


PROGRAMI I MBËSHTETJES SË PLANIFIKIMIT HAPËSINOR KOMUNAL NË KOSOVË

Bëjmë Qytete më të Mira Bashkë

# UDHËZUES PËR HARTIMIN E VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR



Implementuar nga:

**UN HABITAT**  
FOR A BETTER URBAN FUTURE

Financuar nga:

**SWEDISH DEVELOPMENT  
COOPERATION**



PROGRAMI I MBËSHTETJES SË PLANIFIKIMIT HAPËSINOR KOMUNAL NË KOSOVË

Bëjmë Qytete më të Mira Bashkë

# UDHËZUES PËR HARTIMIN E VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR

Tetor 2014

*Implementuar nga:*

**UN HABITAT**  
FOR A BETTER URBAN FUTURE

*Financuar nga:*

**SWEDISH DEVELOPMENT  
COOPERATION**



Udhëzues për vlerësimin strategjik mjedisor

Të gjitha të drejtat e rezervuara © 2014

Programi i Kombeve të Bashkuara për Vendbanimet Njerëzore (UN-Habitat)

Programi i Mbështetjes së Planifikimit Hapësinor Komunal në Kosovë

Ndërtesa e Qeverisë, Rilindja, Kati 10, 10000 Prishtinë, Kosovë

[www.unhabitat.org](http://www.unhabitat.org)

[www.unhabitat-kosovo.org/](http://www.unhabitat-kosovo.org/)

## **NJOFTIM**

Emërtimet e përdorura dhe prezantimet e materialit në këtë publikim nuk paraqesin shprehjen e asnjë opinioni nga ana e Sekretariatit të Kombeve të Bashkuara në lidhje me statusin ligjor të ndonjë shteti, territori, qyteti apo zone, ose të autoriteteve të tij, ose në lidhje me caktimin e kufijve apo kufijve administrativ.

Pikëpamjet e shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Programit të Kombeve të Bashkuara për Vendbanimet Njerëzore, Kombeve të Bashkuara, ose shteteve anëtare të tij.

Pjesët e tij mund të ribotohen pa autorizim, me kusht që të tregohet burimi.

Për UN-Habitat-in, të gjitha referencat për Kosovën janë bërë në kontekst të Rezolutës 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të OKB-së.

## **FALËNDERIMET**

Redaktore kryesore: Catarina Camarinhas, UN-Habitat

Kontribuesi kryesor: Davide Geneletti, Universiteti i Trentos

Kontribuesit: Nezakete Hakaj, Shukri Shabani MMPH, Afrim Berisha AMMK/MMPH

Asistente e Hulumtimit: Doruntinë Rexhepi, UN-Habitat

# PËRMBAJTJA

---

SHKURTESAT DHE AKRONIMET	5
Parathënie	6
Hyrje	8
I. Historiku dhe konteksti	12
1.1 Direktiva e VSM-së dhe Ligji i Kosovës	12
1.2 VSM-ja dhe zhvillimi i qëndrueshëm në Kosovë	15
II. Metodologjia e VSM-së për planet hapësinore në Kosovë	19
2.1 Shqyrtimi/ekzaminimi	19
2.1.1 Kur kërkohet VSM-ja për planifikim hapësinor?	19
2.1.2 Kur duhet bërë ekzaminimi?	22
2.1.3 Si duhet kryer ekzaminimi?	22
2.2 Shqyrtimi (Studimi)	25
2.3 Konsultimi	26
2.3.1 Kërkesat për konsultim	26
2.3.2 Trupat konsultative dhe publiku	27
2.3.3 Rekomandimet	28
III. Fazat e Vlerësimit Strategjik Mjedisor	30
3.1 Faza A: Përcaktimi i kontekstit dhe objektivave, vendosja e bazës dhe shqyrtimit (studimit)	32
3.1.1 Identifikimi i Kornizës Strategjike	32
3.1.2 Hartimi i një studimi themelor/bazë	33
3.1.3 Shqyrtimi (studimi) i çështjeve mjedisore dhe propozimi i objektivave të VSM-së	34
3.2.3 Vlerësimi i ndikimeve të draft-planit	42
3.2.4 Propozimi i masave lehtësuese	44
3.3 Faza C: Përgatitja e raportit të VSM-së	45
3.4 Faza D: Konsultimi dhe vendimmarrja	47
3.5 Faza E: Monitorimi i zbatimit të planit	49
IV. Rekomandimet	51
Referencat	56
Fjalor	58
Shtojca I: Lista përkatëse e Direktivave të BE-së për mjedisin	61
Shtojca II: Lista përkatëse e legjislacionit dhe veprimeve strategjike për mjedisin dhe planifikimin hapësinor	64
Shtojca III: Tabela e VSM-së në lidhje me planifikimin hapësinor	67
Shtojca IV: Veglat për vsm (matricat, lista për Vlerësim)	68

## LISTA E KUTIVE

Kutia 1.1. VSM kundrejt Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM)	9
Kutia 1.2 Disa burime tjera për metodologjinë VSM-së	11
Kutia 1.1.1 Direktiva e VSM-së	12
Kutia 3.2.1 Infrastruktura e gjelbër (IGJ), si një bazë e rëndësishme për planet hapësinore të Kosovës	38
Kutia 4.1.1 Rekomandime të veçanta për VSM-në e Hartave Zonale të Komunave	53
Kutia 4.1.2 Procesi i një VSM-je kualitative	54
Kutia 4.1.3 Një përmbledhje e shkurtër e VSM-së	55

## LISTA E FIGURAVE

Fig 1.1 Hierarkia e vendimmarrjes që tregon se VSM-ja fokusohet në nivele "strategjike" të vendimmarrjes (p.sh. planet dhe programet) dhe VNM-ja fokusohet më shumë në nivele "të prekshme", dmth projektet individuale	10
Fig 1.3.1 VSM-ja si pjesë e procesit të planifikimit strategjik	18
Fig 2.1.1 Aplikimi i ligjit të VSM-së për planet dhe programet (PP)	21
Fig 3.1.1 Fazat dhe detyrat e VSM-së të propozuara në këtë udhëzues	30
Fig 3.2.1 Hierarki tipike e alternativave në VSM	40
Fig 3.2.2 Hierarkia e lehtësimit	45

## LISTA E TABELAVE

Tabela 1.1.1 Kërkesat e Ligjit të VSM-së	13
Tabela 1.2.1 Pikat kyçe për përmirësim dhe ku të gjendet udhëzimi në këta udhëzues	15
Tabela 2.1.1 Karakteristikat e planit ose programit. Për secilën nga pesë kriteret e cekura në shtojcën 1 të Ligjit të VSM-së, një po / jo pyetje është dhënë. Në rast se përgjigja është pozitive, janë dhënë disa pyetje më specifike	23
Tabela 2.1. 2 Karakteristikat e efekteve dhe zona që mund të ndikohet	24
Tabela 2.3.1 Përmbledhje e kërkesave për konsultim në fazat e ndryshme të VSM-së	27
Tabela 2.3.2 Lista e trupave të mundshme konsultative	28
Tabela 3.1.1 Shembuj të burimeve të informacionit në dispozicion: Raportet e gjeneruara në shkallë kombëtare / nën-kombëtare që mund të përmbajnë të dhëna të dobishme për studimin themelor	34
Tabela 3.1.2 Shembuj të objektivave dhe treguesve të VSM-së	35
Tabela 3.1.3 Identifikimi dhe vlerësimi i çështjeve kritike - rast studimor nga El Salvador 2012 (ndryshuar pas Partidário)	37
Tabela 3.2.1 Fragment i një matrice të përputhshmërisë	39
Fig 3.2.1 Hierarki tipike e alternativave në VSM	41
Tabela 3.2.3 Vlerësimi kualitativ i ndikimit të pritshëm të planit në lidhje me kushtet e tanishme kundrejt një sërë objektivave të VSM-së	43
Tabela 3.2.4 Një shembull i matricës që mund të përdoret për përmbledhjen e efekteve kumulative të të gjitha elementeve të një plani në një grup të komponentëve mjedisore	44
Tabela 3.2.5 Shembuj të llojeve të ndryshme të masave të cilat mund të merren në konsideratë në VSM	45
Tabela 3.3.1 Përvijimi dhe përmbajtja e sugjeruar për raportin e mjedisit dhe korrespondenca me informacionin që duhet të ofrohet në pajtim me Ligjin për VSM-në (Shtojca 2)	46
Tabela 3.4.1 Lista kontrolluese për të vlerësuar cilësinë e raporteve të VSM-së (Shtojca 3 të Ligjit për VSM-në)	48
Tabela 3.5.1 Shembull i formatit të mundshëm për një plan monitorues	49
Tabela 4.1.1. Procesi i VSM-së për planet hapësinore në nivele të ndryshme	51

## LISTA E HARTAVE

Harta 3.2.1 Shembull i analizës së infrastrukturës të gjelbër	38
Harta 3.2.2 Ilustrim i një skenari të PZHK-së. Ngjyra kafe e errët tregon zonat aktuale të banimit, kafe e hapur tregon zonat potenciale të banimit dhe e hirtë tregon zonat potenciale të industrisë (në bazë të analizave AHP	42
Harta 3.2.3 Vlerësimi i ndikimit në ekosistemet natyrore dhe ndërlidhja e një plani urban. Harta krahason gjendjen aktuale me gjendjen në plan, duke theksuar fushat ku plani do të shkaktojë një ndikim negativ (e kuqe) ose një ndikim pozitiv (e gjelbër)	43

## SHKURTESAT DHE AKRONIMET

BE	Bashkimi Evropian
QeK	Qeveria e Kosovës
GZ	Gazrat Serre
GIS	Sistemi Informatikë Gjeografik (Geographic Information System)
PNNK	Paneli Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike
AMMK	Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
SZhm	Synimet Zhvillimore të Mijëvjeçarit
PZHK	Plani Zhvillimor Komunal
MZhE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MSh	Ministria e Shëndetësisë
MuSPP	Programi i Mbështetjes së Planifikimit Hapësinor Komunal
HZK	Harta Zonale e Komunës
OJQ	Organizata jo-qeveritare
QRM	Qendra Rajonale e Mjedisit
VSM	Vlerësimi Strategjik Mjedisor
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
UN-Habitat	Programi i Kombeve të Bashkuara për Vendbanimet Njerëzore
GP	Grupet punuese të palëve të interesuara për çështje specifike

## PARATHËNIE

Këto udhëzime janë rezultat i përvojës së UN-Habitat-it në Kosovë në mbështetjen e proceseve të planifikimit hapësinor dhe të mjedisit. Ato kanë për qëllim të ndihmojnë qeverinë qendrore e lokale, duke ofruar rekomandime për zbatimin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM) në Kosovë, pas adoptimit të Direktivës<sup>1</sup> së Bashkimit Evropian për VSM-në të vitit 2001 në legjislacionin e Kosovës, dhe në veçanti në lidhje me atë që ka të bëjë me procesin e planifikimit hapësinor.

Adresimi i problemeve mjedisore është një nga prioritetet më të rëndësishme në Kosovë për orientimin e saj drejt procesit të integritimit Evropian. Programi i UN-Habitatit për Mbështetjen e Planifikimit Hapësinor Komunal në Kosovë (MuSPP), i ka përkrahur komunat e Graçanicës, Junikut, Hanit të Elezit, Malishevës, Mamushës, Parteshit, Prizrenit dhe Rahovecit në procesin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM) të planeve zhvillimore komunale. Në nivel kombëtar, MuSPP-ja ka udhëhequr VSM-në e planit hapësinor të Parkut Kombëtar të Bjeshkëve të Nemuna, në mbështetje të Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AKMM), dhe Institutit për Planifikim Hapësinor (IPH).

Përderisa bashkëpunon në vlerësimin e cenueshmërisë së mjedisit, VSM-ja synon të fokusohet tek zhvillimi i qëndrueshëm. Si pjesë e proceseve të ndërmarra në Kosovë, autoritetet e planifikimit së bashku me ekspertë të pavarur të mjedisit, kanë vlerësuar dimensionin mjedisor të planeve të tyre mjedisore që janë në vazhdim e sipër dhe nxjerrjen e veprimeve të propozuara, duke përcaktuar objektivat mjedisore dhe duke definuar synimet dhe treguesit për të ndihmuar matjen e ndryshimit dhe për të parashikuar ndikimet e planeve të propozuara mbi mjedisin dhe gjithashtu duke zhvilluar masat lehtësuese për ndikimet e parapara negative që ndodhin nga zhvillimi i propozuar.

Vlerësimet kanë tërhequr vëmendjen e një audience të gjerë, në atë se ata kanë prezantuar një vlerësim të hapur të planeve hapësinore, duke ofruar aktivitete të trajnimit dhe një qasje të përgjithshme të planifikimit me pjesëmarrje. Gjatë këtyre proceseve, janë shqyrtuar teknikat e zakonshme të vlerësimit të qëndrueshmërisë, të tilla si:

- Vlerësimi i matricës;
- përdorimi i GIS-it, duke përfshirë edhe procesin analitik të hierarkisë (PAH);
- Vlerësimi i shumë kritereve sociale me përdorimin e kombinuar të teknikave pjesëmarrëse dhe analizave të shumë kritereve;
- 'komunikimi bashkëpunues' në të cilin grupet e interesuara përzgjedhin kriteret e vlerësimit, ekspertët prezantojnë ndikimin e informacionit dhe matjes, si dhe qytetarët eksplorojnë vlerat, etj.

Përveç matjes së performancës së veçantë të secilit opion të planifikimit kundrejt kritereve mjedisore, është ndërmarrë renditja tipike e skenarëve.

Procesi i vlerësimit strategjik mjedisor në Kosovë përfshin disa parime të cilat janë konsideruar si pjesë e udhëzimit të ofruar nga UN-Habitati tek autoritetet komunale:

- integrimin e të dhënave sasiore dhe cilësore në analizë;
- aprovimi i kapitalit ndër-brezor dhe të pakicave duke marrë parasysh grupe të ndryshme sociale dhe interesat e tyre të veçanta;
- ofrimi i mundësive për të mësuar gjatë procesit;
- sigurimi i transparencës në çdo hap të VSM-së; dhe
- pasja e një elementi të fortë të angazhimit publik dhe të palëve të interesuara.

Ky Udhëzues për Vlerësim Strategjik Mjedisor të Planeve Hapësinore, është pjesë e një serie të udhëzuesve dhe mjeteve që Programi i UN-Habitatit/ (MuSPP) për Mbështetje të Planifikimit Hapësinor Komunal është ofruar në mbështetje të proceseve të planifikimit hapësinor dhe të qeverisjes në Kosovë. Të gjithë udhëzuesit dhe mjetet në këtë seri janë të nxjerrë në bazë të përvojës dhe informacionit të gjeneruar nga mbështetja e UN-Habitatit për planifikimin hapësinor komunal. Ky udhëzues ka për qëllim të mundësojë vendimmarrësit e nivelit lokal dhe qendror, organizatat

<sup>1</sup> Direktiva 2001/42/EC e Parlamentit dhe Këshillit Evropian të 27 Qershorit 2001 mbi vlerësimin e efekteve të planeve dhe programeve të caktuara në mjedis, OJ L 197, 21.7.2001, f. 30-37.



joqeveritare, si dhe përfaqësuesit e komuniteteve lokale që të njihen me një shumëllojshmëri të metodave më të përshtatshme për kontekstin e tyre zhvillimor në mbështetje të proceseve të planifikimit hapësinor.

Ky udhëzues është rregulluar në atë mënyrë që do të inkurajon përdoruesit të marrin në konsideratë ndikimet mjedisore të planeve dhe programeve në kontekste specifike të planifikimit hapësinor. Gjetjet nga proceset e para të VSM-së në Kosovë kanë vendosur bazat për udhëzues dhe duhet të ofrojnë mësim të rëndësishme për komunitetet tjera si në Kosovë ashtu dhe në rajonin e Ballkanit, kur ata i shqyrtojnë opsionet e ndryshme për planifikimin e mjedisit dhe planifikimin e integruar të zhvillimit. Përpos vlerësimit të planit, vlerësimi i mjedisit në kontekstin e Kosovës duhet të ofroj mundësi për të rritur ndërgjegjësimin për konsideratë mjedisore në planifikim dhe duhet po ashtu të përfshijë një sërë masash monitoruese dhe lehtësuese për t'u zhvilluar më tej nga ana e komunave gjatë zbatimit të planeve të tyre zhvillimore komunale si pjesë e një qasje të integruar drejt planifikimit efektiv të zhvillimit të qëndrueshëm.

### Çfarë është Vlerësimi Strategjik Mjedisor?

Qëllimi i përgjithshëm i Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM) është të ofroj një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit dhe të kontribuoj në integrimin e konsideratave mjedisore në përgatitjen dhe miratimin e planeve dhe programeve me qëllim të promovimit të zhvillimit të qëndrueshëm. VSM-ja është një instrument vlerësues për vlerësimin e ndikimeve të natyrës strategjike<sup>2</sup> që synon në:

- Sigurimin e një vizioni strategjik dhe perspektivë të gjerë sa i përket aspekteve mjedisore, në kuadër të një qasje të zhvillimit të qëndrueshëm;
- Sigurimin e integritetit të aspekteve që lidhen me mjedisin në procesin e vendimmarrjes, ndërsa mundësitë për zhvillimin e ardhshëm janë në diskutim;
- Sigurimin e ndihmës në identifikimin, përzgjedhjen dhe arsyetimin e opsioneve në sfidat e mjedisit dhe synimet e zhvillimit;
- Zbulimin e problemeve dhe mundësive, dhe prezantimin e sugjerimeve për programet strategjike të monitorimit dhe menaxhimit;
- Sigurimin e transparencës dhe pjesëmarrjes në zhvillimin strategjik, duke përfshirë të gjitha palët e interesuara;
- Gjenerimin e konteksteve për zhvillim që mund të jenë më të përshtatshme për propozime të zhvillimit në të ardhmen.

Qëllimi kryesor i një VSM-je është promovimi i zhvillimit të qëndrueshëm përmes shqyrtimit të hollësishëm të çështjeve të qëndrueshmërisë të integruara në përgatitjen dhe miratimin e planeve. Qëllimi është që të prezantohet të menduarit e qëndrueshëm në të gjitha fazat e planifikimit të zhvillimit, duke pasur parasysh se "efikasiteti i urbanizmit duhet t'iu paraprijë shpenzimeve të teknologjive alternative"<sup>3</sup>, duke u fokusuar në mbrojtjen e aspekteve kritike të mjedisit dhe në të njëjtën kohë duke reduktuar kërkesat e përgjithshme të burimeve.

Në procesin e planifikimit hapësinor, vendimet strategjike do të ndërmerren me kohë. Nëse VSM-ja synon të ndikojë në vendim strategjik, duhet të jetë proces i vazhdueshëm, i promovuar në kuadër të procesit të planifikimit, duke integruar aspektet mjedisore dhe çështjet e qëndrueshmërisë gjatë hartimit të opsioneve strategjike për zhvillimin e ardhshëm.

VSM-ja duhet të jetë fleksibile dhe të jetë në gjendje që të përshtatet në kontekstin e planifikimit dhe hartimit të politikave (përfshirë faktorët ligjorë, institucionalë, proceduralë, kulturorë dhe politikë), që mund të jetë shumë i ndryshëm mes vendeve, niveleve vendimmarrëse (kombëtare, rajonale, etj), dhe sektorëve (shfrytëzimi i tokës, bujqësia, uji, energjia, etj). Përveç kësaj, rrethanat specifike të veprimit strategjik në shqyrtim (në aspektin e përmbajtjes, nivelin e përkufizimit, disponueshmëria e të dhënave, kohëzgjatjes, këshillimet me grupet e interesit, etj) do të përcaktojnë mënyrën se si është ndërmarrë VSM-ja. Megjithatë, edhe pse qasjet e VSM-së ndryshojnë në vende të ndryshme, për sektorë të ndryshëm dhe për nivele të ndryshme të vendimmarrjes, ekziston marrëveshje e gjerë për parimet e caktuara të definimit<sup>4</sup>:

- VSM është një mjet për përmirësimin e veprimeve strategjike. Për këtë arsye, VSM-ja duhet të fillojë herët, dhe të ndërmerret si pjesë integrale e procesit të vendimmarrjes. Vendimmarrësit duhet të përfshihen në procesin e VSM-së për të siguruar se çështjet e duhura u janë dhënë gjetjeve të VSM-së;
- VSM duhet të promovojnë pjesëmarrjen e palëve të interesuara dhe të sigurojnë transparencë në procesin e vendimmarrjes, duke përfshirë ndjeshmërinë ndaj gjinisë;

<sup>2</sup> PARTIDÁRIO, Maria do Rosário (2007) *Guia de Boas Práticas para Avaliação Ambiental Estratégica: Orientações Metodológicas*, Lisbonë, Agência Portugeze e Mjedisit

<sup>3</sup> CALTHORPE CALTHORPE, Peter (2010) *Urbanism in the age of climate change*, Washington, Revista Island

<sup>4</sup> THERIVEL, R. (2004) *Strategic Environmental Assessment in action*, Earthscan, Londër

- VSM duhet të përqendrohet në problemet kryesore mjedisore dhe të qëndrueshmërisë që janë të duhura për ndonjë veprim të caktuar strategjik, duke pasur parasysh afatet e përcaktuara dhe burimet e procesit të vendimmarrjes. Një fazë shqyrtimi është gjithmonë e rëndësishme për të klasifikuar çështjet kyçe;
- VSM duhet të përfshijë analizën dhe krahasimin e opsioneve të mundshme për veprim strategjik, dhe identifikimin e asaj më të përshtatshmes;
- VSM duhet të synojë zvogëlimin e efekteve negative, rritjen atyre pozitive, duke kompensuar humbjen e karakteristikave të vlefshme dhe dobive, dhe duke u siguruar që nuk janë shkaktuar dëme të pakthyeshme. Kjo kërkon parashikimin e efekteve të vendimit strategjik, dhe duke krahasuar situatën e mundshme në të ardhmen pa veprim (bazë) kundrejt situatës me veprim. Kjo gjithashtu kërkon vlerësimin e rëndësisë së efekteve.

Me pak fjalë, një proces i VSM-së me cilësi të mirë i informon planifikuesit, vendimmarrësit dhe popullatën e prekur për qëndrueshmërinë e vendimeve strategjike, lehtëson kërkimin për alternativën më të mirë dhe siguron një proces për vendimmarrje demokratike<sup>5</sup>.

Direktiva e KE-së për VSM-të si dhe Ligji i Kosovës për VSM-të kufizojnë fushëveprimin e VSM-së në dy nivele të vendimeve strategjike: planet dhe programet. Planet dhe programet do të thotë gjëra të ndryshme në kontekste të ndryshme, edhe pse shumica e përkufizimeve kanë aspekte gërshetuese dhe në thelb janë variante të së njëjtës temë. Thënë thjeshtë<sup>6</sup>:

- Një plan që është strategji ose dizajn i qëllimshëm dhe i mezipritur, shpesh me prioritete, opsione dhe masa të koordinuara që elaborojnë dhe zbatojnë politikën;
- Një program që është axhendë koherente e organizuar e angazhimeve, propozimeve, instrumenteve dhe/ose projekt i cili elaboron dhe zbaton politikën.

Karakteristikat dalluese të VSM-së në krahasim me VNM-në, janë<sup>7</sup>:

- Pasiguria e madhe në lidhje me efektet e planit apo programit (që japin direktivën e përgjithshme), në krahasim me projektin (që përbëhet prej veprimeve konkrete);
- Duhet pasur parasysh shkallë më të gjerë të pasojave në mjedis;
- Grup më i gjerë i lidhshmërive dhe kompromiseve me çështjet ekonomike dhe sociale;
- Të merren parasysh struktura me shkallë më të gjerë/kohë më të gjatë për efektin dhe pasojat mjedisore (p.sh., implikimet e emetimeve të gazrave serë për ndryshimin e klimës).

#### Kutia 1.1. VSM kundrejt Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM)

VSM dhe VNM përqendrohen në nivele të ndryshme të vendimmarrjes. Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis (VNM) fokusohet në projekte individuale (që potencialisht mund të prodhojë ndikim të ndjeshëm në mjedis), derisa Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM) fokusohet në vendimet e nivelit të lartë, dmth planeve dhe programeve.

VNM	VSM
Aplikohet në projekte specifike	Aplikohet në plane dhe programe me një perspektivë të gjerë strategjike dhe afatgjatë
Merr parasysh shkallën e kufizuar të alternativave të projektit	Merr parasysh një shkallë të gjërë të skenarëve alternativë
Shqyrtim i kufizuar i ndikimeve kumulative, shpesh i kufizuar deri tek fazat e projektit të caktuar. Nuk mbulon shkallën regjionale dhe projektet e shumëfishta	Në thelb merr parasysh ndikimet kumulative dhe sinergjitë
Proces mirë i definuar, linear	Proces shumë fazësh, me reagim të pandërprerë dhe me përsëritje
Vë theks në zbutjen e ndikimeve, por me identifikimin e disa mundësive të projektit (p.sh., masat fillestare)	Vë theks në përmbushjen e objektivave të balancuara mjedisore, sociale dhe ekonomike. Përfshin identifikimin e rezulttit të zhvillimit në nivel makro.


Modifikuar nga: OECD (2006) *Aplikimi i Vlerësimit Strategjik Mjedisor: Udhëzimet praktikave të mira për bashkëpunimit zhvillimor*, Udhëzimet e DAC dhe seria e referencave

<sup>5</sup> Asociacioni Ndërkombëtar për Vlerësimin e Ndikimit (2002) *Strategic Environmental Assessment: Performance Criteria, Publikimet e veçanta IAIA, seria nr. 1* [shih : <http://www.iaia.org/publicdocuments/special-publications/sp1.pdf>]

<sup>6</sup> SADLER, B. and R. VERHEEM (1996) *Strategic Environmental Assessment, Volume 53: Status, Challenges and Future Directions*, Ministry of Housing, Spatial Planning and the Environment, The Netherlands, and the International Study of Effectiveness of Environmental Assessment

<sup>7</sup> ABAZA, H., BISSET, R., SADLER, B. (2004) *Environmental Impact Assessment and Strategic Environmental Assessment: Towards an Integrated Approach*, UNEP

**Fig 1.1 Hierarkia e vendimmarrjes që tregon se VSM-ja fokusohet në nivele "strategjike" të vendimmarrjes (p.sh. planet dhe programet) dhe VNM-ja fokusohet më shumë në nivele "të prekshme", dmth projektet individuale**



### Qëllimi i udhëzuesit

Këto udhëzime kanë për qëllim ofrimin e udhëzimeve për zbatimin e Direktivës së VSM-së në nivel të Kosovës me qëllim që të promovohet qasje e planifikimit mjedisor në praktikën e zhvillimit urban. Udhëzimet janë zhvilluar si mjet referimi për komunat e Kosovës dhe si rezultat i iniciativave kryesore mjedisore të ndërmarra në mbështetje të komunave partnere të MuSPP, atëherë kur i adresohet planifikimit hapësinor të Kosovës.

Qëllimi i këtij dokumenti është të ofrojë udhëzime operative për t'i mbështetur proceset e Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM) në Kosovë. Dokumenti fokusohet në planifikimin hapësinor, por pjesa më e madhe e përmbajtjes, dhe metodologjisë së propozuar, janë të aplikueshme në mënyrë më të përgjithshme për VSM në gjitha sektorët.

### Kë synojnë ky udhëzues?

Të kuptuarit e VSM-së në planifikimin hapësinor ofron një bazë të vlefshme për vendimmarrësit, planifikuesit, projektuesit dhe akterëve tjerë në procesin e planifikimit hapësinor, ashtu që të analizohet dhe inkorporohet një perspektivë mjedisore në formulimin e kornizave zhvillimore shumë të afta për t'iu përshtatur kontekstit specifik.

Ky udhëzues ka për qëllim të ndihmojë qeverinë qendrore dhe lokale, si dhe profesionistët që punojnë në fushën e mjedisit në Kosovë, duke siguruar një udhëzues hap pas hapi si dhe rekomandime të përgjithshme, metoda dhe mjete se si të zbatohet VSM-ja për planifikimin hapësinor, duke vënë në dispozicion informata të përgjithshme për metodologjinë dhe praktikën e VSM-së.

### Si të përdoret ky udhëzues?

Dokumentin ofron hyrje të përgjithshme mbi planifikimin mjedisor, duke marrë nga përvoja e MuSPP-së në Kosovë. Përdoruesit mund ta shohin gjithë dokumentin përnjëherësh ose të kalojnë direkt në kapitujt me interes të

veçantë në mënyrë që të merren informata specifike për procesin, metodologjitë, teknikat dhe mjetet specifike të VSM-së, të dizajnuara për rrethanat e Kosovës.

**Kapitulli 1: Historiku dhe konteksti** ofron përmbledhje të historikut mbi praktikën e VSM-së dhe zbatimin ligjor dhe praktik të tij në nivelin e planifikimit hapësinor të Kosovës.

**Kapitulli 2: Metodologjia e VSM-së për planet hapësinore të Kosovës** përshkruan metodologjinë e përgjithshme të propozuar për procesin e VSM-së në përputhje me Ligjin e Kosovës nr.03/L -230 (në tekstin e mëtejshëm "Ligji i VSM-së"), si dhe kërkesat e sugjeruara nga udhëzimet dhe praktikën më të mira ndërkombëtare. Ky kapitull ofron rekomandim për ekzaminim, shqyrtim dhe konsultim, i planifikuar posaçërisht për praktikën e Kosovës.

**Kapitulli 3: Fazat e Vlerësimit Strategjik Mjedisor**-përshkruajnë në detaje metodologjinë hap pas hapi për zhvillimin e VSM-së për planet hapësinore të Kosovës.

**Kapitulli 4: Rekomandimet**- japin një përmbledhje të informatave kryesore të përfshira në këtë udhëzues dhe ofrojnë disa ide se si VSM-ja duhet të reflektojë nivelin e planit hapësinor që i nënshtrohet analizimit, duke bërë dallimin në mes planifikimit në nivelin nacional dhe atij lokal.

#### Kutia 1.2 Disa burime tjera për metodologjinë VSM-së

Burimi	Faqja e internetit
Komisioni Evropian (2013). Udhëzime mbi integrimin e ndryshimeve klimatike dhe biodiversitetit në vlerësimin strategjik mjedisor.	<a href="http://ec.europa.eu/environment/eia/sea-support.htm">http://ec.europa.eu/environment/eia/sea-support.htm</a>
UNEP (2014). Integrimi i shërbimeve të ekosistemit në vlerësimin strategjik mjedisor: Udhëzues për praktikuesit.	<a href="http://www.proecoserv.org/information-hub-test/guideline.html">http://www.proecoserv.org/information-hub-test/guideline.html</a>
Partidario, M (2012). Vlerësimi Strategjik Mjedisor-Udhëzues i praktikave më të mira: Udhëzime metodologjike për të menduarit strategjik në VSM. Agjencia e Mjedisit e Portugalisë dhe REDES Energéticas Nacionais.	<a href="https://www.iaia.org/publicdocuments/special-publications/SEA%20Guidance%20Portugal.pdf">https://www.iaia.org/publicdocuments/special-publications/SEA%20Guidance%20Portugal.pdf</a>
Vlerësimi Strategjik Mjedisor-Burim i hapur edukativ. Universiteti i Kombeve të Bashkuara dhe Universiteti i Oxford Brookes	<a href="http://sea.unu.edu/index.html">http://sea.unu.edu/index.html</a>
Ahmed, K. dhe Sánchez-Triana, E. (Eds) (2008)Vlerësimi strategjik mjedisor për Politika.Banka Botërore, Washington D.C	<a href="http://siteresources.worldbank.org/INTRANE/ENVIRONME/NT/1705772-1210788188539/21819527/SEA_FOR_POLICIES.pdf">http://siteresources.worldbank.org/INTRANE/ENVIRONME/NT/1705772-1210788188539/21819527/SEA_FOR_POLICIES.pdf</a>
OECD (2006). Aplikimi i Vlerësimit Strategjik Mjedisor. Udhëzim për praktika të mira për zhvillimin e bashkëpunimit. Udhëzimet dhe seritë e referencës së DAC	<a href="http://www.oecd.org/dac/environment-development/37353858.pdf">http://www.oecd.org/dac/environment-development/37353858.pdf</a>
Abaza, H., Bisset, R., Sadler, B. (2004) Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis dhe Vlerësimi Strategjik Mjedisor: Drejt një qasjeje të integruar. UNEP	<a href="http://www.unep.ch/etu/publications/textONUBr.pdf">http://www.unep.ch/etu/publications/textONUBr.pdf</a>
ODPM (2005) Udhëzues praktik për Direktivën e Vlerësimit Strategjik Mjedisor. Departamenti Ekzekutiv i Skocisë Kuvendi i Uellsit për mjedis, Irlandë Veriore	<a href="http://www.doeni.gov.uk/niea/bm_sea_practicalguide.pdf">http://www.doeni.gov.uk/niea/bm_sea_practicalguide.pdf</a>

# I. HISTORIKU DHE KONTEKSTI

## 1.1 Direktiva e VSM-së dhe Ligji i Kosovës

Fusha e VSM-së është zhvilluar me shpejtësi të madhe gjatë 15 viteve të fundit, dhe VSM-ja është ndërmarrë, si zyrtarisht ashtu edhe jo zyrtarisht, tek një numër gjithnjë në rritje të vendeve dhe organizatave ndërkombëtare<sup>8</sup>. VSM-ja aplikohet kryesisht tek nismat që lidhen me zhvillim, që promovohen individualisht në sektorë (p.sh., transport, energji, ujë, turizëm), ose kolektivisht në një zonë gjeografike (p.sh., plani rajonal hapësinor ose shfrytëzimi i tokës). Gjithnjë e më shumë, VSM-ja ka zgjeruar fushëveprimin e vet për të përfshirë pasojat sociale, shëndetësore dhe ekonomike si dhe marrëdhëniet e tyre me konceptet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe strategjitë<sup>9</sup>.

Direktiva e Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM) është hap i rëndësishëm në të drejtën Evropiane për mjedis. Direktivat Evropiane nr.2001/42/EC mbi vlerësimin e efekteve të planeve dhe programeve në mjedis, i njohur si Vlerësimi Strategjik Mjedisor ose Direktiva e VSM-së, dhe 2003/35/EC, lidhur me pjesëmarrjen e publikut në planet dhe programet e caktuara që kanë të bëjnë me mjedisin, kanë paraqitur vlerësim strategjik mjedisor për planet dhe programet në sektorët e bujqësisë, pylltarisë, peshkatarisë, energjisë, industrisë duke përfshirë xehetarinë, transportin, zhvillimin rajonal, menaxhimin e mbeturinave, menaxhimin e ujit, telekomunikacionin, turizmin, planifikimin e qytetit ose vendit ose shfrytëzimin e tokës të cilat vendosin kornizën për zhvillimin e ardhshëm, ku planifikimi komunal është i përcaktuar qartë.

Vlerësimi mjedisor i planeve dhe programeve ka qenë kërkesë obligative në Kosovë që nga viti 2010: sipas pikës 2 të nenit 3, kapitulli II, të Ligjit të Kosovës nr. 03/L -230 për Vlerësimin Strategjik Mjedisor (tetor 2010), " Hartimi i raportit për VSM është i detyrueshëm për planet dhe programet nga fusha e planifikimit hapësinor dhe urbanistik, në shfrytëzimin e tokës, bujqësisë, pylltarisë, peshkatarisë, energjetikës, industrisë, minierave, komunikacionit, menaxhimin e mbeturinave, menaxhimin e ujërave, telekomunikacionit, turizmit, të cilat japin kornizën për zhvillimin e ardhshëm të projekteve të cilat i nënshtrohen vlerësimit të ndikimit në mjedis në përputhje me Ligjin për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis ".

Ligji 03/L-230 për Vlerësimin Strategjik Mjedisor përcakton kushtet, mënyrën dhe procedurat për vlerësimin e ndikimit në mjedis, të planeve dhe programeve të caktuara përmes integritit të parimeve për mbrojtjen e mjedisit në përgatitjen, miratimin dhe realizimin e planeve dhe programeve, me qëllim të promovimit të zhvillimit të qëndrueshëm.

Në thelb, Ligji për VSM-në kërkon që procedura e VSM-së të përmbajë:

<sup>8</sup> SADLER, B. (2011) *Vështrim i vëmendshëm i VSM-së*, In: SADLER, B., ASCHEMANN, R., DUSIK, J., FISCHER, T.B., PARTIDARIO, M., VERHEEM, R. (eds), *Manual i vlerësimit strategjik mjedisor*, Londër, Earthscan, 1-19

<sup>9</sup> ABAZA, H., BISSET, R., SADLER, B. (2004) *Vlerësimi i ndikimit në mjedis dhe vlerësimi strategjik mjedisor: Drejt një qasje të integruar*, UNEP

### Kutia 1.1.1 Direktiva e VSM-së

Direktiva e VSM kërkon që PP-të e caktuara t'i nënshtrohen një vlerësimi mjedisor para se të miratohen.

Direktiva e VSM-së është integruar në legjislacionin e Kosovës dhe zbatohet në një shkallë të gjerë të PP (p.sh. në shfrytëzimin e tokës, transportit, energjisë, bujqësisë, etj).

PP në aspektin e Direktivës së VSM-së duhet të hartohet ose miratohet nga një autoritet publik (të nivelit kombëtar apo lokal) dhe të kërkohej me dispozita legjislative, rregullative ose administrative.

PP-të që mbulohen nga Direktiva i nënshtrohen një vlerësimi mjedisor gjatë përgatitjes së tyre si dhe para se të miratohen. Procedurat përfshijnë hartimin e një raporti për VSM-në në të cilin janë marrë parasysh efektet e mundshme të ndjeshme në mjedis dhe alternativat. Raporti i VSM-së dhe rezultatet e konsultimeve (me publikun, autoritetet mjedisore, etj) janë marrë parasysh para se të miratohet PP-ja e propozuar. Pas miratimit të PP-së, organet mjedisore dhe publiku janë të informuar dhe informacioni gjegjës iu është dhënë në dispozicion. Direktiva e VSM-së më tej përfshin monitorimin e efekteve të rëndësishme mjedisore të PP për të identifikuar efektet negative të paparashikuara në një fazë të hershme të zbatimit të PP-së

- Përgatitjen e një raporti të VSM-së mbi efektet domethënëse të projekt planit ose programit;
- Konsultimin e organeve përkatëse dhe publikut të gjerë, në projekt planin ose programin dhe duke ia shoqëruar raportin e VSM-së;
- Shqyrtimi i raportit të VSM-së dhe rezultatit të konsultimit në vendimmarrje;
- Komunikimi i rezultateve të VSM-së dhe të përfshirjes së rezultatit të tij në plan ose program.

Ligji i Kosovës për Vlerësimin Strategjik Mjedisor, thekson se VSM-ja duhet të raportojë aspektet e mëposhtme:

1. një përmbledhje të përmbajtjeve, objektivave kryesore të planit ose programit dhe raportet me planet dhe programet tjera relevante;
2. aspektet relevante të gjendjes aktuale të mjedisit dhe evolucionit të mundshëm të tij pa zbatimin e planit ose programit;
3. karakteristikat mjedisore të zonave që mund të preken në mënyrë të konsiderueshme;
4. çdo problem ekzistues mjedisor, i cili është relevant për planin ose programin, duke përfshirë, në veçanti, ato që lidhen me çdo fushë të një rëndësie të veçantë për mjedisin, siç janë zonat e caktuara në pajtim me Direktivat 79/409/EEC dhe 92/43/EEC;
5. objektivat për mbrojtjen e mjedisit, të krijuara në nivel kombëtar, ndërkombëtar ose të atij të Komunitetit Evropian, që kanë të bëjnë me planin ose programin dhe mënyrën se si këto objektiva ose konsiderata mjedisore janë marrë parasysh gjatë përgatitjes së saj;
6. Efektet e mundshme domethënëse në mjedis (duke përfshirë efektet dytësore, kumulative, sinergjike, afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, të përhershme dhe të përkohshme, pozitive dhe negative dhe sipas nevojës edhe efektet ndërkufitare), në çështjet e tilla si biodiversiteti, popullata, shëndeti i njeriut, flora, fauna, toka, uji, ajri, faktorët klimatik, asetet materiale, trashëgimia kulturore dhe natyrore duke përfshirë trashëgiminë arkitekturale dhe arkeologjike, peisazhin dhe marrëdhëniet në mes të faktorëve të mësipërm;
7. masat e parashikuara për të parandaluar, zvogëluar dhe kompensuar sa më shumë që të ketë mundësi efektin negativ domethënës në mjedis të zbatimit të planit ose programit;
8. një përshkrim të arsyeve për përzgjedhjen e alternativave të trajtuara, si dhe përshkrimi i asaj se si është realizuar vlerësimi, duke përfshirë secilën vështirësi - siç janë vështirësitë teknike ose mungesa e ekspertizës - të hasura gjatë përgatitjes së informacionit të kërkuar;
9. një përshkrim të masave të parashikuara në lidhje me monitorimin në përputhje me nenin [...];
10. një përmbledhje jo-teknike e informacionit të dhënë nën titujt e mësipërm.

Tabela më poshtë përcakton këto kërkesa në mënyrë më të detajuar, dhe përshkruan ku ato janë të adresuara në këtë raport.

**Tabela 1.1.1 Kërkesat e Ligjit të VSM-së**

Kërkesat	Në cilin kapitull janë mbuluar ato
<i>Përgatitja e një raporti të VSM-së, në të cilin efektet domethënëse të mundshme në mjedisin e zbatimit të planit ose programit dhe alternativat e arsyeshme duke marrë parasysh objektivat dhe fushëveprimin gjeografik të planit ose programit, janë identifikuar, përshkruar dhe vlerësuar. Informatat që duhet dhënë janë (Neni 7 dhe Aneksi II):</i>	<i>Kapitulli 3.3</i>

Kërkesat	Në cilin kapitull janë mbuluar ato
1. një përmbledhje të përmbajtjeve, objektivave kryesore të planit ose programit dhe raportet me planet dhe programet tjera relevante	Kapitulli 3.1, Kapitulli 3.2
2. aspektet relevante të gjendjes aktuale të mjedisit dhe evolucionit të mundshëm të tij pa zbatimin e planit ose programit	Kapitulli 3.1, Kapitulli 3.2
3. karakteristikat mjedisore të zonave që mund të preken në mënyrë të konsiderueshme	Kapitulli 3.1
4. çdo problem ekzistues mjedisor, i cili është relevant për planin ose programin, duke përfshirë, në veçanti, ato që lidhen me çdo fushë të një rëndësie të veçantë për mjedisin, siç janë zonat e caktuara në pajtim me Direktivat 79/409/EEC dhe 92/43/EEC	Kapitulli 3.1, Kapitulli 3.2
5. objektivat për mbrojtjen e mjedisit, të krijuara në nivel kombëtar, ndërkombëtar ose të atij të Komunitetit Evropian, që kanë të bëjnë me planin ose programin dhe mënyrën se si këto objektiva ose konsiderata mjedisore janë marrë parasysh gjatë përgatitjes së saj	Kapitulli 3.1, Kapitulli 3.2
6. efektet e rëndësishme të mundshme në mjedis (duke përfshirë efektet dytësore, kumulative, sinergjike, afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë, të përhershme dhe të përkohshme, pozitive dhe negative dhe sipas nevojës edhe efektet ndërkuftare), në çështjet e tilla si biodiversiteti, popullata, shëndeti i njeriut, flora, fauna, toka, uji, ajri, faktorët klimatik, asetet materiale, trashëgimia kulturore dhe natyrore duke përfshirë trashëgiminë arkitekturale dhe arkeologjike, pesizhin dhe raportin në mes të faktorëve të mësipërm	Kapitulli 3.2
7. masat e parashikuara për të parandaluar, zvogëluar dhe kompensuar sa më shumë që të ketë mundësi efektin e rëndësishëm negativ në mjedis të zbatimit të planit ose programit	Kapitulli 3.2
8. një përshkrim të arsyeve për përzgjedhjen e alternativave të trajtuara, si dhe përshkrimi i asaj se si është realizuar vlerësimi, duke përfshirë secilën vështirësi - siç janë vështirësitë teknike ose mungesa e ekspertizës - të hasura gjatë përgatitjes së informacionit të kërkuar	Kapitulli 3.2, Kapitulli 3.3
9. një përshkrim të masave të parashikuara në lidhje me monitorimin	Kapitulli 3.5
10. një përmbledhje jo-teknike e informacionit të dhënë nën titujt e mësipërm	Kapitulli 3.3
<p>Raporti do të duhej të përfshijë informata të tilla siç janë përmendur në Aneksin II, që mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme, duke marrë parasysh (Neni 7.3):</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- njohuritë aktuale dhe metodat e vlerësimit;</li> <li>- përmbajtjen dhe nivelin e detajeve në plan ose program;</li> <li>- fazën e planit ose programit në vendimmarrje dhe fazën e procesit për çështjet e caktuara që vlerësohen më përshtatshëm në nivele të ndryshme në atë proces për ta shmangur dyfishimin e vlerësimit.</li> </ul>	Kapitulli 3, Kapitulli 3.1, Kapitulli 3.2, Kapitulli 3.4
<b>Konsultimi</b>	
Të konsultohen organet konsultative kur të vendoset për fushëveprimin dhe nivelin e detajeve të informatave që duhet të përfshihen në raport (Neni 7.5)	Kapitulli 2.3, Kapitulli 3.4
Të sigurohet që organeve konsultative dhe publikut tu jepet mundësia efektive për të shprehur mendimin e tyre mbi dokumentet përkatëse (projekt propozimin e mëhershëm të planit ose programit dhe raportin e tij shoqëruar të VSM-së) (neni 8)	Kapitulli 2.3, Kapitulli 3.4
Të aranzhohet për debat publik (neni 9)	Kapitulli 2.3, Kapitulli 3.4
Të aranzhohet për procesin e konsultimit me vendet tjera, në rast se plani ose programi	Kapitulli 2.3, Kapitulli 3.4



<b>Kërkesat</b>	<b>Në cilin kapitull janë mbuluar ato</b>
<i>mund të ketë efekte të rëndësishme në mjedisin e atyre vendeve (Neni 10).</i>	
<i>Vendimmarrja duhet të ketë parasysh raportin e VSM-së si dhe rezultatet e konsultimeve (neni 14).</i>	Kapitulli 3.4
<b>Informata mbi vendimin</b>	
<i>Kur plani ose programi miratohet, publiku, organet konsultative dhe çdo shtet i konsultuar do të duhet të informohet dhe këto si më poshtë duhet të vihen në dispozicion të këtyre më lartë(Neni 15):</i>	Kapitulli 3.4
<ul style="list-style-type: none"> <li>- si janë janë integruar çështjet mjedisore në plan ose program;</li> <li>- si janë marrë parasysh mendimet nga autoritetet konsultuese dhe publikut, përfshirë edhe konsultimet e publikut dhe ndonjë pikëpamje si rezultat i konsultimeve ndër shtetërore;</li> <li>- arsyet për zgjedhjen e planit apo programit nga shqyrtimi i alternativave të tjera të arsyeshme;</li> <li>- masat që duhet të ndërmerren për të monitoruar efektet domethënëse mjedisore të zbatimit të planit ose programit.</li> </ul>	
<b>Monitorimi i efekteve të mundshme mjedisore të zbatimit të planit apo programit (neni 16)</b>	Kapitulli 3.5
<b>Sigurimi i cilësisë i raportit të VSM-së, duke iu referuar listës së kritereve të cilësisë (neni 12.5, Aneksi III)</b>	Kapitulli 3.4

## 1.2 VSM-ja dhe zhvillimi i qëndrueshëm në Kosovë

VSM-ja për planifikim hapësinor është ende një temë relativisht e re në Kosovë, dhe ka shembuj të kufizuar të zbatimit "të plotë" të VSM-së, dmth., VSM-ja është ndërmarrë në të njëjtën kohë me procesin e planifikimit, në krahasim me VSM-në e cila është ndërmarrë (kryesisht) si vlerësim pasues. Pasi që legjislati i VSM-së është miratuar, më 2014, shumë nga proceset e planifikimit tashmë në proces ngadalë janë përshtatur dhe VSM-ja është integruar gradualisht në praktikën e planifikimit hapësinor, siç ka ndodhur edhe në shumë vende të tjera Evropiane. Përveç kësaj, i gjithë procesi i planifikimit hapësinor në vetvete është i ri për komunat e Kosovës dhe kërkon shumë testim shtesë për përmirësimin e aspekteve kyçe, si pjesëmarrja e publikut ose disponueshmëria dhe shfrytëzimi i të dhënave të duhura. Prandaj, kufizimet kryesore që lindin nga kjo përvojë janë ato që zakonisht priten në sistemet e reja të themeluara të VSM-së. Një pasqyrë e këtyre pikave kyçe që kërkojnë vëmendje të veçantë për të përmirësuar efektivitetin e proceseve të VSM-së në Kosovë është paraqitur në tabelën 1.2.1. Sugjerimet për atë se si të adresohen këto pika do të jepen në kapitujt e ardhshëm, ashtu siç është e detajuar në tabelë.

**Tabela 1.2.1 Pikat kyçe për përmirësim dhe ku të gjendet udhëzimi në këta udhëzues**

Pika kyçe	Komentet	Ku të gjendet udhëzimi
<b>Studimi bazë</b>	<i>Mungesa e të dhënave kyçe: ky aspekt është i lidhur me përparimin e përmirësimit të përgjithshëm të disponueshmërisë së të dhënave mjedisore në Kosovë. Aktualisht, kjo ende është çështje kritike. Përveç kësaj, studimet bazë për VSM-në mund të organizohen në mënyrë më efektive, në një mënyrë që lejon përgjigjen në pyetjet kyçe të paraqitura në seksionin 3.1.2.</i>	Seksioni 3.1.2
<b>Shqyrtimi</b>	<i>Shqyrtimi i VSM-së është kryer, në mënyrë eksplicite ose më pak eksplicite, në shumicën e përvojave të mëparshme të VSM-së në Kosovë. Ai mund të përmirësohet në praktikë në të ardhmen duke siguruar një shpjegim më të</i>	Seksionet 3.1.1, 0, 3.1.4

	<p>arsyeshëm për zgjedhjen e çështjeve kyçe, si dhe me përfshirjen e organeve konsultative në fazën e studimit, i cili kërkohet nga legjislacioni. Gjithashtu rekomandohet prodhimi një raporti të ndarë studimi dhe mbajtja e një debati të parë publik për të qartësuar çështjet e studimit dhe ato themelore, edhe pse nuk kërkohet nga legjislacioni.</p>	
<b>Procesi i konsultimit</b>	<p>Ky ka qenë një aspekt kritik, duke pasur parasysh se shumë VSM janë përgatitur më pas. Megjithatë, shumica e proceseve të VSM-së kanë pasur një formë konsultimesh, të paktën me organet dhe autoritetet e zgjedhura, në mos edhe me publikun e gjerë. Konsultimi është i rregulluar në mënyrë mjaft rigoroz me Ligjin për VSM-në, siç përshkruhet në Kapitullin 2.2. Kapitulli gjithashtu jep disa rekomandime të përgjithshme nga praktikatat më të mira ndërkombëtare dhe një listë të organeve të mundshme konsultative për Kosovën.</p>	Seksioni 2.3.1, 2.3.3 dhe 2.3.4
<b>Metodat e vlerësimit të ndikimit</b>	<p>Jo të gjitha raportet e VSM-së kanë kryer analizë të përputhshmërisë së objektivave të PZHK-së kundrejt objektivave të VSM-së. Kjo është e kuptueshme duke pasur parasysh që objektivat e PZHK-së janë identifikuar në fillim të procesit, ndërsa shumica e VSM-ve kanë filluar më vonë (ose janë përgatitur më pas). Megjithatë, analiza e pajtueshmërisë së objektivave të planit është kyçe dhe element i vërtetë strategjik i VSM-së, dhe duhet çdo herë të përfshihet. Sugjerime dhe shembuj janë dhënë në seksionin 3.2.3.</p> <p>Përdorimi i analizave me bazë në GIS ka qenë mjaft i kufizuar në VSM, për shkak edhe të mungesës së të dhënave të duhura. Në të ardhmen, disponueshmëria e të dhënave të GIS-it është e lidhur me rritjen në Kosovë, dhe do të kërkohet përdorimi i tyre në VSM për planifikimin hapësinor.</p> <p>Efektet kumulative rrallë janë adresuar, pavarësisht se janë element qendror i VSM-së. Disa sugjerime në këtë pikë janë paraqitur në nenin 3.2.3</p>	Seksioni 3.2.1 dhe 3.2.3
<b>Marrja parasysh e alternativave</b>	<p>Kjo është një pikë e ndjeshme për proceset e VSM-së (jo vetëm në Kosovë). Përvojat e fundit përqëndrohen kryesisht në alternativa të pa planifikuara kundrejt alternativave të planit, ose në një grup të kufizuar të skenarëve alternativë të para-përcaktuar. Megjithatë, plani përbëhet nga shumë vendime, ku secili është i përbërë nga disa alternativa të mundshme, të cilat duhet të adresohen nga VSM-ja. Marrja në konsideratë e alternativave mund të përmirësohet me fuqizimin e integritetit midis proceseve të planifikimit dhe të VSM-së, dhe duke siguruar se të gjitha llojet përkatëse të alternativave janë adresuar (shih "hierarkinë e alternativave" dhe shembujt e krahasimit alternativ të paraqitur në Seksionin 3.2.2)</p>	Seksioni 3.2.2
<b>Struktura e raportit</b>	<p>Disa raporte të VSM-së janë të pabalancuara, në atë që më së shumti u janë përkushtuar përshkrimet të elementeve "hyrëse" (legjislacioni, përkufizimi, baza e mjedisit), se sa kryerjes së vlerësimit aktual dhe kontributimi në zhvillimin e planit. Sa më shumë VSM që do të kryhen në Kosovë, aq më pak do të ketë nevojë për prezantime të përgjithshme mbi VSM-në, në kontekstin e Kosovës, etj. Një strukturë më e balancuar për përmbajtjen e raportit të VSM-së, si dhe kriteret e cilësisë që mund të përdoren gjatë përmbledhjes, mund të gjenden në Kapitullin 3.3.</p>	Kapitulli 0
<b>Masat lehtësuese</b>	<p>Masat e propozuara lehtësuese janë kryesisht të përgjithshme dhe i referohen veprimeve të lidhura me projektin që mund të ndërmerren për të zvogëluar ndikimet mjedisore (p.sh. ndërhyrjet në gjelbërim). Megjithatë, VSM-ja mund të propozojë shumë lloje të ndryshme lehtësirash (fiskale, rregullatore, arsimore, teknike, etj) që mund të zbatohen tek një element tjetër i planit</p>	Seksioni 3.2.4

hapësinor. Kësi lloj lehtësimesh si dhe shembujt përkatës, janë dhënë në seksionin 3.2.4.

Masat lehtësuese nuk janë propozuar me një hierarki logjike, siç duhet të pritet në vlerësimin e ndikimit. Kjo hierarki, me shembuj relevante, është përshkruar në nenin 3.2.4.

**Plani i monitorimit**

Shumica e VSM-ve propozojnë një listë të treguesve të monitorimit, se sa një plan aktual të monitorimit. Ky i fundit kërkon, përveç përshkrimin e treguesve, edhe informatat për: shpeshësinë e grumbullimit të të dhënave; Përgjegjësinë për mbledhjen e të dhënave; vlerësimin (çfarë të bëhet me të dhënat e mbledhura? Si të interpretohen?), dhe reagimin e menaxhmentit (si të arrihen rezultatet e monitorimit që nuk janë në përputhje me parashikimin e ndikimit?). Karakteristikat e planeve të mira të monitorimit janë paraqitur në Kapitullin 3.5

Kapitulli 3.5

### 1.3 Si do kontribuojë VSM-ja në promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm në Kosovë?

VSM-ja është mjet për përmirësimin e cilësisë së përgjithshme të planifikimit dhe programimit të veprimeve të ardhshme, në atë që ka të bëjë me perspektivën e saj mjedisore. Duke vepruar kështu, kjo mundëson kuptimin dhe programimin më të mirë të të gjitha aktiviteteve mjedisore, duke lehtësuar një perspektivë të integruar të planifikimit të qëndrueshëm hapësinor. Këto aktivitete mund të jenë të ndryshme, por është e rekomandueshme që ndryshimet klimatike dhe biodiversiteti<sup>10</sup> të jenë dy nga komponentet e forta të praktikës së VSM-së në Kosovë.

Pasojat e para të ndryshimeve klimatike tashmë janë vërejtur në Evropë dhe në mbarë botën, me ndikimet që parashikohen të intensifikohen në vitet në vijim, duke rritur gjasat e fatkeqësive natyrore që lidhen me motin. Menaxhimi i riskut nga fatkeqësitë po bëhet aspekt qendror që merret parasysh në planifikimin hapësinor, si dhe efektet në komunitetet, duke përfshirë pronën dhe rentabilitetin, pritet që të rritet në dekadat e ardhshme, për shkak të ndryshimit të klimës. Prandaj, adaptimi ndaj ndryshimeve klimatike dhe masat për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë mund të konsiderohet si vendimtare për të përballuar ndikimet e ardhshme negative të rreziqeve natyrore dhe lehtësimin e rreziqeve eventuale<sup>11</sup>.

Duke adresuar politikë-bërjen dhe të menduarit strategjik nga fazat e hershme të tij, VSM-ja mund të luajë rol të rëndësishëm në forcimin e iniciativave e integritimit mjedisor, duke vënë theksin në zhvillimin e qëndrueshëm: përcaktimin e prioriteteve që nuk do ta rrezikojnë të ardhmen dhe janë të bazuara në një ekuilibër të qartë në mes të mjedisit, shoqërisë dhe kornizave ekonomike.

Përgjigjet për ndryshimin e klimës janë të strukturuar zakonisht në dy sferat kryesore të punës, që duhet të merren parasysh dhe integrohen përmes VSM-së:

- Masat lehtësuese - masat që bëjnë shmangien, zvogëlimin, sanimin apo kompensimin për ndikime të domethënëse negative të një veprimi strategjik në mjedis.
- Adaptimi - është proces, ose grup i iniciativave dhe masave, për të reduktuar ndjeshmërinë e sistemeve natyrore dhe njerëzore kundër efekteve të tanishme apo të pritshme të ndryshimeve klimatike. Adaptimi gjithashtu mund të paramendohet si të mësuarit me atë se si të jetojmë me pasojat e ndryshimeve klimaterike.


Planifikimi hapësinor mund të ketë efekt pozitiv në rritjen e lidhjeve reciproke në mes adaptimit ndaj ndryshimeve klimatike dhe aktiviteteve të propozuara lehtësuese: përshtatja e masave të caktuara ka për shembull dobi lehtësuese. Një nga rolet e VSM-së është kërkimi për adresimin konfliktive dhe sinergjive të mundshme në mes këtyre masave dhe shmangien e 'keq adaptimit' (p.sh., masat të cilat kërkojnë të përmirësojnë përshtatjen ndaj rreziqeve natyrore në fakt

<sup>10</sup> Për këtë çështje shih Komisioni Evropian (2013), *Guidance on Integrating Climate Change and Biodiversity into Strategic Environmental Assessment*.

<sup>11</sup> Korniza Hyogo për Veprim (2005) tërheq nga ky parim të stimulojë hapat drejt zbatimit të masave të duhura për zvogëlimin e rrezikut të fatkeqësive, duke bashkëpunuar në ndërtimin e aftësive ripërtëritëse të kombeve dhe komuniteteve lokale.

mund të rrisin cenueshmërinë). Udhëzuesi i BE-së për këtë çështje propozon që VSM-ja duhet të bëjë një "vlerësim gjithëpërfshirës të lidhjeve mes lehtësimit të ndryshimeve klimatike, përshtatjen dhe çështje të tjera mjedisore dhe problemeve politike, për të iu shmangur rrezikut të sinergjisë negative dhe politikave jo konsistente; si dhe mundësitë e humbura për eksplorimin dhe promovimin e sinergjive pozitive; dhe alokimi nën-optimal i burimeve dhe reagimeve politike."<sup>12</sup>

**Fig 1.3.1 VSM-ja si pjesë e procesit të planifikimit strategjik**



**Burimi: UNEP (2014) Integrating ecosystem services in Strategic Environmental Assessment: A guide for practitioners**

<sup>12</sup> Komisioni Evropian (2013) *Guidance on Integrating Climate Change and Biodiversity into Strategic Environmental Assessment*, Bashkimit Evropian, fq. 21 [<http://ec.europa.eu/environment/eialsea-support.htm>]

## II. METODOLOGJIA E VSM-SË PËR PLANET HAPËSINORE NË KOSOVË

Qasjet gjithëpërfshirëse të planifikimit hapësinor duhet të ndikojnë në zhvillimin e qëndrueshëm, duke balancuar zhvillimin njerëzor/shoqëror me zhvillimin mjedisor dhe ekonomik. Mjetet për identifikimin e ndikimeve mjedisore mund të përbëjnë listat kontrolluese, matricat, analizat e rrjetit, mbulimet dhe sistemet informative gjeografike (GIS), sistemet e ekspertëve dhe / ose gjykimin profesional. Kriteret për zgjedhjen e një mjeti të veçantë duhet të bazohen në llojin dhe madhësinë e propozimit, llojet e alternativave në shqyrtim, natyrën dhe shtrirjen e ndikimeve të mundshme, disponueshmërinë e ndikimit të metodave të identifikimit, përvojën e ekipit dhe burimet e disponueshme (koston, informacionin, kohën, personelin).<sup>13</sup>

Përderisa qasje të ndryshme metodologjike për vlerësimin strategjik mjedisor lejojnë mundësitë e ndryshme të ndikojnë në vendim strategjik, Shoqata Ndërkombëtare për Vlerësimin<sup>14</sup> e Ndikimit deklaron se procesi i VSM-së duhet të paraqesë kriteret e performancës si në vijim:

- Të jetë integruar (duke siguruar një vlerësim të duhur mjedisor të të gjitha vendimeve strategjike relevante për arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm; adresimin e ndërlikimeve të aspekteve biofizike, shoqërore dhe ekonomike dhe duke pasur parasysh politikën në sektorët përkatës dhe rajonet ndërkufitare);
- Të udhëhiqet nga qëndrueshmëria, duke lehtësuar identifikimin e opsioneve zhvillimore dhe propozimeve alternative që janë më të qëndrueshme.
- Të përqendrohet në sigurimin e të dhënave të mjaftueshme, të besueshme dhe të përdorshme për planifikimin e zhvillimit dhe vendimmarrjes, duke u përqendruar në çështjet kyçe të zhvillimit të qëndrueshëm, të përshtatura me rrethanat e procesit të vendimmarrjes dhe të jetë me kosto dhe kohë -efektive.
- Të jetë i përgjegjshëm (duke qenë përgjegjës i agjencive kryesore për vendimin strategjik që do të marrë, që të kryhet me profesionalizëm, ashpërsi, drejtësi, paanësi dhe ekuilibër, që i nënshtrohet kontrolleve dhe verifikimit të pavarur, që dokumentojnë dhe justifikojnë se si çështjet e qëndrueshmërisë janë adresuar në vendimmarrje).
- Të jetë pjesëmarrës, informues dhe përfshijë publikun e prekur dhe të interesuar nga organet qeveritare përmes procesit të vendimmarrjes, për të adresuar të dhënat dhe shqetësimet e tyre në dokumentim dhe vendimmarrje, duke ofruar kërkesa lehtë kuptueshme dhe të qarta dhe duke siguruar qasje të mjaftueshme në të gjitha informatat relevante.
- Të ri-përsëritet, duke siguruar disponueshmërinë e rezultateve të vlerësimit mjaft herët për të ndikuar në procesin e vendimmarrjes dhe të frymëzojë planifikimin e ardhshëm, duke ofruar informata të mjaftueshme mbi ndikimet aktuale të zbatimit të një vendimi strategjik, për të vlerësuar nëse ky vendim duhet të ndryshohet dhe për të siguruar një bazë për vendimet e ardhshme.

### 2.1 Shqyrtimi/ekzaminimi

#### 2.1.1 Kur kërkohet VSM-ja për planifikim hapësinor?

Sipas Ligjit të Kosovës për VSM-në, VSM-ja vlen vetëm për planet dhe programet (PP) që i nënshtrohen përgatitjes dhe / ose miratimit nga një autoritet në nivel kombëtar, rajonal ose lokal; ose PP-të që janë të përgatitura nga një autoritet për miratim nëpërmjet një procedure legjislativë, rregullatore ose administrative nga Parlamenti apo Qeveria. Përveç kësaj, ajo nuk aplikohet në PP-të në sektorët si në vijim: mbrojtjen kombëtare, emergjencën civile, çështjet financiare dhe buxhetin.

VSM-ja në Kosovë është e detyrueshme për rastet e mëposhtme<sup>15</sup>:

<sup>13</sup> Në këtë temë shih *Qendrën Rajonale e Mjedisit për Evropën Qendrore dhe Lindore (2003) VNM manual i burimeve të trajnimit për Evropën Juglindore, Szentendre, REC 2003*

<sup>14</sup> *Shoqata Ndërkombëtare për Vlerësimin e Ndikimit (2002) Vlerësimi Strategjik Mjedisor: Kriteret e performancës, IAIA Publikim i veçantë Seria Nr. 1 [Shih: <http://www.iaia.org/publicdocuments/special-publications/sp1.pdf>]*

<sup>15</sup> Këto kushte janë të ngjashme me ato të përcaktuara nga Direktiva e VSM-së, edhe pse ka disa dallime më të rëndësishme janë: a) Direktiva e VSM-së kufizon PP-të që i nënshtrohen VSM-së sipas kushteve 2 në zonat e mbrojtura sipas direktivës së habitatit (dmth, e

Planet dhe Programet (PP-të) që janë të përgatitura për planifikim hapësinor, planifikim urban, shfrytëzim të tokës, bujqësisë, pylltarisë, peshkatarisë, gjuetisë, energjisë, industrisë, minierave, trafikut, menaxhimit të mbeturinave, menaxhimit të ujërave, telekomunikacionit, turizmit, dhe që japin një kornizë për projektet e ardhshme të zhvillimit të cilat i nënshtrohen VNM-së në bazë të Ligjit të VNM-së;

1. PP-të që marrin në konsideratë vendndodhjen ku zbatohen, mund të kenë një efekt mbi zonat e mbrojtura, në habitatet natyrore, si dhe florës e faunës së egër.
2. Llojet e tjera të PP-ve, vetëm nëse ato janë të përcaktuara nga "ekzaminimi" (dmth. nga procedurat e përcaktimit rast-pas-rasti) që ka të ngjarë të kenë efekte domethënëse mjedisore;
3. Modifikime të vogla të PP-së dhe PP për zonë të vogël në nivel lokal, vetëm nëse ato janë të përcaktuara nga "ekzaminimi" që ka të ngjarë të kenë efekte domethënëse mjedisore.

Një vërejtje e rëndësishme është që gjendja 1 përcakton se VSM-ja është e nevojshme për sektorë të caktuar të PP-ve, por vetëm në qoftë se ato japin një kornizë për projektet e ardhshme të zhvillimit të cilat i nënshtrohen VNM-ve në bazë të Ligjit të VNM-së. Kuptimi i "paraqitjes së një kornize për projektet e ardhshme të zhvillimit" është vendimtare për interpretimin, edhe pse nuk ka ndonjë përkufizim në tekst. E njëjta gjë ka ndodhur me Direktivën e VSM-së, por më vonë është qartësuar se për të vendosur korniza "zakonisht do të thotë se plani ose programi përmban kriteret apo kushte të cilat udhëzojnë mënyrën të cilën autoriteti miratues e vendos për miratimin e zhvillimit". Kriteret e tilla mund të kufizojnë llojin e aktivitetit apo zhvillimit i cili do të lejohet në një zonë të caktuar; ose mund të përmbajnë kushtet të cilat duhet të përmbushen nga aplikuesi në qoftë se leja jepet; ose ato mund të jenë të dizajnuara për të ruajtur karakteristikat e caktuara të zonës në fjalë (të tilla si përzierje të përdorimit të tokës e cila promovon vitalitetin ekonomik të zonës).<sup>16</sup> Atëherë , një interpretim i ngjashëm duhet të zbatohet edhe për Ligjin Kosovës për VSM.


Diagrami/figura e mëposhtme ilustron procesin që duhet ndjekur për të përcaktuar nëse VSM-ja është e nevojshme për një PP të caktuar. Kutia e theksuar në gri i referohet përcaktimit rast pas rasti (i quajtur edhe "ekzaminim"), i cili do të përdoret për të vendosur nëse e VSM-ja është e nevojshme ose jo për lloje të caktuara të PP-ve. Kjo është zgjeruar në seksionin tjetër.

---

*ashtuquajtura NATURA 2000 sites), ndërsa Ligji i Kosovës për VSM-në është më i përgjithshëm dhe adreson të gjitha zonat e mbrojtura të natyrës, gjithashtu edhe habitatet natyrore si dhe florën dhe faunën madje edhe nëse nuk janë të mbrojtura; b) Direktiva e VSM-së kufizon PP-të që i nënshtrohen VSM-së sipas kushteve 3 për ato që "përcaktojnë kornizën për pëlqimin e ardhshëm të zhvillimit", ndërsa Ligji i Kosovës nuk e përfshinë këtë kusht.*

<sup>16</sup> Komisioni Evropian (2003) Zbatimi i Direktivës 2001/42/EC mbi vlerësimin e efekteve të disa planeve dhe programeve mbi Mjedisin, Bruksel, p. 10, [[http://ec.europa.eu/environment/eial/pdf/030923\\_sea\\_guidance.pdf](http://ec.europa.eu/environment/eial/pdf/030923_sea_guidance.pdf)]

**Fig 2.1.1 Aplikimi i ligjit të VSM-së për planet dhe programet (PP)**



- Në nivel qendror:
  - Plani Hapësinor i Kosovës
  - Harta Zonale e Kosovës
  - Plani Hapësinor për Zonat e Veçanta
- Në nivel lokal:
  - Plani Zhvillimor Komunal
  - Harta Zonale Komunale

Hartat zonale komunale janë të përfshira në listë në bazë të kushteve të përcaktuara në legjislacionin<sup>17</sup> e Kosovës për VSM-në. Për shembull, duke identifikuar banimin, përdorimin e përzier dhe sektorët industrial të ardhshëm (që janë dispozita tipike të hartës zonale), një plan përcakton kornizën për projektet e ardhshme zhvillimore të cilat do i nënshtrohen VNM-së, prandaj ajo duhet të jetë subjekt i VSM-së. Modifikime të vogla të dokumenteve të planifikimit të përmendura më sipër, apo dokumentet e planifikimit që përcaktojnë përdorimin e zonave të vogla në nivel lokal, i

<sup>17</sup> Shih gjithashtu shpjegimin në ekzaminimin e ofruar më sipër, 2.1, kushti 1.

nënshtrohen VSM-së vetëm nëse ato janë të përcaktuara nga "ekzaminimi" me gjasë të kenë efekte domethënëse mjedisore, siç përshkruhet në seksionin e ardhshëm.

### 2.1.2 Kur duhet bërë ekzaminimi?

Përcaktimi i "ekzaminimit" rast- për-rast se a është VSM e nevojshme apo jo, është i rregulluar me nenin 5 të Ligjit për VSM-në. Ky përcaktim është ndërmarrë për:

- Llojet e PP-ve për të cilat kërkohet VSM-ja (shih 2.1.1) nëse ato përcaktojnë përdorimin e zonave të vogla në nivel lokal, ose nëse ato janë modifikime të vogla që nuk kërkojnë procedurë të rregullt për miratim;
- PP-ja e llojeve tjera (Ligji përdorë fjalët "planet dhe programet të cilat nuk përcaktohen në paragrafin 2 të Nenit 3"). Si e tillë, ajo mund potencialisht të përfshijë ndonjë plan tjetër (me përjashtim të atyre që hyjnë në kategoritë e Nenit 3.4 (mbrojtja kombëtare, emergjenca civile, etj)).

Për të sqaruar kuptimin e termave kyçe të tilla si "zona të vogla", "nivel lokal", dhe "modifikime të vogla", udhëzimi i KE-së mund të referohet:

- "ona të vogla në nivel lokal "duhet të vendoset rast pas rasti dhe interpretimi do të ketë nevojë për ushtrim të kujdesshëm të gjykimit. Lloji i PP-ve të parashikuara mund të jetë një "plan ndërtimi i cili, për një zonë të caktuar, të kufizuar, përshkruan detajet se si duhet të ndërtohet ndërtesa, duke përcaktuar, për shembull, lartësinë e tyre, gjerësinë apo dizajnin;"<sup>18</sup>
- Sa i përket shprehjes "niveli lokal", edhe pse legjislacioni nuk krijon një lidhje të qartë me autoritetet lokale, fjala "nivel" nënkupton një kontrast me, për shembull, nivelet rajonale apo kombëtare. Prandaj, qëllimi i shprehjes së plotë "zona të vogla në nivel lokal" është se një PP për tërë territorin e një zone të autoriteteve lokale nuk duhet të përjashtohet nga VSM-ja;<sup>19,19</sup>
- Modifikime të vogla mund të konsiderohet në lidhje me mundësinë që kanë efektet e tyre domethënëse mjedisore. Neni 3 i Direktivës për VSM-në sqaron se " një modifikim mund të jetë i një rendi të vogël dhe nuk ka gjasë që të ketë efekte domethënëse mjedisore". "Kur modifikimi i një plani ose programi ka të gjasë të kenë efekte domethënëse mjedisore atëherë duhet të kryhet një vlerësim, pavarësisht nga shkalla e modifikimit."<sup>19</sup>

Duke marrë parasysh vërejtjen e mësipërme, mund të konkludohet se në parim ekzaminimi mund të ndërmerret për modifikime të vogla që nuk kërkojnë procedurë të rregullt për ratifikimin e të gjitha dokumenteve të planifikimit hapësinor që normalisht u nevojitet VSM-ja, përkatësisht:

- Në nivel qendror:
  - Plani Hapësinor i Kosovës
  - Harta Zonale e Kosovës
  - Plani Hapësinor për Zonat e Veçanta
- Në nivel lokal:
  - Plani Zhvillimor Komunal
  - Harta Zonale Komunale
  - Planet i detajuar rregullues

Megjithatë, për shumicën e modifikimeve të dokumenteve të planifikimit hapësinor në nivel qendror mund të jetë më e përshtatshme që të ndërmerret direkt procedurat e VSM-së, duke pasur parasysh zonat e mëdha dhe të popullsinë e përfshirë.

### 2.1.3 Si duhet kryer ekzaminimi?

Ekzaminimi kryhet nga autoriteti përgjegjës, pasi të jetë konsultuar me organet konsultative. Autoriteti prodhon një deklaratë që përmban arsyet për përcaktimin, e cila duhet të bazohet në kriteret e përcaktuara në Ligjin e VSM -së. Shtojca 1 Këto kriteret janë të ndara në dy grupe.

<sup>18</sup> Komisioni Evropian (2013) Udhëzues për Integrimin e Ndryshimeve Klimatike dhe Biodiversiteti në Vlerësimin Strategjik Mjedisor, Bashkimi Evropian [<http://ec.europa.eu/environment/eia/sea-support.htm>]

<sup>19</sup> Përveç nëse komuna është vetë e vogël, në të cilin rast një procedurë e shqyrtimit mund të jetë e këshillueshme për të përcaktuar nevojën për VSM.



Grupi i parë përfshin kriteret që i referohen karakteristikave të planit ose programit:

- shkallën në të cilën një plan ose program përcakton kuadrin e projekteve dhe të aktiviteteve të tjera, ose lidhja e tyre me vendndodhjen, natyrën, madhësinë dhe kushtet operuese ose me burimet e përcaktuara;
- shkallën në të cilën plani ose programi influencën plane dhe programe të përfshira dhe ato në hierarki;
- lidhjen e planit ose programit për integrimin e konsideratave mjedisore në veçanti në lidhje me promovimin e një zhvillimi të qëndrueshëm;
- probleme mjedisore që lidhen me planin ose programin;
- përputhshmërinë e një plani ose programi për zbatimin e legjislacionit të Komunitetit mbi mjedisin (p.sh planet dhe programet e lidhura me menaxhimin e mbetjeve dhe mbrojtjen e ujit).

Grupi i dytë përfshin kriteret që i referohen karakteristikave të efekteve dhe të zonave që mund të preken:

- probabilitetin, kohëzgjatjen, frekuencën dhe kthyeshmërinë e efekteve;
- natyrën kumulative të efekteve;
- natyrën ndërkuftare të efekteve;
- rrezikun e shëndetit të njeriut mbi mjedis (psh si shkak i aksidenteve);
- shkallën dhe shtrirjen hapsinore të efekteve (zona gjeografike dhe madhësia e popullsisë që mund të preken);
- vlerën dhe cënueshmërinë e zonës që ka të ngjarë të ndikohet si rezultat i:
  - karakteristikave të veçanta natyrore ose trashëgimisë kulturore,
  - standardeve mjedisore të tepërta dhe vlerave limit,
  - përdorimit intensiv të tokës;
- efektet mbi zonat ose sipërfaqet që kanë një status të njohur kombëtar, Komunitar ose ndërkombëtar mbrojtës.

Për të mbështetur autoritetin përgjegjës në prodhimin e deklaratës lidhur me përcaktimin, ky udhëzues propozon përdorimin e dy listave kontrolluese të thjeshta të dhëna në tabelat e mëposhtme. Këto listat kontrolluese ndihmojnë në identifikimin e çështjeve shqetësuese, dhe në raportimin e tyre në mënyrë të përmbledhur që mund të përdoret për të bashkëvepruar me organet konsultative, dhe për të arritur në një konkluzion nëse një plan apo program i dhënë duhet t'i nënshtrohet VSM-së apo jo. Listat kontrolluese të plotësuara mund të bashkëngjiten më pas si shtojca në deklaratën përfundimtare.

**Tabela 2.1.1 Karakteristikat e planit ose programit. Për secilën nga pesë kriteret e cekura në shtojcën 1 të Ligjit të VSM-së, një po / jo pyetje është dhënë. Në rast se përgjigja është pozitive, janë dhënë disa pyetje më specifike**

Kriteri 1		
<i>A i përcakton PP-ja kornizën për projektet dhe aktivitetet tjera?</i>	<i>Po</i>	<i>Jo</i>
- <i>Për çfarë lloj të projekteve / aktiviteteve (p.sh., nxjerrjes së burimeve natyrore, përdorimit të tokës, transportit, infrastrukturës dhe shërbimeve, vendbanimeve urbane, bujqësi, etj )?</i>	<i>[ shto komentin ]</i>	
- <i>A janë ato projekte / aktivitete të listuara në legjislacionin e VNM-së ?</i>	<i>Po</i>	<i>Jo</i>
Kriteri 2		
<i>A ndikon PP-ja në PP-të e tjera ?</i>		
- <i>Cili PP dhe për çfarë sektori ?</i>	<i>[ shto komentin ]</i>	
- <i>A janë këto PP në nivel kombëtar apo lokal ?</i>	<i>[ shto komentin ]</i>	
- <i>A është ndikimi i detyruar të ndërhyjë në arritjet e objektivave cilësore mjedisore të këtyre PP-ve (p.sh., siç janë përcaktuar në VSM-të e tyre )?</i>	<i>[ shto komentin ]</i>	
Kriteri 3		

<i>A është PP-ja e rëndësishme në drejtim të integritetit të konsideratave mjedisore ?</i>	<i>Po</i>	<i>Jo</i>
- Çfarë çështje mjedisore / qëndrueshmërisë adreson PP-ja? (p.sh., uji, mbeturinat, energjia, biodiversiteti, etj .)	[ shto komentin ]	
- A konsiderohen këto çështje si prioritete në zonën e prekur nga korniza ekzistuese e politikave dhe planifikimit (p.sh., objektivat e vendosura nga Plani Hapësinor i Kosovës ose nga Plani Zhvillimor Komunal )?	[ shto komentin ]	
<b>Kriteri 4</b>		
<i>A ekzistojnë probleme mjedisore relevante për PP-të?</i>	<i>Po</i>	<i>Jo</i>
- Cilat janë ato ?	[ shto komentin ]	
- A konsiderohen këto probleme si çështje prioritare në zonën e prekur (p.sh., nga mjetet ekzistuese të planifikimit dhe politikave )?	[ shto komentin ]	
<b>Kriteri 5</b>		
<i>A është PP-ja e rëndësishme për zbatimin e legjislacionit të Bashkimit Evropian në mjedis ?</i>	<i>Po</i>	<i>Jo</i>
- Cili legjislacioni (p.sh. Direktiva e BE-së) dhe për cilin sektor?	[ shto komentin ]	
- Cila është gjendja aktuale e zbatimit të këtij legjislacioni në Kosovë (p.sh., mungon, ekzistues por nuk zbatohet plotësisht, etj.)	[ shto komentin ]	

**Tabela 2.1. 2 Karakteristikat e efekteve dhe zona që mund të ndikohet**

	Biodiversiteti, flora dhe fauna	Popullsia dhe shëndeti i njeriut	Toka dhe uji	Ajri dhe klima	Asetet materiale, trashëgimia kulturore dhe peizazhi
<b>Kriteri 1</b>					
<i>Probabiliteti i efekteve</i>					
<i>Kohëzgjatja e efekteve</i>					
<i>Shpeshtësia e efekteve</i>					
<i>Kthyeshmëria e efekteve</i>					
<i>Natyra kumulative e efekteve</i>					
<i>Natyra ndërkuftare e efekteve</i>					
<i>Shkalla dhe shtrirja hapësinore e efekteve (zona gjeografike dhe madhësia e popullsisë së prekur )</i>					
<b>Kriteri 2</b>					
<i>A paraqesin PP-të rreziqe për shëndetin e njeriut apo mjedisin (p.sh. për shkak të aksidenteve )?</i>				[po/jo]	
- Çfarë lloj kërcënimi dhe sa i mundshëm është ?				[ shto komentin ]	
- Cilët komponentë mjedisore / aspekte shëndetësore njerëzore ka gjasa të preken ?				[ shto komentin ]	
<b>Kriteri 3</b>					
<i>A ka kjo zonë karakteristika të veçanta natyrore ose trashëgimi kulturore ?</i>				[po/jo]	

-	<i>Cilat janë ato ?</i>	<i>[ shto komentin ]</i>
-	<i>A janë të vlefshme dhe / ose të pambrojtura ?</i>	<i>[ shto komentin ]</i>
<i>A ka tejkaluar kjo zonë standardet e cilësisë së mjedisit ose vlerat e pragut ?</i>		<i>[po/jo]</i>
-	<i>Cilat dhe për sa kohë ?</i>	<i>[ shto komentin ]</i>
-	<i>A ka kjo zonë një numër të madh të popullsisë ?</i>	<i>[ shto komentin ]</i>
<i>A karakterizohet kjo zonë me shfrytëzim intenziv të tokës ?</i>		<i>[ shto komentin ]</i>
<b>Kriteri 4</b>		
<i>A do të shkaktojnë efekte PP-të në zonat apo peizazhet të cilat kanë një vlerë kombëtare, të njohur ndërkombëtarisht dhe nga BE-ja ?</i>		
-	<i>Cilat janë ato ?</i>	
-	<i>Sipas cilit akt janë të mbrojtura?</i>	

Grupi i parë i kriterëve vlerësohen kundrejt çështjeve të mjedisit të renditura në Shtojcën II të legjislacionit të VSM-së. Qëllimi është që të sigurojë një vlerësim cilësor të llojit të efekteve që plani ose programi mund të prodhojnë mbi çështje të ndryshme mjedisore. Ky vlerësim mund të sigurohet nëpërmjet komenteve, ose duke përdorur një shkallë cilësore, të tilla si + + + / ---, ku + + + i referohet një përfitimi të madh pozitiv, dhe --- do të thotë një ndryshim i konsiderueshëm negativ. Kriteret e mbetura janë vlerësuar përmes një po / jo përgjigjeje, pasuar nga pyetjet më specifike, në rast se përgjigja është pozitive.

## 2.2 Shqyrtimi (Studimi)

Faza e parë e procesit të VSM-së përbëhet nga prezantimi dhe vlerësimi i gjendjes aktuale të territorit të adresuar dhe vendimit për fushëveprimin e raportit (niveli i detajimit dhe faktorëve që duhet të vlerësohen). Aktivitetet kryesore gjatë kësaj faze janë grumbullimi i të dhënave, identifikimi i potencialeve të zhvillimit dhe identifikimi i sfidave dhe nevojave kryesore. Është e rëndësishme që çështjet kryesore të identifikohen në këtë fazë fillestare, e cila do të jetë një bazë për të identifikuar qëllimet dhe objektivat për zhvillim në të ardhmen. Përkufizimi i kontekstit dhe objektivat e vlerësimit kërkon profilin strategjik me vëmendje të veçantë për dimensionin e saj, përparësitë dhe objektivat strategjike. Rishikimi i faktorëve kritik për strukturimin e vlerësimit strategjik është rezultat i kontekstit dhe shkallës në të cilën VSM-ja është kryer, në lidhje me integrimin e elementeve të mëposhtme (bazike dhe të fushëveprimi):

1. objektivat mjedisore për mbrojtjen, të themeluar në, Komunitetin Evropian, ndërkombëtar ose nivel kombëtar, të cilat janë relevante për planin dhe mënyrën si këto objektiva ose çështje mjedisore janë marrë parasysh gjatë përgatitjes së tij;
2. aspektet relevante të gjendjes aktuale të mjedisit dhe evolucionin e mundshëm të tij pa zbatimin e planit ose programit dhe karakteristikat mjedisore të zonave që mund të ndikohen në mënyrë të konsiderueshme;
3. problemet ekzistuese mjedisore që janë relevante për planin, duke përfshirë, në veçanti, ato që lidhen me zonat e një rëndësie të veçantë mjedisore.

Rishikimi i direktivave kombëtare dhe ndërkombëtare që lidhen me mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm duhet të konsiderohen në lidhje me propozimet strategjike të Planit Hapësinor. Ky studim i ndërlidhur do të lejojë zgjedhjen e një sërë temash të mjedisit dhe qëndrueshmërisë. Këto tema duhet të analizohen më tej, në mënyrë që të përcaktohen kriteret, qëndrueshmëria dhe indikatorët për VSM-në. Hapi i parë i procesit të vlerësimit të qëndrueshmërisë është të shikohet planet, politikat dhe programet relevante, mblidhen informatat bazë dhe identifikimi i çështjeve të qëndrueshmërisë në territorin në fjalë. Ky informacion përdoret pastaj për të zhvilluar objektivat e qëndrueshmërisë dhe një kornizë për vlerësimin e planit kundrejt tyre.

Raporti i shqyrtimit (studimit) është i detyrueshëm për disa legjislacione ndërkombëtare (p.sh. në Itali për rajonin e Lombardisë dhe në Mbretërinë e Bashkuar), por jo sipas ligjit të Kosovës. Megjithatë hartimi i tij është i

rekomandueshëm, sepse: 1) ndihmon në drejtimin dhe menaxhimin e procesit të konsultimit, dhe 2) jep një kontribut të parë dhe të prekshëm të procesit të VSM-së, i cili mund të tërheq vëmendjen e planifikuesve dhe vendimmarrësve.

Si praktikë më e mirë, është po ashtu e rekomandueshme (dhe e detyrueshme sipas disa legjislativioneve ndërkombëtare) që të mbahet një debat publik në këtë fazë, duke paraqitur raportin e shqyrtimit (studimit) në një takim, në të cilin janë të ftuar të organet konsultative dhe publiku i gjerë. Një angazhim i hershëm i publikut mund të përmirësojë procesin e pjesëmarrjes gjatë VSM-së / planifikimit, për të lejuar identifikimin e shpejtë të tensioneve dhe konflikteve, për të stimuluar një ndërveprim më produktiv dhe pozitiv, dhe për të lehtësuar përfundimisht marrjen e vendimeve në vazhdim.

## 2.3 Konsultimi

Konsultimi është një element i rëndësishëm i VSM-së, dhe kjo është pasqyruar në ligjin e VSM-së. Ligji e bën të qartë që konsultimi është pjesë e pandashme e vlerësimit mjedisor, dhe që rezultatet e konsultimeve duhet të merren parasysh gjatë vendimmarrjes. Siç thuhet në udhëzuesin e KE-së mbi VSM-në, "një nga arsytet për konsultim është që të kontribuojë në cilësinë e informatave në dispozicion për ata që janë përgjegjës për vendimet që janë bërë në lidhje me planin ose programin. Konsultimi mundet ndonjëherë të zbulojë informacione të reja të rëndësishme që çojnë në ndryshime substanciale të planit ose programit dhe rrjedhimisht efektet e saja të rëndësishme mjedisore. Në këtë rast, mund të jetë e nevojshme të merret në konsideratë një rishikim i raportit dhe, në qoftë se ndryshimet e justifikojnë këtë, të bëhen edhe konsultime të tjera".<sup>20</sup>

Në përgjithësi, proceset konsultative për mjetet e planifikimit ekzistues hapësinor në nivel kombëtar kërkojnë përfshirjen e një numri të madh të autoriteteve kombëtare dhe organeve, nga sektorë dhe fusha të ndryshme. Në të kundërtën, në nivel lokal, ky numër është zakonisht shumë më i vogël, dhe varet nga karakteristikat e çështjeve brengosëse të komunës (p.sh. Departamenti për ujë) mund të jetë një organ relevant nëse komuna përfshinë një ujëndarës strategjik për sigurimin e ujit, apo një agjenci gjeologjike nëse komuna përshinë zona të cilat i ekspozohen rrezikut të konsiderueshëm gjeologjik). Në proceset konsultative në nivel komunal, akterët lokalë duhet pa dyshim të luajnë një rol më të madh. Këto përfshijnë një shumëllojshmëri të organizatave formale dhe joformale të cilat janë të përfshira në aktivitete në terren në zonën e komunës (p.sh. sektori i tretë, institucionet arsimore, aleancat e lagjeve, etj) apo që ndajnë brenga të përbashkëta, që mund të jenë të rëndësishme për zonën (p.sh., shoqatat për mbrojtjen e mjedisit etj.). Organet e tjera konsultative mund të përfshijnë kapituj lokal të shoqatave profesionale. Në nivel kombëtar, organet konsultative janë zakonisht në shkallë më të lartë për të përfshirë shoqatat dhe grupet e interesi në nivel kombëtar. Kjo bëhet për të siguruar që pjesëmarrësit janë të përfshirë në nivelet e duhura. Për shembull, shpesh është e vështirë që grupet përfaqësuese vendore të marrin një perspektivë rajonale ose kombëtare, kur puna dhe interesat e tyre janë të përqendruar në një komunë të caktuar apo edhe lagje. Në mënyrë të ngjashme, organet në nivel kombëtar mund të jenë më pak të njohura me çështjet lokale.

### 2.3.1 Kërkesat për konsultim

Dispozitat e konsultimit janë të obligueshme që t'u japin një mundësi autoriteteve të caktuara dhe anëtarëve të publikut për të shprehur mendimin e tyre në faza të ndryshme të procesit, dhe pas përgatitjes së raportit të VSM-së dhe projekt planit ose programit. Më konkretisht, Ligji i VSM-së përmban kërkesat e mëposhtme për konsultim:

- Organet të cilat, për shkak të përgjegjësisë të tyre mjedisore, mund të jenë të brengosura nga efektet e zbatimit të planit ose programit, duhet të konsultohen lidhur me qëllimin dhe nivelin e detajeve të informatave që do të përfshihen në Raportin e VSM-së.
- Publiku dhe Organet konsultative duhet të konsultohen për projekt planin ose programin dhe Raportin Mjedisor, dhe duhet t'u jepet një mundësi e hershme dhe efektive brenda kornizave kohore të përshtatshme për të shprehur mendimet e tyre.
- Vendet e tjera duhet të konsultohen nëse plani ose programi mund të ketë efekte të rëndësishme në mjedis, në territoret e tyre.

<sup>20</sup> Komisioni Evropian (2003) Zbatimi i Direktivës 2001/42/EC për Vlerësimin e Efekteve të Planeve dhe Programeve të Caktuara mbi Mjedisin, Bruksel [[http://ec.europa.eu/environment/eia/pdf030923\\_sea\\_guidance.pdf](http://ec.europa.eu/environment/eia/pdf030923_sea_guidance.pdf)]

- Organet konsultative duhet të konsultohen për të shqyrtuar nëse VSM-ja është e nevojshme për planet dhe programet
- Të gjitha organet e konsultuara, autoritetet e huaja dhe publiku duhet të iu jepet qasje në informacion, dhe duhet të informohen lidhur me vendimin.

Kërkesat e konsultimit janë të detajuara në tabelën 2.3.1, e cila është e përshtatur me legjislacionin e Kosovës nga udhëzuesi i Komisionit Evropian për Direktivën e VSM-së.<sup>21</sup>

**Tabela 2.3.1 Përmbledhje e kërkesave për konsultim në fazat e ndryshme të VSM-së**

Fazat e VSM-së	Kërkesat për konsultim	Kërkesat shtesë në situata ndërkufitare
Përcaktimi nëse një plan ose program kërkon një VSM	<i>Konsultimi i organeve konsultative nëse shqyrtimi i "ekzaminimit" rast pas rasti është i nevojshëm (neni 5.2)</i>  <i>Informacioni i vënë në dispozicion për publikun përmes një faqe interneti dhe shpalljeve publike (neni 6.3)</i>	
Vendimi për fushëveprimin dhe nivelin e detajeve të vlerësimit	<i>Konsultimi i organeve konsultative (neni 7)</i>	
Raporti i VSM-së dhe projekt plani ose programi	<i>Informacioni i vënë në dispozicion për publikun (neni 8)</i>  <i>Konsultimi i organeve konsultative (neni 8)</i>  <i>Konsultimi i publikut dhe personave të cilët janë të prekur ose ka mundësi të ndikohen nga, ose kanë një interes në, vendimet e përfshira në plan ose program (neni 8)</i>  <i>Debati publik (Neni. 9)</i>	<i>Informacioni i vënë në dispozicion për vendet në fjalë (neni 10.3)</i>  <i>Konsultimi i organeve, organizatave jo-qeveritare dhe publike mjedisore (neni 10.4)</i>
Gjatë përgatitjes së planit ose programit	<i>Të merren në konsideratë mendimet e shprehura sipas nenit 8 (nenit 14)</i>	<i>Të merren në konsideratë mendimet e shprehura sipas nenit 10 (neni 14)</i>
Miratimi i planit ose programit	<i>Raport mbi pjesëmarrjen e publikut, organet konsultativ edhe debatit publik dërgohen në Ministri për miratim</i>  <i>Informacioni i vënë në dispozicion për organet konsultative dhe publikun (Neni 15)</i>	<i>Informacioni i vënë në dispozicion për autoritetet e vendit (Neni 15)</i>

### 2.3.2 Trupat konsultative dhe publiku

Trupat konsultative përcaktohen me Ligjin për VSM-në, të tilla si Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe trupat tjerë të përcaktuara me ligj duke pasur përgjegjësi specifike mjedisore dhe të cilat Ministria i konsideron të prekura nga plani ose programi i propozuar. Në rastet kur vet Ministria është autoritet përgjegjës i planit ose programit, atëherë konsultohet Komisioni (trup i propozuar nga ministri dhe i miratuar nga Qeveria sipas Ligjit për VSM). Një listë e trupave konsultative të mundshme për kontekstin e Kosovës është paraqitur në tabelën më poshtë. Kjo listë nuk është domosdoshmërisht shteruese, dhe disa prej trupave apo organeve të propozuara mund të mos jenë të rëndësishme në të gjitha proceset të VSM-së. Si e tillë, lista përfaqëson një referencë të përgjithshme që mund të

përdoret në fillim të VSM-së për të identifikuar një grup të trupave konsultative. Listat e trupave konsultative në mënyrë tipike do të zgjerohen dhe do të ndryshojnë me përparimin/progresin e VSM-së dhe çështjeve të tjera që në ndërkohë paraqiten apo që mund edhe të mos jenë më relevante.<sup>21</sup>

**Tabela 2.3.2 Lista e trupave të mundshme konsultative**

Lista e trupave të mundshme konsultative varësisht prej rastit dhe kontekstit
- <i>Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH)</i>
- <i>Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR)</i>
- <i>Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit</i>
- <i>Ministria e Shëndetësisë (MSH)</i>
- <i>Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK)</i>
- <i>Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike (nën MSH)</i>
- <i>Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV - nën Qeveri)</i>
- <i>Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (nën MBPZHR)</i>
- <i>Agjencia e Pyjeve të Kosovës (nën MBPZHR)</i>
- <i>Agjencia e Kosovës për Eficiencë të Energjisë - nën Ministrin e Zhvillimit Ekonomik (MZHE)</i>
- <i>Shërbimi Gjeologjik i Kosovës (nën MZHE)</i>
- <i>Departamenti i Ujit (nën MMPH)</i>
- <i>Divizioni për Kimikate dhe Mbeturinai (nën Departamentin e Mbrojtjes së Mjedisit, MMPH)</i>
- <i>Instituti për Mbrojtjen e Natyrës (nën AKMM, nën MMPH)</i>
- <i>Drejtoria Parku Kombëtar Bjeshkët e Nemuna</i>
- <i>Drejtoria Parku Kombëtar Sharr</i>
- <i>Shteti (fqinj) tek i cili mund të ketë efekte të theksuara në mjedis implementimi i një plani ose programi</i>

Përveç trupave konsultative, ligji parasheh përfshirjen e publikut, të përcaktuar si "një ose më shumë persona fizik ose juridikë, si dhe shoqatat, organizatat ose grupet e ndryshme". Të gjitha shoqatat, organizatat dhe grupet p.sh., OJQ-të mjedisore, shoqatat e fermerëve, shoqatat e lagjes, rrjetet e biznesit, shoqatat kulturore, etj të cilat mund të kenë interes në vendimet e përfshira në vlerësim duhet të informohen, dhe të përfshihen në procesin e konsultimit.

### 2.3.3 Rekomandimet

Në fazat e hershme të VSM-së, mund të jetë e dobishme përgatitja e një përmbledhje paraprake se si do të zhvillohen konsultimet. Ky përshkrim duhet të qartësojë se si do të plotësohen kërkesat e ligjit të VSM-së, dhe nëse konsultimet për VSM do të jetë pjesë e strategjisë më të gjerë konsultative për planin dhe programin.<sup>22</sup> Përshkrimi duhet të tregojë: 1. Çfarë informacione dhe dokumente do të jenë në dispozicion, se si mund të merren ato; 2. Si do të merren parasysh përgjigjet konsultative, dhe se si Autoriteti Përgjegjës do të sigurojë reagimet tek Konsulentët; 3. Cilat aktivitete konsultative do të kryhen?

<sup>21</sup> Zyra e Zëvendës Kryeministrit (2005) *A Practical Guide to the Strategic Environmental Assessment Directive*, Londër, Publikimet e ZZKM

<sup>22</sup> Zyra e Zëvendës Kryeministrit (2005) *A Practical Guide to the Strategic Environmental Assessment Directive*, Londër, Publikimet e ZZKM

Në lidhje me pikën e fundit, një numër i qasjeve dhe teknikave mund të përdoren për të mbështetur proceset e konsultimit. Këto përfshijnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse dhe përshkrimi mund të gjendet në UNEP<sup>23</sup>:

- Takimet publike, vendet e hapura për të gjithë, panele këshillëdhënëse;
- Intervistat, pyetësorët, anketat shtëpiake;
- Teknikat e vlerësimit me pjesëmarrje, analizat e palëve të interesuara dhe shenjëzimi (pasqyrimi);
- Fokus grupi, gazetatat, rrjetet sociale.

Zgjedhja e një forme të konsultimit varet nga aftësitë dhe njohuritë në dispozicion, buxheti dhe kufizimet kohore, çështjet specifike dhe konteksti lokal. Përveç kësaj, duhet pasur parasysh objektivat specifike të konsultimeve, të cilat mund të përfshijnë:<sup>24</sup>

- Marrjen e njohurive lokale dhe tradicionale përpara marrjes së vendimeve;
- Mundësimi i një konsideromi më të ndjeshëm të alternativave, masave lehtësuese dhe kompromiseve;
- Sigurimin se ndikimet e rëndësishme nuk janë anashkaluar dhe përfitimet janë maksimalizuar;
- Reduktimin e konfliktit nëpërmjet identifikimit të hershëm të çështjeve të diskutueshme;
- Krijimin e një ndjenjë të pronësisë së planit ose programit;
- Integrimin e dallimeve gjinore në përdorimin e burimeve;
- Përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënies të vendimmarrjeve;
- Rritjen e besimit të publikut në VSM dhe procesin e bërjes së planit.

Përveç kësaj, kufizimet e mëposhtme të mundshme mund të pengojnë pjesëmarrjen efektive, dhe duhet të konsiderohen me kujdes gjatë projektimit të aktiviteteve të konsultimit<sup>25</sup>:

- Varfëria: Përfshirja do të thotë koha e kaluar larg nga aktivitetet që gjenerojnë të ardhura;
- Zonat rurale: distancat e gjata e bëjnë komunikimin më të vështirë dhe të shtrenjtë;
- Kultura dhe çështjet gjinore: normat e sjelljes ose praktika kulturore mund të pengojnë përfshirjen e disa grupeve (p.sh., gratë);
- Grupet e interesit: mund të kenë pikëpamje të kundërta ose divergjente dhe interesa të jashtme.

Së fundi, është e rëndësishme që të sigurohet se pjesëmarrësit janë të përfshirë në shkallët dhe nivelet e duhura. Për shembull, shpesh është e vështirë për grupet përfaqësuese vendore të marrin një perspektivë rajonale, kur puna dhe interesat e tyre janë të përqendruar në një komunë të caktuar apo edhe lagje. Në mënyrë të ngjashme, organet në nivel kombëtar mund të jenë më pak të njohura me çështjet lokale.<sup>23</sup>


<sup>23</sup> UNEP (2009) *Vlerësimi i Integruar për përfshirjen e qëndrueshmërisë në Politikë-bërje: Një Manual Udhëzues*  
[<http://www.unep.ch/ETb/publications/AI%20guidance%202009/UNEP%20IA%20final.pdf>]

<sup>24</sup> A ABAZA, H., BISSET, R., SADLER, B. (2004) *Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis dhe Vlerësimi Strategjik Mjedisor: Drejt një qasje të integruar*, UNEP

### III. FAZAT E VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR

Ky kapitull ofron udhëzime hap pas hapi se si të kryhet një VSM, me referencë të veçantë për sektorin e planifikimit hapësinor. Udhëzuesi është strukturuar në 5 faza kryesore, dhe një numër i detyrave kryesore që lidhen me secilën fazë (shih Figurën 3.1.1). Fazat dhe detyrat janë mjaftueshmërisht të gjera për t'u zbatuar në çdo VSM. Megjithatë, VSM-ja duhet të jetë fleksibile dhe e përshtatur për nevojat dhe kontekstin e ushtrimit të planifikimit të caktuar, duke marrë parasysh çështjet e tilla si: kohën dhe kufizimet e burimeve, disponueshmëria e të dhënave, karakteristikat e vendimeve dhe dispozitave të planit. Fazat janë propozuar në një rend, i cili ndjek rendin ideal të fazave të planifikimit. Në praktikë, proceset e planifikimit dhe VSM-së nuk janë aq lineare, dhe përgjatë fazave dhe detyrave të ndryshme, shumë përsëritje dhe reagime janë zakonisht të nevojshme.

**Fig 3.1.1 Fazat dhe detyrat e VSM-së të propozuara në këtë udhëzues**



Qasja metodologjike e përdorur për zhvillimin e këtij udhëzuesi ka ndjekur rekomandimet ndërkombëtare dhe evropiane, duke përfshirë çështjet e fazave të nevojshme për të kryer vlerësimin:



### *Faza A: Përcaktimi i kontekstit dhe shqyrtimit (studimit)*

Kjo fazë identifikon kornizën strategjike, duke prodhuar një studim bazik për referencë në të ardhmen dhe identifikon çështjet kryesore mjedisore në interes dhe objektivat. Palët kryesore mjedisore të cilat do të marrin pjesë në proces gjithashtu mund të identifikohen dhe analizohen gjatë këtij procesi, me kujdes të veçantë për analiza të ndjeshme gjinore. Mënyrat e përfshirjes së grupeve të interesit në fushën e mjedisit dhe një kuptim paraprak të pikëpamjeve të tyre në lidhje me çështjet kryesore mjedisore mund të vendosen në këtë pikë, si një bazë për zhvillimin e ardhshëm të procesit. Çështja kryesore është adresimi dhe identifikimi i çështjeve kryesore mjedisore, duke përfshirë ndryshimet klimatike dhe / ose çështjet e biodiversitetit dhe të caktoj kufijtë e gjendjes në atë që i përket mjedisit (në lidhje edhe me aspekte që kanë të bëjnë me ndryshimet klimatike dhe biodiversitetin) dhe se si mund të ndryshohet në të ardhmen. Konteksti i politikës duhet të përcaktohet qartë dhe të vendosen objektivat dhe synimet.

### *Faza B: Mbështetja e projektimit të planit dhe vlerësimi i ndikimeve*

Pas prezantimit të informacionit të parë bazë në dispozicion dhe vendimit për vlerësimin e raportit (nivelein e detajimit dhe faktorët e pritshëm për t'u vlerësuar), objektivat e PP-ve dhe veprimet e programuara duhet të analizohen. Në këtë fazë, plani hapësinor ose programi do të testohen për të identifikuar potencialin e sinergjive ose mospërputhjeve ndërmjet objektivave të saj ndaj objektivave të VSM-së. Analiza duhet bashkëpunoj për të përsosur veprimet strategjike dhe të parashikoj efektet domethënëse mjedisore të PP-ve. Kjo është një fazë e rëndësishme, ku merren parasysh opsionet lehtësuese. Ligji i Kosovës për Vlerësimin Strategjik Mjedisor ofron një listë të kritereve për përcaktimin e rëndësisë së mundshme të efekteve të planifikimit në mjedis (në shtojcën 1 të saj).

Në këtë fazë skenarët e propozuar duhet të vlerësohen në aspektin e ndikimit të mundshëm të objektivave dhe veprimeve e propozuara mbi çështjet mjedisore kritike. Kjo mund të ndihmojë në vlerësimin e efekteve të parashikuara të planit dhe veprimeve të saj të programuara, dhe të ndihmojë për përsoshmërinë e planit duke prezantuar alternativat potenciale të zbatimit dhe duke pasur parasysh masat lehtësuese për çfarëdo ndikimi negativ të identifikuar. Procedurat e vlerësimit rrjedhin nga praktika e krijuar, duke vënë theksin në zgjerimin e masat lehtësuese dhe përmirësuese. Ligji i Kosovës për VSM gjithashtu kërkon analizën e efekteve të përfshijnë "efektet afatshkurtra, afatmesme, afatgjata, të përkohshme dhe të përhershme". Efektet mund të ndryshojnë me kalimin e kohës, dhe edhe pse shkaktojnë ndikim në afat të shkurtër, mund të kontribuojnë në afat të gjatë për shembull në zvogëlimin e ndotjes së ajrit ose gazeve serë.

### *Faza C: Përgatitja e raportit të VSM-së*

Hapi i ardhshëm është paraqitja e efekteve të parashikuara mjedisore të planit ose programit, në formën e një raporti që përfshin alternativa, dhe që është i përshtatshëm për konsultim publik dhe përdorim nga vendimmarrësit. Është e rëndësishme që raporti në mënyrë të qartë shpjegon se si janë vlerësuar alternativat e ndryshme, se si janë identifikuar çështjet kyçe, si është menaxhuar pasiguria, etj.

### *Faza D: Konsultimi dhe vendimmarrja*

Ligji i Kosovës për Vlerësimin Strategjik Mjedisor kërkon informacion në raportin e VSM-së dhe reagimet e marra gjatë konsultimeve të merren në konsideratë gjatë përgatitjes së planit ose programit dhe para se të merret vendimi përfundimtar për t'u miratuar (neni 14). Autoritetet përgjegjëse duhet të gjenerojnë një përmbledhje të asaj se si ata kanë marrë këto të gjetura në konsideratë, dhe si këto konsiderata mjedisore janë integruar në planin ose programin, me informacion të mjaftueshëm për të bërë të qarta ndryshimet e bëra ose alternativat e refuzuara.

Ligji thotë:

*Neni 14*

*Miratimi i planit ose programit*

*Autoriteti përgjegjës, merr parasysh raportin e VSM, rezultatet e konsultimeve përfshirë edhe konsultimet ndërshtetërore, gjatë përgatitjes së planit apo programit dhe para aprovimit.*

*Informacion për vendimin*

1. Pas miratimit të një plani ose programi, për të cilin është kryer një vlerësim strategjik mjedisor, autoriteti përgjegjës do të informojë trupat konsultativ, publikun, personat të cilët kanë qenë të konsultuar, nga neni 9 nën-paragrafi 2.2. dhe Ministrin që plani ose programi është miratuar, datën e miratimit të tij, adresën - e cila mund të përfshijë një ueb faqe se ku mund të shihet ose sigurohet kopja e tij dhe e raportit të VSM-së,

2. Ministri do të informojë vendin me të cilin janë zhvilluar konsultimet lidhur me planin ose programin për çështjet e referuara në paragrafin 1 të këtij neni.

3. Detajet e referuara në paragrafin 1. të këtij neni janë:

3.1. si janë integruar çështjet mjedisore në plan ose në program;

3.2. si është marrë parasysh raporti i VSM-së;

3.3. si janë marrë parasysh mendimet nga autoritetet konsultuese dhe publikut, përfshirë edhe konsultimet e publikut dhe ndonjë pikëpamje si rezultat i konsultimeve ndër shtetërore;

3.4. arsyet për zgjedhjen e planit apo programit të miratuar nga shqyrtimi i alternativave të tjera të arsyeshme; dhe

3.5. masat që do të merren për monitorimin e efekteve të dukshme mjedisore nga implementimi i planit ose programit.”

*Faza E: Monitorimi i zbatimit të Planit*

Në këtë fazë, performanca mjedisore e planit do të vlerësohet, sipas sistemit të monitorimit të themeluar më parë për zbatimin e planit. Efektet mbi ndryshimet klimatike dhe biodiversitetin, duhet të monitorohen, së bashku me zbatimin e masave lehtësuese dhe menaxhimin e mjedisit.

### 3.1 Faza A: Përcaktimi i kontekstit dhe objektivave, vendosja e bazës dhe shqyrtimit (studimit)

Procesi i VSM-së është më efektivë kur fillon në të njëjtën kohë me përgatitjen e planit. Në mënyrë ideale, kjo fazë kryhet në fazat shumë të hershme të planifikimit, dhe ka për qëllim sigurimin e informacionit të historikut për VSM-në që mund të përdoret për të udhëhequr identifikimin e çështjeve kryesore dhe objektivave të planit.

Kjo fazë përfshin detyrat e mëposhtme kryesore:

- a. Identifikimi i kornizës strategjike
- b. Hartimi i një studimi themelor apo bazë
- c. Shqyrtimi (studimi) i çështjeve mjedisore dhe propozimi i objektivave të VSM-së
- d. Konsultimi mbi fushëveprimin e VSM-së

#### 3.1.1 Identifikimi i Kornizës Strategjike

**Qëllimi.** Qëllimi është që të ofrojë informacion mbi planet dhe programet e tjera përkatëse (Ligji për VSM-në, Shtojca I, pika 1.2), si dhe në objektivat për mbrojtjen e mjedisit të përcaktuara në nivel kombëtar, KE dhe niveli ndërkombëtar (Ligji për VSM-në, Shtojca I, pika 1.5) të cilat duhet të merren në konsideratë gjatë përgatitjes të planit.

**Si?** Së pari, duhet të bëhen një listë e planeve dhe programeve përkatëse, si dhe objektivave mjedisore. Pastaj, elementet që janë të rëndësishme për planin në fjalë duhet të theksohen. Këto elemente duhet të sillen në vëmendjen e planifikuesve, me qëllim zvogëlimin e konflikteve dhe shfrytëzimin e sinergjive mes planit dhe kuadrit strategjik ekzistues.

Planet dhe programet relevante për kontekstin e Kosovës mund të përfshijnë:

- Plani Hapësinor i Kosovës dhe Harta Zonale e Kosovës;
- Plani Hapësinor i Zonave të Veçanta;
- Planet Zhvillimore komunale të komunave fqinje;

-Planet për sektorë ose aktivitete të veçanta, të tilla si Plani i Transportit, Plani i Banimit, Plani për Menaxhimin e Mbeturinave, Plani për Administrimin e Ujërave, Plani për Cilësinë e Ajrit, Plani i Veprimtimit Mjedisor, Plani i industrisë Minerale, Plani për Energji, Plani i Zhvillimit Ekonomik (në nivele të ndryshme gjeografike).

Objektivat përkatëse për mbrojtjen e mjedisit mund të vendosen nga politikat ose rregulloret, të tilla si për shembull:

-Legjislacioni kombëtar (p.sh., Ligji Nr. 02/L-26 mbi tokën bujqësore; Ligji nr 02/L-102 për mbrojtjen nga zhurma; Ligji Nr. 03/L-025 për mbrojtjen e mjedisit; Ligji Nr. 03/L-043 për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes; Ligji nr 03/L-104 Ligj për mbrojtje nga rrezatimi jo-jonizues, jonizues dhe sigurinë nukleare; Ligji nr 03/L-160 për mbrojtjen e ajrit nga ndotja; Ligji Nr.03/L-233 për mbrojtjen e natyrës; Ligji Nr.04/L-147 për Ujërat e Kosovës;

-Direktivat e KE-së (p.sh., Direktiva e Zogjve, Direktiva e Habitatit, Direktiva e Deponive, Direktiva e Përmblytjeve, Direktiva Kornizë e ujit, Direktiva për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes, Direktiva Kornizë për mbeturinat);

-Marrëveshjet ndërkombëtare dhe konventat (p.sh., Konventa kornizë e OKB-së për ndryshimet klimatike; Konventa mbi Diversitetin Biologjik).

### 3.1.2 Hartimi i një studimi themelor/bazë

**Qëllimi.** Gjenerimi i një studimi bazë me informacion në lidhje me kushtet mjedisore ka për qëllim të sigurojë bazën për vlerësimin e ndikimit të planit, dhe për fazën pasuese të monitorimit.

Si? Aspektet që do të përfshihen janë të shënuara në Aneksin 2 (biodiversiteti, popullsia, shëndeti i njeriut, flora, fauna, toka, uji, ajri, faktorët klimatik, asetet materiale, trashëgimia kulturore dhe natyrore, peizazhi, dhe ndërveprimi e tyre), por struktura e studimi themelor dhe rëndësia e dhënë aspekteve të ndryshme mund të jenë të përshtatura me planin specifik, me kusht që të jepen arsyttime të përshtatshme. Për shembull, energjia dhe zhurma nuk janë përmendur në mënyrë eksplicite, por ato mund të jenë shumë të rëndësishme në shumë kontekste. Çështja e biodiversitetit dhe ndryshimeve klimatike janë duke u bërë gjithnjë e më të rëndësishme për VSM-në. Një manual udhëzues se si të merren në konsideratë ato gjatë gjithë procesit të VSM-së mund të gjendet në KE (2013).

Zakonisht, studimi themelor kryhet duke mbledhur informacionin ekzistues, edhe pse për çështje të caktuara mund të jetë e nevojshme (dhe e këshillueshme, nëse koha dhe buxheti e lejojnë atë) të mblidhen të dhëna të reja nëpërmjet, për shembull, anketave në terren. Studimi themelor duhet të ofrojë një pasqyrë të përmbledhur të çdo aspekti mjedisor brenda zonës së planifikimit, në mënyrë që të lejojë t'u përgjigjet, me sa më shumë detaje të jetë e mundur, pyetjeve të mëposhtme:

-Cilat janë kushtet aktuale të aspektit mjedisor, dhe cilat janë evulimet dhe trendët e mundshme? Për shembull: gjendja aktuale e përdorimit të tokës mund të përshkruhet duke shtypur hartën tokësore më aktuale në dispozicion dhe një tabelë që zbërthen përqindjet e mbulimit të llojeve kryesore të përdorimit të tokës. Trendët e mundshme mund të sigurohen përmes analizës së hartave të përdorimit të hartave tokësore të së kaluarës (nëse ka), ose në një formë më kualitative duke paraqitur dëshmi lidhur me ruajtjen kryesore të përdorimit të tokave që janë duke u zhvilluar. Kjo dëshmi mund të mblidhet nëpërmjet vrojtimit të shkurtër në terren, dhe duke intervistuar njerëzit e informuar.

-A janë veçanti elementet e rëndësishme ose të ndjeshme të mjedisit pritisë të prekur? Këto mund të përfshijnë, për shembull, ekosistemet natyrore, trupat ujor, zonat e populluara, habitatet e llojeve të rralla, sektorët e ndjeshëm të popullsisë (p.sh., të moshuarit, fëmijët).

Burimet informative të mundshme për Kosovën që mund të jenë të dobishme në prodhimin e studimit themelor janë të shënuara në Tabelën 3.1.1. Për VSM-në e planifikimit hapësinor në nivel komunal, ky informacion mund të plotësohet me të dhënat e gjeneruara nga zyrat teknike të komunës, të tilla si inventarët e ndërtimtarisë, ankesat e qytetarëve për zhurmë, aroma apo shqetësime të tjera mjedisore, informacion mbi shpërndarjen dhe gjendjen e mirëmbajtjes të sipërfaqeve të gjelbra dhe të hapësirave publike, të dhënat për konsum të energjisë dhe të ujit dhe të gjenerimit të mbeturinave, të dhëna për shpërndarjen dhe gjendjen e mirëmbajtjes së infrastrukturës ujore etj.

Përfundimisht, informacioni hapësinor shpesh përdoret në VSM për planifikim hapësinor, kështu që të gjitha hartat përkatëse tematike duhet të paraqiten dhe të përshkruhen (p.sh., cilësia e tokës; rrejtet lumor, zonat e mbrojtura, dendësia e popullsisë, etj). Ky informacion zakonisht është në dispozicion në dy shkallë gjeografike:

-Në nivel kombëtar. Për shembull baza e të dhënave EULUP<sup>25</sup> mund të jetë shumë e dobishme. Këto të dhëna përfshijnë hartat e mbulimit të tokës, përshtatshmërinë e tokës bujqësore, ndjeshmërinë e ujërave nëntokësore dhe rrezikun e ndotjes, ndjeshmërinë dhe rreziku nga erozioni i tokës, zonat e rrezikuara nga përmytjet, vlerat e vlerësuara të biodiversitetit.

-Në nivel komunal. Komunitet duhet të ketë bazën e tyre të të dhënave GIS që mund të përfshijë një shumëllojshmëri të gjerë të shtresave (të tilla si përdorimin e tokës, topografinë, rrugët, zonat e banuara, hidrografinë, kufijtë administrativë, kufijtë kadastralë, etj), si dhe pikë karakteristike të objekteve, shërbimet dhe infrastrukturën (shkollat, qendrat shëndetësore, hapësira publike, etj).

**Tabela 3.1.1 Shembuj të burimeve të informacionit në dispozicion: Raportet e gjeneruara në shkallë kombëtare / nën-kombëtare që mund të përmbajnë të dhëna të dobishme për studimin themelor**

Raportet	Autori/agjencia/burimi
Gjendja e ujërave në Kosovë	MMPH/AKMM
Gjendja e Natyrës	MMPH /AKMM
Raporti për gjendjen e mbeturinave në Kosovë	MMPH /AKMM
Gjendja e mjedisit në Kosovë	MMPH /AKMM
Raport për gjendjen e ajrit	MMPH /AKMM
Kadastru i Ndotësve të Ujërave në Kosovë	REC-zyra në Kosovë KEPA
Raporti për hotspotet mjedisore në Kosovë	MMPH /AKMM
Siguria e ujit për Kosovën Qendrore, 2012	MMPH
Vlerësimi i Biodiversitetit të Kosovës, 2003	USAID/Kosovë
Analiza mjedisore e shtetit të Kosovës. Vlerësimi i kostos së degradimit Mjedisor, Rishikimi Institucional dhe Rishikimi i Shpenzimeve Publike për Mjedisin	Banka Botërore
Anketa Demografike, Shoqëror dhe Shëndetit Riprodhues në Kosovë, Nëntor 2009	Enti i Statistikës së Kosovës (ESK) Ministria e Administratës Publike, i mbështetur nga UNFPA dhe UNICEF
Raporti Teknik: identifikimi paraprak i 2000 vendeve natyrore në Kosovë	Nuk është e specifikuar
Emetimi i gazeve serrë në Kosovë 2008 - 2009	UNDP Kosovë
Kosovo and climate change. A Strategic Approach to the Copenhagen Climate Change Conference 2009.	Copenhagen Climate Change Conference 2009

### 3.1.3 Shqyrtimi (studimi) i çështjeve mjedisore dhe propozimi i objektivave të VSM-së

**Qëllimi.** Studimi themelor është potencialisht shumë i gjerë. Në mënyrë që VSM-ja të jetë efektive në mbështetjen e procesit të planifikimit, fokusi duhet të ngushtohet, duke identifikuar çështjet specifike mjedisore (në aspektin problemeve dhe të mundësive) të cilat janë relevante për atë kontekst dhe ushtrimin e planifikimit. Kjo lejon

<sup>25</sup> Projekti i BE-së "Mbështetje e mëtutjeshme e shfrytëzimit të tokës", Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian ([www.eulup-ks.org](http://www.eulup-ks.org))

identifikimin e objektivave specifike të VSM-së për të adresuar çështje të tilla, dhe për të përdorur këto objektiva si referencë gjatë hartimit të planit, si dhe gjatë zbatimit të tij.

**Si?** Një mënyrë për të trajtuar këtë detyrë është hartimi i një liste të problemeve mjedisore dhe një listë të mundësive mjedisore. Problemet paraqesin çështje kritike për të cilat ne dëshirojmë që plani t'i adresojë, dhe t'i përmirësoj (p.sh. ndotja akustike në zonat shkollore). Mundësitë janë elemente të kontekstit mjedisor që mund të përdoren nga plani për të arritur objektivat e saj, ose gjithsesi për të përmirësuar kushtet e banorëve (p.sh., një sasi e mirë e tokës së lirë brenda zonës urbane mund të jetë një mundësi për të përmirësuar zonat e gjelbra dhe parqet urbane).

Problemet dhe mundësitë mund të identifikohen nga:

- Analiza e studimit themelor, kryerja e anketave shitesë dhe puna në terren;
- Duke iu referuar planeve të mëparshme në kontekste të ngjashme;
- Intervistimi i autoriteteve lokale dhe më gjerë, ekspertëve teknikë dhe informatorëve kyç;
- Këshillimi me organet konsultative dhe publikun (shih detyrën tjetër).

Duke u bazuar në listën e problemeve dhe mundësive, dhe duke pasur parasysh objektivat e vendosura nga politikat përkatëse mjedisore apo planeve dhe programeve të tjera (shih tabelat 3.1.1 dhe 3.1.2), mund të nxirret një draft listë e objektivave të VSM-së. Kjo mund të jetë një listë e thjeshtë me një përshkrim të shkurtër të çdo objektivi dhe me arsyet që kanë sugjeruar përfshirjen e saj. Objektivat mund të grupohen sipas temave apo sektorëve (p.sh., biodiversiteti, rreziqet mjedisore, cilësia urbane, etj). Kurdo që është e mundur, duhet të bëhet një përpjekje për të ndërlidhur në çdo objektiv një nga treguesit e shumtë (cilësorë apo sasiorë), që mund të përdoren për të parashikuar shkallën e arritjes së objektivit të tillë (shih shembullin në tabelën 3.1.2). Në mënyrë analoge, synimet mund të jenë të lidhura me çdo objektiv, i cili sipas rrethanave mund të jenë cilësorë dhe i përgjithshëm (p.sh., përmirësimi i cilësisë aktuale të ujërave sipërfaqësore) ose sasiorë dhe më specifik (rritje me 20% e fondit të banimit që përputhet me standardet e efikasitetit të energjisë).

Për të qenë i menaxhueshëm dhe që të përdoret në mënyrë efektive gjatë proceseve të VSM-së dhe të planifikimit, lista e objektivave nuk duhet të jetë shumë e gjatë ( përafërsisht më pak se 15 objektiva mund të jetë numër adekuat për një PZHK). Identifikimi i objektivave të VSM-së është zakonisht një proces ri-përsëritës. Grupi i parë i objektivave mund të propozohet, dhe pastaj të diskutohet dhe rishikohet nga brenda (mes ekipeve të planifikimit dhe VSM-së) dhe pastaj nga jashtë (gjatë konsultimeve). Megjithatë, objektivat e VSM-së mund të rishikohen edhe më vonë, në qoftë se evoluimi i përmbajtjes së planit e kërkon atë.

**Tabela 3.1.2 Shembuj të objektivave dhe treguesve të VSM-së**

Tema e VSM-së	Objektivat e mundshme të VSM-së	Treguesit e mundshëm
<b>Biodiversiteti</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Shmangni dëmtimet në botën shtazore vendet gjeologjike dhe speciet e mbrojtura</i></li> <li>- <i>Mirëmbani biodiversiteti</i></li> <li>- <i>n, duke shmangur humbjet e pakthyeshme</i></li> <li>- <i>Rikthimi i gamës së plotë të habitateve dhe specieve karakteristike në nivele të qëndrueshme</i></li> <li>- <i>Rikthimi i rënies afatgjate në shpendët shtëpiak.</i></li> <li>- <i>Garantoni menaxhim të qëndrueshëm të habitateve kryesore të botës shtazore dhe proceseve ekologjike nga të cilat ata varen</i></li> <li>- <i>Ofroni mundësi njerëzve që të vijnë në kontakt me kafshë dhe vendet e paprekura dhe t'i vlerësojnë ato.</i></li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Nivelet e raportuara të dëmtimit të vendeve specie të caktuara</i></li> <li>- <i>Arritja e mbrojtjes së objektivave të Biodiversitetit</i></li> <li>- <i>Gjendja e raportuar e vendeve të rëndësishme në shkallë kombëtare që janë të populluara me kafshë të egra dhe strehimore natyrore</i></li> <li>- <i>Numri /sipërfaqja e zonës së mbrojtur</i></li> </ul>
<b>Popullsia dhe shëndeti i njeriut</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Krijimi i kushteve për përmirësimin e shëndetit dhe reduktimin e paparazive shëndetësore</i></li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Madhësia e popullsisë</i></li> <li>- <i>Ndryshimet demografike</i></li> <li>- <i>Vitet e jetëgjatësisë të shëndetshme /</i></li> </ul>

	<p><i>Nxitja e jetës së shëndetshme</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Mbrojtja dhe përmirësimi i shëndetit të njeriut</i></li> <li>- <i>Ulja dhe parandalimi i krimit, zvogëlimi i frikës nga krimi</i></li> <li>- <i>Ulja e zhurmës dhe dridhjeve</i></li> <li>- <i>Rritja e mundësive për rekreacion dhe ushtrime brenda objekteve</i></li> </ul>	<p><i>Shkalla e vdeqshmërisë së foshnjave</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Krimet e regjistruara për 1,000 njerëz</i></li> <li>- <i>Frika nga krimilanketat</i></li> <li>- <i>Numri i aksidenteve rrugore/këmbësore/çiklizmit</i></li> <li>- <i>Numri i njerëzve të prekur nga nivelet e zhurmës të ambientit</i></li> <li>- <i>Përqindja e zonave të qeta</i></li> <li>- <i>Përqindja e popullsisë që jetojnë në zonat më të privuaraltë varura nga përfitimet kryesore/të ardhura të privuara</i></li> </ul>
<b>Uji dhe toka</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Mbajtja e ndotjes së ujit në nivele që nuk i dëmtojnë sistemet natyrore</i></li> <li>- <i>Ruajtja nxjerrjes së ujit, konsumimi dhe rimbushja brenda kapaciteteve të natyrës.</i></li> <li>- <i>Zvogëlimi i ndotjes, mbrojtja e cilësisë dhe sasisë së tokës</i></li> <li>- <i>Minimizimi i mbeturinave, pastaj ri-përdorimi ose rimëkëmbjen e tyre përmes riciklimit, kompostimit apo rimëkëmbja e energjisë</i></li> <li>- <i>Ruajtja dhe rivendosja e proceseve ekologjike kyçe (p.sh. hidrologjike, cilësia e ujit, proceset bregdetare)</i></li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Cilësia (biologjike dhe kimike) e trupave lumor, kanaleve dhe ujërave të ëmbla</i></li> <li>- <i>Cilësia dhe sasia e ujërave nëntokësore</i></li> <li>- <i>Përdorimi i ujit (në bazë të sektorëve, duke përfshirë edhe rrjedhjen), disponueshmëria dhe sasi e ricikluara</i></li> <li>- <i>Disponueshmëria e ujit për habitatet e varura nga uji, posaçërisht për disa ligatina të caktuara</i></li> <li>- <i>Sasia/humbja e tokave të gjelbra/kafenjta dhe përqindja në disponim për ripërdorim</i></li> <li>- <i>Numri i shtëpive të prekura nga rrëshqitja, paqëndrueshmëria, etj</i></li> <li>- <i>Dendësia</i></li> <li>- <i>Mbeturinat e hedhura në deponi</i></li> <li>- <i>Toka e kontaminuar</i></li> <li>- <i>Rreziku nga përmbytja</i></li> </ul>

**Burimi: E ndryshuar sipas Zyrës së Zëvendës Kryeministrit (2005) A Practical Guide to the Strategic Environmental Assessment Directive, Londër, Publikimet e ZZKM**

### 3.1.4 Konsultimi mbi fushëveprimin e VSM-së

**Qëllimi.** Qëllimi i kësaj detyre është për të siguruar që struktura e VSM-së (në aspektin e informacionit themelor, ndërlihet me objektivat përkatëse mjedisore dhe planet ose programet tjera, identifikimi i çështjeve kyçe mjedisore dhe propozimi i objektivave të VSM-së) të jetë mjaftueshëm e fuqishme që të mbështes në mënyrë adekuate hartimin e planit. Në veçanti, konsultimet ndihmojnë të verifikohet nëse të gjitha informatat dhe çështjet e rëndësishme janë marrë në konsideratë, dhe për të dëgjuar mendimin e agjencive apo organizatave të tjera që kanë ekspertizë në fusha specifike (p.sh., në shëndetësi, trashëgimi kulturore) ose njohuri në zonën e studimit. Konsultimi në këtë fazë është i detyrueshëm sipas nenit 7.5 të Ligjit të VSM-së, i cili përcakton që kur të vendoset për fushëveprimin e VSM-së dhe llojin e informacionit të përfshirë në raport, autoriteti përgjegjës duhet të këshillohet me organet konsultative (shih Kapitullin 2.3.2).

**Si?** Autoriteti përgjegjës duhet të vendos se cila është qasja më e mirë dhe të angazhojë organet konsultative, brenda afatit kohor të përcaktuar në nenin 7.5. Megjithatë, në këtë fazë është e rekomandueshme për VSM-në të hartojë një "Raport të Shqyrtimit (studimit)" i cili mund të qarkullojë dhe të komentohet mes organeve konsultative. Ky raport shqyrtimit (studimit) bëhet pastaj baza kryesore (e qartë) për konsultim, dhe mund të rishikohet dhe të pasurohet pasi të komentohet nga organet konsultative. Një skicë e mundshme e këtij raporti vijon më poshtë:

- Hyrje (Objektivat e VSM-së dhe të fazës së shqyrtimit (studimit))
- Proceset e VSM-së dhe planifikimit (përmbledhje të shkurtër e aktiviteteve të ndërmarra deri më tani nga proceset e VSM-së dhe planifikimit)
- Përshkrimi i kornizës strategjike
- Studimi themelor
- Problemet dhe mundësitë mjedisore
- Objektivat e propozuara të VSM-së

**Tabela 3.1.3 Identifikimi dhe vlerësimi i çështjeve kritike - rast studimor nga El Salvador 2012 (ndryshuar pas Partidário)**

Çështjet kritike	Kriteret e vlerësimit
Qeverisja	- <i>Instrumentet e qeverisjes</i> - <i>Forcimi i kapaciteteve dhe koordinim institucional</i> - <i>Angazhimi i palëve të interesuara</i>
Ekosistemet, zhvillimi dhe Ekonomia lokale	- <i>Sistemet socio-ekologjike</i> - <i>Ngritja e kapaciteteve dhe ndërmarrësia</i> - <i>Cenueshmëria dhe përshtatja me ndryshimet klimatike</i>
Burimet e ujit dhe ujërat e zeza	- <i>Ndotja</i> - <i>Disponueshmëria e burimeve ujore</i> - <i>Qasja në ujë dhe në infrastrukturën e rrjetit</i>

**Burimi: PARTIDÁRIO, Maria e Rosário (2012) Udhëzues i Praktikës së Vlerësimit Strategjik Mjedisor më të Mirë : udhëzime metodologjike për të menduarit strategjik në VSM, Lisbon, Agjencia Portugeze e Mjedisit dhe REDES Energéticas Nacionais (REN)**

### 3.2 Faza B: Përkrahja e hartimit të planit dhe vlerësimi i ndikimeve

Në këtë fazë, plani po merr formë dhe objektiva specifike, dhe janë propozuar mënyra alternative për t'i arritur ato. VSM-ja ka për qëllim të kontribuojë në identifikimin e rrjedhës më të përshtatshme të veprimit në mënyrë që të përmirësojë cilësinë mjedisore të zonës, ose të paktën për të minimizuar efektet negative të planit mbi të. Kjo kërkon përmëshjen e detyrave të mëposhtme kyçe:

- a. Testimi i objektivave të planit kundrejt objektivave të VSM-së
- b. Identifikimi dhe krahasimi i alternativave
- c. Vlerësimi i efekteve të draft planit
- d. Propozimi i masave lehtësuese

Këto detyra janë pjesë përbërëse e procesit të planifikimit dhe nuk mund të kryhen në mënyrë efektive nëse janë të izoluar nga ai. Në këtë fazë, është e rëndësishme që të përdoret VSM-ja si një grup i thjeshtë mjetesh i cili verifikon qëndrueshmërinë e PP-së, mirëpo si një proces kreativ me pjesëmarrje që ka për qëllim integrimin e çështjeve mjedisore në Plan ose Program nga fazat e hershme. Integrimi i Infrastrukturës të gjelbër mund të jetë një mënyrë e mirë për përf forcimin e PP-së, duke vlerësuar mënyrën e tij të lidhjes, përdorimin e duhur të projektimit të rrjetit për lëvizshmëri dhe aktiviteteve rekreative (p.sh. nga formimi i një sistemi hapësirash publike me përmasa të një qyteti) dhe duke pasur parasysh mbrojtjen dhe zgjerimin e korridoreve ekologjike.

### Harta 3.2.1 Shembull i analizës së infrastrukturës të gjelbër



**Burimi:** VSM-ja për PZHK-në e Rahovecit.

Propozimi i korridoreve të gjelbra të cilat sigurojnë lidhje në mes të zonave natyrore në komunë (kryesisht pyjeve) mund të shmang copëzimin e habitatit dhe humbjen e biodiversitetit. Zonat me potencial të lartë të biodiversitetit janë paraqitur në figurë, ndërsa shtretërit e lumenjve është provuar se kanë një potencial të lartë të biodiversitetit. Zonat mbrojtëse të lumenjve janë shënuar si një element potencial i infrastrukturës së gjelbër të komunës.

#### **Kutia 3.2.1 Infrastruktura e gjelbër (IGJ), si një bazë e rëndësishme për planet hapësinore të Kosovës**

Infrastruktura e Gjelbër mund të përdoret si prioritet strategjik dhe mund të strukturoj komponentin e planifikimit mjedisor të planit duke krijuar një rrjet të mirë planifikuar të hapësirave të gjelbra të cilësisë së lartë dhe karakteristike të tjera mjedisore. Ai përfshin zonat natyrore dhe gjysmë-natyrore, dhe hapësirat e gjelbra në zonat rurale dhe urbane, tokësore dhe hapësirat e ujërave të ëmbla. Zonat e mbrojtura natyrore janë thelbi i infrastrukturës së gjelbër.

IGJ duhet të projektohet dhe menaxhohet si një burim shumë funksional i aftë për ofrimin e një game të gjerë të përfitimeve dhe shërbimeve.

Parimi themelor është se e njëjta sipërfaqe e tokës shpesh herë mund të ofrojë përfitime të shumta. Duke përmirësuar infrastrukturën e gjelbër, karakteristikat e çmuara të peizazhit që mund të mbahen ose të krijohen, të cilat nuk janë të vlefshme vetëm për biodiversitetin, por edhe ndihmojnë në ofrimin e shërbimeve të ekosistemit siç janë sigurimi i ujit të pastër, toka produktive, zonat rekreative tërheqëse, dhe ndihmojnë zbutjen e ndryshimeve klimatike dhe përshtatjen. Kjo ndonjëherë mund të jetë një alternativë kosto-efektive ose të jetë shtesë e infrastrukturës të hirtë dhe ndryshimeve intensive të përdorimit të tokës. Infrastruktura e gjelbër mund të përdoret si një strategji për uljen e rrezikut nga përmbytjet dhe fatkeqësitë në përgjithësi.

**Burimi:** *webfaqja përkatëse e DG Environment*

### 3.2.1 Testimi i objektivave të planit kundrejt objektivave të VSM-së

**Qëllimi.** Në këtë detyrë, objektivat e planit testohen kundrejt objektivave të VSM-së për të identifikuar sinergjinë dhe konfliktet e mundshme. Qëllimet e përgjithshme të analizës janë si më poshtë:

- Testimi për të parë nëse të gjitha objektivat e VSM-së trajtohen në plan, pra nëse për çdo objektiv të VSM-së ka të paktën një plan objektiv potencialisht të përshtatshëm;
- Të theksoj mospërputhjet dhe konfliktet e mundshme, dhe të rekomandojë mënyra për të zbatuar planin në mënyrë që të shmangen konfliktet e tilla;
- Të theksoj sinergjitë e mundshme, dhe të sugjerojë mënyra për t'i zgjeruar dhe shfrytëzuar ato në plan.

Si? Ky test mund të kryhet duke përdorur një matricë ("matrica e përputhshmërisë"), e cila harton objektivat e planit në një bosht dhe objektivat e VSM-së në boshtin tjetër. Boshllëqet mbyllen duke u përgjigjur në pyetjen e mëposhtme: "A është ky objektiv - siç përshkruhet në dokumentin e planifikimit - potencialisht në përputhje/potencialisht në kundërshtim me objektivin e VSM-së?". Komentet duhet të shtohen në matricë, si dhe rekomandimet se si të përmirësohet përputhshmëria ndërmjet objektivave të planit dhe të VSM-së.



Një shembull është dhënë në tabelën e mëposhtme:

**Tabela 3.2.1** Fragment i një matrice të përputhshmërisë

Objektivat e VSM-së	Qëllimet e Planit Hapësinor				
	Qëllimi 1 Administrata dhe menaxhimi efikas	Qëllimi 2 Mbrojtja, ruajtja dhe shfrytëzimi i vlerave natyrore	Qëllimi 3 Shfrytëzimi racional i burimeve natyrore për zhvillimin ekonomik dhe të turizmit	Qëllimi 4 Zhvillimi socio-demografik	Qëllimi 5 Ofrimi i qasjes dhe objektet publike teknike
O1: Konservimi i specieve dhe habitateve	+	++	+/-		-
O2: Përmirësimi/mirëmbajtja e korridoreve të habitat-it natyror			+		-
O3: Përmirësimi i shëndetit				++	+
O4: Reduktimi i ekspozimit ndaj rreziqeve natyrore	+	++			-
O5: Parandalimi i erozionit të tokës	+	++	-		-
O6: Mirëmbajtja e kapacitetit produktiv të tokës	+	++	++/-		
O7: Mirëmbajtja e kualitetit të ujit	+	+			++
O8: Sigurimi i ruajtjes së ujit	+	+			

*Legjenda ++: Përputhshmëri e mundshme (domethënëse); +: Përputhshmëri e mundshme (e vogël, kryesisht indirekte); 0: Nuk ka bashkëveprim; -: Konflikti i mundshëm ose papërputhshmëri (të vogla, kryesisht indirekte); --: Konflikti i mundshëm ose papërputhshmëri (domethënëse); + / -: Bashkëveprim i pasigurt/Edhe elementet e përputhshme dhe të papërputhshme.*

### 3.2.2 Identifikimi dhe krahasimi i alternativave

**Qëllimi.** Sipas Ligjit të VSM-së, VSM-ja duhet të vlerësojë efektet e mundshme mjedisore të zbatimit të planit dhe çdo alternativë të arsyeshme. Termi "alternativat" (ose opsionet) i referohet mënyrave të ndryshme që mund të propozojë një plan për të përmbushur objektivat e tij. Nëpërmjet identifikimit dhe krahasimit të alternativave, VSM-ja mund të luajë një rol "proaktiv", duke ndikuar në përmbajtjen e planit dhe përmirësimin e shqyrtimit të çështjeve mjedisore.


Si? Alternativat mund të identifikohen gjatë VSM-së si një reagim ndaj propozimeve të formuluar nga planifikuesit/politik bërësit (p.sh., duke propozuar zhvillim të brendshëm kundër zgjerimit urban në zonat ku toka është e vlefshme), ose si përgjigje ndaj çështjeve që janë shfaqur gjatë fazave të mëparshme, dhe që duhet të adresohen në mënyrë adekuate nga plani (p.sh., propozon një kufizim në konservimin të përdorimit të tokës në një zonë të rëndësishme për konservimin e biodiversitetit). Alternativat e zhvilluara gjatë VSM-së mund të jenë mënyra rrënjësisht të ndryshme për të arritur një objektiv të dhënë, ose mund të rezultojnë nga rregullimi i propozimeve ekzistuese (p.sh., duke sugjeruar detajet më të mira të zbatimit ose vend për një aktivitet të caktuar).

Në praktikë, alternativat rrallë zhvillohen në mënyrë të izoluar nga ekipi i VSM-së: bashkëpunimi i ngushtë me planifikuesit/politikë bërësit, si dhe me palët e interesuara është thelbësor. Megjithatë, VSM-ja mund të fillojë procesin duke sjellë në vëmendje çështje të veçanta dhe duke i mbështetur ato me informata relevante dhe duke u ofruar ndihmë në "përpilimin e rastit". Politikë bërësit dhe palët e interesit mund të zhvillojnë pastaj më tej këto çështje dhe të formulojnë opsionet të arsyeshme.<sup>26</sup>

Zakonisht, një VSM duhet të marrë në konsideratë llojet e ndryshme të alternativave. Për të ilustruar këtë koncept, është propozuar një hierarki e alternativave (Figura 3.2.1). Hierarkia është si në vijim:<sup>27</sup>

- Kontrolloni nëse veprimi është me të vërtetë i nevojshëm: A është e mundur shmangja e kërkesës dhe nevojave? A është opsioni mos veprim (apo "zero") një zgjidhje e arsyeshme?
- Shqyrtoni mënyra të ndryshme të cilat do të mund t'u përgjigjen nevojave apo kërkesave: Si duhet të bëhet? Cilat janë politikat, metodat ose teknologjitë e mundshme?
- Të vendoset lokacioni: Ku duhet të përqendrohet zhvillimi? Ku duhet të zbatohet një politikë e dhënë?
- Të vendoset për kohën dhe detajet e zbatimit: Cilat detaje kanë rëndësi? Çfarë lloj kërkesash duhet të bëhen rreth tyre?

**Fig 3.2.1 Hierarki tipike e alternativave në VSM**



**Burimi: Ndryshuar sipas Zyrës së Zëvendës Kryeministrit (2005) A Practical Guide to the Strategic Environmental Assessment Directive, Londër, publikimet e ZZKM**

**Shembull.** Një shembull tipik në VSM për një Plan Zhvillimor Komunal (PZHK) përfaqësohet nga alternativat e mundshme për zhvillimin e banimeve të reja:

- Nevoja/Kërkesa: Studimet bazë të VSM-së dhe PZHK-së mund të përdoren për të verifikuar nëse zhvillimi i banimeve të reja është në të vërtetë i nevojshëm, ose nëse mund të përdoren fondet ekzistuese të banimit (p.sh., duke nxitur rinovimin, shndërrimin e ndërtesave të tepërta jo-rezidente, etj.)

<sup>26</sup> UNEP (2014) *Integrating ecosystem services in Strategic Environmental Assessment: Një udhëzues për praktikuesit, raport për Proecoserv* [<http://www.proecoserv.org/information-hub-test/guideline.html>]

<sup>27</sup> Ndryshuar sipas THERIVEL, R. (2004) *Strategic Environmental Assessment in action, Londër, Earthscan*

- Mënyra/Procesi: VSM-ja mund të krahasojë dhe të vlerësojë opsione të ndryshme, si për shembull një zhvillim i madh kundrejt disa më të voglave (ky shembull është zgjeruar në tabelën 3.2.2), ose zhvillimi i brendshëm kundrejt zhvillimit të zonave të gjelbra.
- Vendndodhja: VSM-ja mund të sigurojë një analizë të përshtatshme të tokës për të drejtuar zhvillimin e ri dhe të sugjerojë vende të mundshme, të cilat pastaj krahasohen duke përdorur indikatorët dhe të dhënat bazë në dispozicion (shih tabelat 3.2.5 dhe 3.3.1)
- Koha dhe zbatimi i detajuar: VSM-ja mund të sugjeroj detaje mbi dendësinë, karakteristikat e ndërtimit, parametrat e efikasitetit të energjisë, etj.

**Tabela 3.2.2 Shembull i tabelës për krahasimin e dy alternativave për zhvillim hapësinor**

Objektivat e VSM-së	Opsioni A Zhvillimi i përqendruar		Opsioni B Zhvillimit policentrik: dy nën-qendra	
	Performanca	Komentet/Shpjegimi	Performanca	Komentet/Shpjegimi
<b>Objektiva Mjedisore 1</b> Për të ruajtur dhe theksuar cilësinë e peizazhit natyror dhe atij të qytetit	-	Ndikimi vizual i zhvillimit, dhe ndryshimi i karakterit të qytetit (p.sh. konfigurimi) mund të jetë i rëndësishëm. Lërja anash e një hapësire aq të madhe të tokës mund të nënkuptojë se do të jetë më e vështirë për t'i zhvilluar tokat e kafenjta ( arat) e tjera në qytet.	++	Do të sjellë përsëri në përdorim vendet e braktisura dhe të degraduara, të cilat janë duke shkaktuar dëmtim vizual në të tre vendbanimet.
<b>Objektiva Mjedisore 2</b> Të përmirësohet cilësia e ajrit	-	Mund të shpie deri te shkelja e standardeve të cilësisë së ajrit	+	Gjersa arat janë të vendosura në qendër, duhet të mundësoj zhvillimin që do të inkurajonte ecjen dhe çiklizmin, dhe do të ulte varësinë nga makinat
<b>Objektiva Mjedisore 3</b> Vlerësimi i përmbledhjes kundrejt objektivave mjedisore	--	Efektet kumulative mund të jenë të mëdha, pa politika të përshtatshme për të siguruar ruajtjen e cilësisë së peizazhit, humbjen e lëndinave, kompensimin e biodiversitetit, dhe të arrihet një kalim i rëndësishëm nga makinat në transport publik dhe/ose ecje/çiklizëm	+	Në përgjithësi pozitive (disa efekte të vogla lidhur me vlerën ekologjike të arave). Do të përdorte tokën në mënyrën më të frytshme të mundur.


*Legjenda:*

+ Pozitive; - Negative; 0 neutral; ? e pasigurt; + / - I vogël; + + / - I madh

*Gjithashtu nëse është e përshtatshme do të mund të bëhet një dallim midis afatshkurtrës, afatmesmes dhe afatgjatës.*

**Burimi:** Përshtatur nga Zyra e Zëvendës Kryeministrit (2005) *Një Udhëzues Praktik për Direktivën e Vlerësimit Strategjik Mjedisor, Londër, Publikimet e ZZKM*

**Harta 3.2.2 Ilustrim i një skenari të PZHK-së. Ngjyra kafe e errët tregon zonat aktuale të banimit, kafe e hapur tregon zonat potenciale të banimit dhe e hirtë tregon zonat potenciale të industrisë (në bazë të analizave AHP)**



**Burimi:** VSM-ja për PZHK-në e Prizrenit


### 3.2.3 Vlerësimi i ndikimeve të draft-planit

**Qëllimi.** Kjo detyrë ka për qëllim vlerësimin e ndikimeve mjedisore të draft-planit para aprovimit të tij, pra në një fazë kur është ende e mundur të sugjerohen ndryshime dhe rishikime. Ndikimet definojnë si dallimi në mes të kushteve të një variabël të paraparë me dhe pa plan, nëpër kohë. Për këtë arsye, ndikimet mund të jenë ndryshime të dëshirueshme (pozitive) apo të padëshirueshme (negative), që pritet të rezultojnë nga zbatimi i planit.

**Si?** Për parashikimin dhe vlerësimin e ndikimit mund të përdoren disa metoda dhe teknika, sipas nivelit të detajit të analizës dhe mënyrës në të cilën ES janë karakterizuar në vijën bazë (p.sh., modelet dhe analiza sasiore; opinionin e ekspertit dhe përshkrimi kualitativ; vlerësimi monetar). Në VSM, vlerësimet e ndikimit kualitativ në përgjithësi janë më të zakonshme se vlerësimet e ndikimit kuantitativ, për shkak të niveleve të larta të pasigurisë që përmban (në të dhënat, në mënyrën se si veprimi strategjik do të zbatohet, në tendencat e ardhshme të drejtuesve kyç, etj), kompleksitetit të vendimeve dhe nevojës për të siguruar një kontribut të dobishëm në vendimmarrje, brenda limiteve të kohës dhe burimeve të procesit të planifikimit. Pra, në praktikë ndikimet shpesh shprehen përmes shkallëve të cilësisë (p.sh., + + + / ---) ose tendencave (p.sh., përmirësimi / përkeqësimi). Kjo zbatohet veçanërisht në planet e nivelit më të lartë. Planet më pak strategjike dhe planet e nivelit lokal mund të kërkojnë më shumë të dhëna kuantitative, veçanërisht në qoftë se ato ofrohen për rregullim të detajuar (p.sh., një skemë e zonimit e një plani urban që identifikon ndryshimet në përdorimin e lejuar/ndaluar të tokës në çdo njësi të tokës).

Vlerësimi i ndikimeve mund të kryhet duke përdorur si referencë kushtet aktuale dhe/ose skenarin "biznesi si zakonisht" (business-as-usual). Kjo do të thotë se ndikimet janë përshkruar si dallime në mes të kushteve të planifikimit dhe kushteve aktuale ose të biznesit si zakonisht (shih shembullin në tabelën 3.2.3). Ndikimet e planeve duhet të vlerësohen kundrejt objektivave të VSM-së, të identifikuara më parë (shih seksionin 3.2.1), kështu që në këtë mënyrë mundësohet kuptimi i shkallës në të cilën plani do të kontribuojë në arritjen e këtyre objektivave (shih shembullin në tabelën 3.2.3).

Harta 3.2.3 Vlerësimi i ndikimit në ekosistemet natyrore dhe ndërlidhja e një plani urban. Harta krahason gjendjen aktuale me gjendjen në plan, duke theksuar fushat ku plani do të shkaktojë një ndikim negativ (e kuqe) ose një ndikim pozitiv (e gjelbër)



*Burimi: Burimi: GENELETTI, D. dhe BRAGAGNOLO, C. (2009) L'uso di indicatori per il confronto tra scenari nella Valutazione Ambientale Strategica, Sentieri Urbani. I (2), 33-37*

Tabela 3.2.3 Vlerësimi kualitativ i ndikimit të pritshëm të planit në lidhje me kushtet e tanishme kundrejt një sërë objektivave të VSM-së

Objektiva VSM	Kushtet e planit kundrejt kushteve të tanishme
Reduktimi i zgjerimit të pakontrolluar	↓
Përmirësimi i hapësirave të gjelbra	↓
Përmirësimi i korridoreve ekologjike	↔
Reduktimi i ekspozimit ndaj zhurmës	↑
Përmirësimi i shtigjeve për biçikleta	↑
Reduktimi i ekspozimit ndaj rrezatimit elektro-magnetik	↑

*Burimi: E modifikuar sipas GENELETTI, D. (2013) Strategic Environmental Assessment: General principles. Materiali i ligjëratis për kursin e shkurtër mbi VSM-në për planifikim hapësinor dhe urban, Universiteti i Trentos*

Elementet e rëndësishme që duhet adresuar gjatë vlerësimit të ndikimit janë:

- Magnituda dhe shkalla gjeografike e ndikimit të pritshëm (p.sh., sa është e madhe zona ku pritet humbja e vegetacionit natyral për shkak të ndërtimit të infrastrukturës)
- Periudha kohore (a është ndikimi i kufizuar në kohë? Cila është shpeshësia e pritur?)

- Reverzibiliteti (a është ndikimi i përhershëm apo i përkohshëm?)
- Probabiliteti (Sa janë gjasat e paraqitjes së ndikimit?)
- Ekzistenca e efekteve kumulative (shih më poshtë).

Shumë probleme që ndërlidhen me degradimin e mjedisit dalin nga efektet kumulative të aktiviteteve të njeriut. Efektet kumulative janë ndikimi neto nga një numër i aktiviteteve të ndryshme dhe mund të ndodhin si rezultat i situatave të mëposhtme:<sup>28</sup>

- Bashkëveprimi i ndikimeve nga veprimet në një plan që ndikon në të njëjtin komponent mjedisor. Për shembull, propozimet për ndërtimin e infrastrukturave, objekteve komerciale dhe të banimit brenda një kohe të shkurtër, mund të rezultojnë në humbjen kumulative të hapësirës së hapur dhe peizazhit tërheqës për rekreacion. Në mënyrë analoge, një politikë për inkurajimin e kultivimit të biokarburanteve të ripërtëritshme dhe një politikë e konsolidimit të tokës mund të rezultojë në një humbje kumulative të kultivimit të bimëve;
- Ndikimet e kombinuara të planit të veprimit me ndikimet e planeve dhe programeve të tjera që ndikojnë në të njëjtin komponent mjedisor në një zonë të caktuar. Për shembull, propozimet nga planet urbane dhe pyjore mund të bashkëveprojnë dhe të ndikojnë në rregullimin e klimës lokale.

Njëra nga *raison d'être* të VSM-së është vlerësimi i efekteve kumulative, nisur nga fakti se ndikimet individuale nga një projekt apo zhvillim mund të mos jenë të rëndësishme si të vetme, por janë të rëndësishme në kombinim me ndikimet e tjera<sup>29</sup>. Për këtë arsye, VSM-ja nuk mund të kufizohet në analizën e elementeve individuale të planit, por ka nevojë të kryej edhe një vlerësim të përgjithshëm, në vazhden e aktiviteteve dhe politikave që përfshihen në plan (tabela 3.2.4).

**Tabela 3.2.4 Një shembull i matricës që mund të përdoret për përmbledhjen e efekteve kumulative të të gjitha elementeve të një plani në një grup të komponentëve mjedisorë**

Komponenti mjedisor	Elementet e planit					Vlerësimi i efektit kumulativ
	1	2	3	4	5	
Emetimi i gazrave serë	+	-	+	+	0	Pozitive
Burimet natyrore	--	0	0	--	-	Negative
Toka	0	0	0	0	0	Pa ndonjë efekt domethënës
Biodiversiteti	+	0	-	0	0	Pa ndonjë efekt domethënës

*Burimi: E modifikuar sipas THERIVEL, R. (2004) Strategic Environmental Assessment in action, Londër, Earthscan*

### 3.2.4 Propozimi i masave lehtësuese

**Qëllimi.** Ligji për VSM-në kërkon marrjen në konsideratë të masave lehtësuese për të parandaluar, zvogëluar ose kompensuar efektet negative mjedisore të planit. Këto masa mund të përfshijnë edhe masa pro-aktive për të rritur efektet pozitive mjedisore të planit.

**Si?** Masat lehtësuese duhet të merren parasysh gjatë përgatitjes së planit, për të adresuar në këtë mënyrë elementet kritike të identifikuara gjatë VSM-së. Është i dobishëm referimi në "hierarkinë lehtësuese", e cila është e paraqitur në Figurën 3.2.2. Kjo hierarki<sup>30</sup> tregon se VSM-ja duhet të kërkojë masa që, sipas prioritetit:

<sup>28</sup> COOPER, L. M. (2004) *Guidelines for Cumulative Effects Assessment in SEA of Plans*, EPMG Occasional paper 04/LMC/CEA, Kolegji Mbretëror, Londër


<sup>29</sup> E modifikuar sipas BRAGAGNOLO, C., GENELETTI, D., FISCHER, T.B. (2012) *Efektet kumulative në VSM-të e planeve hapësinore – dëshmi nga Italia dhe Anglia*, *Impact Assessment and Project Appraisal*, 30 (2), fq. 100-110

<sup>30</sup> BOND, A., MORRISON-SAUNDERS, A., STOEGLEHNER, G. (2013) *Projektimi i një procesi efektiv të vlerësimit të qëndrueshmërisë*, në: BOND, A., MORRISON-SAUNDERS, A. dhe HOWITT, R. (eds) *Sustainability Assessment Pluralism: Practice and Progress*, Londër, Routledge, 231-244

- Përmirësojnë mjedisin
- Shmangin efektet negative në mjedis
- Reduktojnë/minimizojnë efektet negative që nuk mund të shmangen
- Restaurojnë efektet negative (p.sh., përmes ndërhyrjeve restauruese në mjedis)
- Kompensojnë efektet negative duke identifikuar masat e përshtatshme për kompensim

VSM-ja ofron një gamë të gjerë të masave të mundshme përmirësuese dhe lehtësuese, të cilat janë të ndryshme për nga natyra, duke përfshirë: masat rregullatore, edukative, teknike, procedurale dhe hapësinore. Tabela 3.2.5 jep shembuj për secilin lloj.

**Fig 3.2.2 Hierarkia e lehtësimit**



**Burimi:** E modifikuar sipas UNEP (2009) *Integrated Assessment for Mainstreaming Sustainability into Policymaking: A Guidance Manual*

**Tabela 3.2.5 Shembuj të llojeve të ndryshme të masave të cilat mund të merren në konsideratë në VSM**

Lloji i masës	Shembulli
Fiskale	Subvencionet për konvertimin e tokës së punuar bujqësore në mënyrë intensive në tokë pyjore; pagesat për mbingarkim
Rregullatore	Standardet e efikasitetit të energjisë; rregullave që pengojnë zhvillimin në fusha të caktuara
Edukative	Fushata ndërgjegjësuese për energji; skema ecja deri në shkollë
Teknike	Kërkesat për trajtimin e ujërave të zeza; sistemet urbane të qëndrueshme të kullimit
Procedurale	Kërkojnë konsultimin publik para se të projektohen lloje të caktuara të zhvillimit
Hapësinore	Kërkojnë që zhvillimi i ri i banimit të bëhet brenda distancës së përcaktuar të transportit publik

**Burimi:** E modifikuar sipas THERIVEL, R. (2004) *Strategic Environmental Assessment in action, Londër, Earthscan*

### 3.3 Faza C: Përgatitja e raportit të VSM-së

**Qëllimi.** Raporti i VSM-së është rezultati kryesor i VSM-së dhe duhet të përmbajë identifikimin, përshkrimin dhe vlerësimin e ndikimeve të mundshme të planit (duke përfshirë alternativat e arsyeshme) në mjedis. Raporti i VSM-së për draft-planin është përgatitur dhe do të përdoret gjatë konsultimit publik (shih fazën D).

Si? Ligji i Kosovës për VSM-në përshkruan informacionet që duhet të përfshihen në raportin e VSM-së (Shtojca 2 e legjislacionit). Neni 7 specifikon se informacioni duhet të jepet "siç mund të kërkohet arsyeshmërisht", në vazhden e njohurive ekzistuese, përmbajtjen dhe nivelin e detajeve në plan, dhe fazën e planit në procesin e vendimmarrjes. I gjithë informacioni i nevojshëm për përpilimin e raportit të VSM-së është përshkruar në detyrat e mëparshme (me përjashtim të planit të monitorimit i cili është përshkruar në kapitullin 3.5), kështu që ka mbetur vetëm sistemimi i tij dhe dhënia e një strukture të qartë, në mënyrë që të lehtësohet ndërveprimi me autoritetet, organet konsultative dhe publikun. Një i mundshëm i raportit të VSM-së është paraqitur në tabelën 3.3.1 dhe korrespondenca ndërmjet këtij përvijimi dhe përmbajtjes së kërkuar nga Shtojca 2 është paraqitur në kolonën e tretë.

**Tabela 3.3.1 Përvijimi dhe përmbajtja e sugjeruar për raportin e mjedisit dhe korrespondenca me informacionin që duhet të ofrohet në pajtim me Ligjin për VSM-në (Shtojca 2)**

Kapitulli	Përmbajtja	Informacionet që duhet të ofrohen në raportet e VSM-së (Shtojca 2, Ligji për VSM-në)
<i>Kapitulli 0</i>	<i>Përmbledhje e procesit të VSM-së dhe e efekteve të mundshme domethënëse të planit për mjedisin</i>	<i>Një përmbledhje jo teknike të informacionit të dhënë në raport</i>
<i>Kapitulli 1. Hyrja</i>	<i>Qëllimi i VSM-së; përshkrimi i proceseve të planifikimit/ VSM; përshkrimi i strukturës së raportit</i>	<i>[Nuk përmendet në legjislacion]</i>
<i>Kapitulli 2. Korniza strategjike dhe</i>	<i>Përshkrimi i legjislacionit, planeve, programeve relevante dhe direktivave relevante të BE-së</i>	<i>Një përshkrim i përmbajtjeve, objektivave kryesore të planit ose programit dhe lidhja me planet ose programet e tjera</i>
<i>Përmbledhja e draft-planit</i>	<i>Përshkrim i shkurtër i draft-planit për lehtësimin e kuptimit të analizave të VSM-së</i>	
<i>Kapitulli 3. Baza mjedisore</i>	<i>Kushtet aktuale dhe tendencat e aspekteve të ndryshme mjedisore; përshkrimi i informatave në dispozicion dhe identifikimi i zbrazëtirave të dijes; elemente kyçe të kontekstit socio-ekonomik; zhvillimi i mundshëm i kontekstit pa plan</i>	<i>Aspektet përkatëse të gjendjes aktuale të mjedisit dhe zhvillimi i mundshëm i saj, pa zbatimin e planit</i> <i>Karakteristikat mjedisore të zonave që mund të preken konsiderueshëm</i>
<i>Kapitulli 4 Çështjet kyçe mjedisore dhe objektivat e VSM-së</i>	<i>Shqyrtimi (studimi) i problemeve dhe mundësive kryesore mjedisore; identifikimi i objektivave/indikatoreve dhe synimeve të VSM-së</i>	<i>Çfarëdo problemi ekzistues mjedisor që është relevant me planin, përfshirë, në veçanti ato që lidhen me çfarëdo zone të një rëndësie të veçantë mjedisore</i> <i>Objektivat e mbrojtjes mjedisore (të krijuara në nivel kombëtar, ndërkombëtar ose të Komunitetit Evropian), të cilat janë relevante për planin dhe mënyrën se si këto objektiva ose çështje mjedisore janë marrë parasysh gjatë përgatitjes së raportit</i>
<i>Kapitulli 5. Analiza e pajtueshmërisë e objektivave të planit</i>	<i>Analiza e pajtueshmërisë ndërmjet objektivave të planit dhe objektivave të VSM-së, si dhe elementet përkatëse të kornizës strategjike (p.sh. planet dhe programet e tjera përkatëse). Mund</i>	<i>Një përvijim të arsyeve për përzgjedhjen e alternativave të trajtuara, dhe një përvijim të mënyrës sesi u realizua vlerësimi, duke përfshirë vështirësitë - të tilla si mangësitë</i>



Kapitulli	Përmbajtja	Informacionet që duhet të ofrohen në raportet e VSM-së (Shtojca 2, Ligji për VSM-në)
	<i>të përfshijë përshkrimin se si objektivat e planit janë zhvilluar gjatë procesit, për të reflektuar sugjerimet e VSM-së</i>	<i>teknike ose mungesa e njohurive teknike - të hasura gjatë përgatitjes së informacionit të kërkuar</i>
<b>Kapitulli 6.</b> <b>Vlerësimi i efekteve mjedisore të planit</b>	<i>Analiza të efekteve të planit, duke përfshirë krahasimin ndërmjet alternativave të arsyeshme (dhe arsytet për zgjedhjen) dhe propozimin e masave lehtësuese. Mund të bëhet ndarja në më shumë kapituj për të pasqyruar më mirë strukturën e planit. Përshkrimin se si janë përfshirë rezultatet e VSM-së në plan</i>	<i>Efektet më të rëndësishme të mundshme mbi mjedis në çështje të tilla si: biodiversiteti, popullsia, shëndeti i njerëzve, fauna, flora, toka, uji, ajri, faktorët klimaterik, asetet materiale, trashëgimia kulturore dhe natyrore, duke përfshirë trashëgiminë arkitekturore dhe arkeologjike, pamjen dhe ndërlidhjen e faktorëve të mësipërm</i>  <i>Masat e parashikuara për të parandaluar, zvogëluar dhe sa më shumë të jetë e mundur të kompensojë ndikimet domethënëse negative në mjedis gjatë zbatimit të planit</i>
<b>Kapitulli 7. Plani i monitorimit</b>	<i>Indikatorët dhe qasja për monitorimin e zbatimit të planit</i>	<i>Një përshkrim i masave të parashikuara në lidhje me monitorimin</i>

### 3.4 Faza D: Konsultimi dhe vendimmarrja

**Qëllimi.** Qëllimi i kësaj faze është mbledhja e opinioneve të organeve konsultative dhe publikut (dhe e autoriteteve ndërkufitare, nëse është e nevojshme) në draft-plan dhe raportin e VSM-së, rishikimi i planit dhe raportit të VSM-së sipas rezultatit të procesit konsultativ, dhe dërgimi i tyre në Ministri (ose Komision, shih detajet më poshtë) për pëlqim. Në këtë fazë po ashtu duhet të merret vendimi në lidhje me Planin ose Programin që është duke u vlerësuar. Për këtë arsye, Raporti i Mjedisit duhet të jetë në dispozicion në të njëjtën kohë me draft-planin ose programin, si pjesë përbërëse e procesit të konsultimit dhe vendimmarrjes, dhe këto dy dokumente duhet të kenë lidhje të qartë.

Si? Procedura e përcaktuar në Ligjin për VSM-në kërkon që:

- Draft-plani dhe raporti i VSM-së të dërgohen tek organet konsultative (shih kapitullin 2.3), dhe të sillen në vëmendjen e personave të cilët me gjasë mund të ndikohen nga plani ose që kanë interes nga plani.
- Dokumentet po ashtu vihen në dispozicion (përmes një ueb-faqe) për publikun e gjerë (Neni 8);
- Aranzhohet një debat (Neni 9);
- Përgatitet një raport mbi pjesëmarrjen e organeve konsultative dhe publikut (Neni 10).

Reagimi i procesit konsultativ duhet të përdoret për të rishikuar draft-planin dhe raportin e VSM-së, kështu që mund të tregohet se si reagimi është marrë në konsideratë, para miratimit të planit.

Për dokumentet e planifikimit hapësinor të nivelit lokal, autoriteti komunal duhet të dërgojë në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor draft-planin, draft-raportin për VSM-në, si dhe raportin për pjesëmarrjen e publikut dhe organeve konsultative, dhe çfarëdo dokumentacioni përcjellës. Organi përgjegjës i Ministrisë do të bëjë vlerësimin e raportit të VSM-së duke zbatuar kriteret e cilësisë, të paraqitura më poshtë si referencë (shih tabelën 3.4.1). Lista kontrolluese për vlerësimin e cilësisë së raporteve të VSM-së (e përfshirë në Shtojcën 3 të Ligjit për VSM-në). Bazuar në këtë vlerësim, organi përgjegjës do të përgatisë një projekt-vendim për ta paraqitur tek Ministri. Brenda 15 ditëve nga pranimi i projekt-vendimit, Ministri do të vendosë nëse do të japë ose të refuzojë pëlqimin. Procedura është e njëjtë edhe për dokumentet e planifikimit hapësinor në nivel kombëtar, por nëse draft-vendimi është përgatitet

nga një Komision i themeluar nga Ministria, pas përgatitjes së draftit të parë të planit ose programit (Neni 4, paragrafi 5 të Ligjit për VSM-në.

**Tabela 3.4.1 Lista kontrolluese për të vlerësuar cilësinë e raporteve të VSM-së (Shtojca 3 të Ligjit për VSM-në)**

<b>Tema</b>	<b>Kriteri</b>
<b>Plani</b>	<i>Janë pasqyruar qartë qëllimet dhe përmbajtja e planit dhe programit, zona për të cilën përgatitet plani dhe programi, përfshirja hapësinore dhe horizonti kohor</i>
	<i>Çështjet e mbrojtjes së mjedisit të cilat janë të përfaqësuara në përgatitjen e qëllimeve të planit dhe programit</i>
	<i>Janë pasqyruar lidhjet mes planeve dhe programeve tjera relevante</i>
<b>Gjendja e mjedisit</b>	<i>Është paraqitur gjendja e tashme dhe e ardhme e mjedisit</i>
	<i>Përshkrimi i gjendjes së mjedisit është përshtatur me qëllimet dhe indikatorët për VSM-së</i>
	<i>Janë prezantuar burimet e informacioneve për gjendjen e mjedisit dhe metodologjitë të cilat janë përshtatur me shkallën e ndërlikueshmërisë së VSM-së</i>
<b>Zgjidhjet alternative</b>	<i>është paraqitur mënyra me të cilën janë përgatitur dhe shqyrtuar zgjidhjet alternative për çështjet dhe problemet lidhur me mjedisin</i>
	<i>është përgatitur zgjidhja alternative e mosrealizimit të planit ose programit dhe zgjidhja alternative më e përshtatshme, nga aspekti i mbrojtjes së mjedisit</i>
	<i>janë vlerësuar ndikimet e zgjidhjeve alternative në mjedis dhe është bërë krahasimi</i>
	<i>janë argumentuar arsytet për zgjidhjen e alternativës më të përshtatshme nga aspekti i mbrojtjes së mjedisit</i>
<b>Vlerësimi i ndikimit në mjedis</b>	<i>Është paraqitë mënyra me të cilën janë përcaktuar dhe vlerësuar ndikimet e rëndësishme të planit dhe programit në mjedis</i>
	<i>Gjatë vlerësimit të ndikimit në mjedis janë përfshirë përbërësit: ajri, uji, toka, 19 klima, bota bimore dhe shtazore, habitatet natyrore, llojlojshmëria biologjike, vlerat e kulturës, natyrës dhe atyre historike, popullata dhe shëndeti, qytetet dhe vendbanimet tjera, objektet e infrastrukturës, industrisë dhe objektet tjera dhe vlerat tjera të krijuara</i>
	<i>gjatë vlerësimit të ndikimit në mjedis janë marrë parasysh, këto karakteristika të ndikimeve: probabiliteti, intensiteti, ndërlikueshmëria / reverzibiliteti, dimensionin kohor: frekuenca, përsëritja, dimensionin hapësinor: lokacioni, zona gjeografike, numri i njerëzve të ekspozuar, natyra e ndikimit ndërkufitar, natyra kumulative dhe sinergjike e ndikimit, karakteristikat tjera të ndikimit</i>
	<i>përcaktimi dhe vlerësimi i ndikimeve të rëndësishme është në përputhshmëri me standardet e përcaktuara, rregullat dhe vlerat kufitare</i>
	<i>Është e përshkruar metodologjia e përdorur.</i>
<b>Masat dhe programet e monitorimit të gjendjes së mjedisit</b>	<i>Janë paraparë masat për pengimin dhe kufizimin e ndikimeve negative, gjegjësisht rritjen e ndikimeve pozitive në mjedis për çdo ndikim të vlerësuar</i>
	<i>Është paraqitur mënyra me të cilën janë përgatitë kahjet për hartimin e vlerësimit të ndikimit të projekteve në mjedis dhe vlerësimeve tjera strategjike</i>

Tema	Kriteri
	<i>Është përgatitur programi i përcjelljes së gjendjes së mjedisit gjatë realizimit të planit ose programit</i>
<b>Raporti për VSM-në</b>	<i>Është i definuar qartë roli i organeve kompetente për hartimin e raportit të VSM-së</i>
	<i>Raporti është i përgatitur në mënyrë të qartë dhe të përpiktë</i>
	<i>Janë përpunuar të gjitha elementet e raportit për VSM-në, të përcaktuara në nenin 13 të këtij ligji dhe janë dhënë burimet e informacioneve duke përfshirë edhe mendimet profesionale</i>
	<i>Është paraqitur mënyra e përfshirjes së çështjeve mjedisore në plan ose në program, mënyra e vendimmarrjes dhe janë përshkruar shkaqet vendimtare për përzgjedhjen e planit ose programit të propozuar nga aspekti i zgjidhjeve alternative të cilat janë shqyrtuar</i>
	<i>Përmbledhja jo-teknike është hartuar në mënyrë të qartë</i>
<b>Pjesëmarrja e organeve konsultative dhe publikut</b>	<i>komentet nga trupat konsultues, publikut dhe të ndonjë shteti të cilat janë konsultuar janë përfshirë dhe mënyrën si janë marrë në konsideratë janë përshkruara në vendim.</i>

#### **Burimi: Shtojca 3 të Ligjit për VSM-në**

### **3.5 Faza E: Monitorimi i zbatimit të planit**

**Qëllimi.** Monitorimi siguron vazhdimësi të procesit të VSM-së dhe mundëson zbulimin e ndryshimeve kontekstuale që mund të ndodhin gjatë zbatimit të planit, së bashku me përparimin në zbatimin e tij efektiv dhe ndikimet aktuale. Zbulimi i hershëm i këtyre çështjeve mundëson propozimin dhe zbatimin e modifikimeve dhe rregullimeve në plan. Qëllimi përfundimtar është krijimi i mundësisë për ndërhyrje dhe korrigjim në kohë të problemeve të detektuar (p.sh., ndikimeve të paparashikuara, masave lehtësuese dhe përmirësuese të cilat nuk janë kryer).

Si? Në raportin e VSM-së duhet të hartohet dhe përfshihet një plan i monitorimit. Ky plan duhet të ofrojë informacionin e mëposhtëm:

- Identifikimin e treguesve të monitorimit dhe përshkrimin e metodave, shpeshtësinë dhe përgjegjësinë për mbledhjen e të dhënave (përgjegjësia mund të ndryshojë sipas natyrës së treguesve);
- Udhëzime mbi vlerësimin e të dhënave (vlerësimi i konformitetit me parashikimet apo pritjet);
- Udhëzime mbi menaxhimin (se si t'i përgjigjemi në mënyrën e duhur çështjeve që dalin nga vlerësimi)
- Strategjitë e komunikimit (informimi i palëve të interesit në lidhje me rezultatet, ose, ku është e nevojshme, përfshirja e palëve të interesit në fazat e vlerësimit dhe/ose menaxhimit).

Ky informacion mund të sigurohet në një formë shumë të thjeshtuar dhe kryesisht cilësore, siç është ilustruar në Tabelën **Error! Reference source not found.**

**Tabela 3.5.1 Shembull i formatit të mundshëm për një plan monitorues**

Objekti	Çka duhet të monitorohet?	Kush i ofron të dhënat?	Sa shpesh?	Në çfarë pike duhet të merret në konsideratë ndonjë veprim shtesë?	Çfarë mund të bëhet nëse identifikohet ndonjë problem?

Objekti	Çka duhet të monitorohet?	Kush i ofron të dhënat?	Sa shpesh?	Në çfarë pike duhet të merret në konsideratë ndonjë veprim shtesë?	Çfarë mund të bëhet nëse identifikohet ndonjë problem?
Mbrojtja e biodiversitetit	<i>Kushtet e vendeve të caktuara dhe fushave të tjera të rëndësishme natyrore</i>	<i>Planifikuesi</i>	<i>Çdo dy vite</i>	<i>Kur gjendja përkeqësohet</i>	<i>Merrni parasysh mënyra për të përmirësuar biodiversitetin (p.sh., ndërhyrjet e gjelbra dhe restauruese)</i>
Mbrojtja e shëndetit të njeriut	<i>Numri i aksidenteve për person/km gjatë udhëtimeve me veturë, në këmbë, biçikletë</i>	<i>Policia</i>	<i>Çdo vit</i>	<i>Nëse njëra nga këto përkeqësohet për 10%</i>	<i>Përmirësimi i hapësirave të këmbësorëve dhe të çiklizmit, qetësimi i trafikut, planifikimi i ri rrugor</i>
Promovimi i sjelljes pozitive të ndërlidhur me shëndetin	<i>% e fëmijëve që ecin/udhëtojnë me biçikletë</i>	<i>Anketa komunale/autoriteti i shkollës</i>	<i>Çdo 2 vite</i>	<i>Zvogëlimi prej 10%</i>	<i>Përmirësimi i rrugëve për këmbësorë dhe biçikleta, fushata për ngritjen e ndërgjegjësimit</i>

**Burimi:** *E modifikuar sipas THERIVEL, R. (2004) Strategic Environmental Assessment in action, Londër, Earthscan*

Indikatorët e monitorimit mund të përfshijnë indikatorët për të monitoruar ndryshimet në kontekst dhe indikatorët për të monitoruar ndikimet e planit. Grupi i parë lejon përfitimin e njohurive në ndryshimet mjedisore dhe socio-ekonomike që ndodhin në këtë zonë gjatë zbatimit të planit. Ndryshimet relevante mund të ndërlidhen me gjendjen e mjedisit (p.sh., trendet klimaterike, fatkeqësitë natyrore), të profilit shoqëror (p.sh. modelet e migrimit), gjendjen socio-ekonomike (p.sh., ndryshim në sistemet e jetesës) dhe kornizën legjislative dhe rregullative (p.sh., caktimi i zonave të reja të mbrojtura; politika e reformës së tokës). Programet ekzistuese të monitorimit dhe të raportimit (p.sh., raportet mbi gjendjen e mjedisit) përfaqësojnë një pikënisje të dobishme për këtë aktivitet. Grupi i dytë lejon mundësin e vlerësimit se deri në çfarë mase ndikimet e vëzhguara ndryshojnë nga parashikimet e kryera gjatë VSM-së.

Si rekomandim përfundimtar, është e rëndësishme për treguesit e monitorimit të jenë në përputhje me treguesit e përdorur për të informuar analizat e mëparshme të VSM-së (p.sh., treguesit që ndërlidhen me objektivat e VSM-së), të jenë të kufizuar në numër (për të siguruar qëndrueshmërinë e sistemit të monitorimit), dhe të masin, interpretojnë dhe komunikojnë sa më lehtë të jetë e mundur.

## IV. REKOMANDIMET

Tabela e mëposhtme jep disa rekomandime se si përmbajtja e VSM-së (e ndarë në fazat e përshkruara më parë) duhet të pasqyrojë nivelin e planit hapësinor sipas analizës, duke bërë dallimin në mes të planifikimit në nivel kombëtar dhe planifikimit në nivel lokal.

**Tabela 4.1.1. Procesi i VSM-së për planet hapësinore në nivele të ndryshme**

Fazat e VSM-së	Plani hapësinor në nivel kombëtar	Planifikimi hapësinor në nivel lokal
<b>Faza A:</b> <i>Përcaktimi i kontekstit dhe shqyrtimit (studimit)</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Korniza strategjike përfaqësohet kryesisht nga objektivat mjedisore të përcaktuara nga politikat ndërkombëtare dhe të KE-së, si dhe nga politikat në nivel kombëtar. Duhet të bëhet një inventar i politikave të tilla, duke theksuar elementet e interesit të veçantë për planin në konsideratë</li> <li>■ Studimi themelor kryesisht bazohet në raportet në nivel kombëtar</li> <li>■ Synimet e VSM-së janë të përgjithshme, të frymëzuara nga parimet e zhvillimit të qëndrueshëm të përcaktuara në politikat kombëtare, si dhe deklaratat apo marrëveshjet ndërkombëtare</li> <li>■ Vendet fqinje mund të përfshihen në konsultim</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Korniza strategjike duhet të referohet vetëm te elementet relevante në nivel lokal të kornizës së përcaktuar nga planet në nivel kombëtar (shih kolonën në të majtë) dhe të shtohen elemente të veçanta të planeve të tjera në nivel lokal apo rajonal (p.sh., PZHK-ja e komunave fqinje)</li> <li>■ Studimi themelor duhet të përfshijë gjithashtu edhe të dhënat e nivelit lokal (p.sh. GIS komunale) dhe të plotësohet me anketime në terren</li> <li>■ Synimet e VSM-së janë më specifike dhe duhet të jenë të arritshme (dhe të matshme) në nivel komunal</li> <li>■ Komunitat fqinje duhet të përfshihen në konsultim</li> </ul>
<b>Faza B:</b> <i>Mbështetja e projektimit të planit dhe vlerësimi i ndikimeve</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Vlerësimi i ndikimit është kryesisht cilësor dhe i bazuar në krahasimin e skenarëve të ardhshëm</li> <li>■ Alternativat janë kryesisht në atë formë që nëse një politikë e dhënë duhet të miratohet apo jo, dhe nëse po, me çfarë karakteristika të përgjithshme</li> <li>■ Vlerësimi i ndikimeve kumulative përfshinë analizën e ndikimeve të kombinuara të planit të veprimit me ndikime në politikat e arsyeshme të parashikueshme në të kaluarën dhe të tashmen, planet dhe programet brenda kufijve të arsyeshëm hapësinor dhe kohor</li> <li>■ Masat lehtësuese janë kryesisht në formën e rregulloreve dhe politikave që mund të përdoren për të përmirësuar kushtet mjedisore, ose të kufizojnë ndikimet e parashikuara</li> <li>■ Masat e kompensimit mund të harmonizohen me ofrimin e strategjive ose politikave të tjera kombëtare (p.sh. politika pa humbje neto për zona të rëndësishme natyrore)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Vlerësimi i ndikimit ka një komponent të madh sasior, veçanërisht për planet që ofrohen për rregulloret e detajuara (p.sh një skemë e zonimit e një plani urban që identifikon ndryshimet e përdorimit të tokës të lejuara / ndaluara në çdo njësi të tokës)</li> <li>■ Analiza e alternativave të përfshijë krahasimin e vendndodhjes të mundshme për një zhvillim të caktuar, si dhe detajet e zbatimit</li> <li>■ Vlerësimi i efekteve kumulative fokusohet kryesisht në ndërveprimin e ndikimeve të shkaktuara nga veprimet e ndryshme brenda planit</li> <li>■ Masat lehtësuese mund të përfshijnë detaje se si projektet duhet të hartohen dhe zbatohen, duke dhënë rekomandime për projektimin e VNM-së</li> <li>■ Masat e kompensimit janë të përgatitura që të ndodhin brenda kufijve të zonës së planifikimit</li> </ul>
<b>Faza C:</b> <i>Përgatitja e</i>	-	-

Fazat e VSM-së	Plani hapësinor në nivel kombëtar	Planifikimi hapësinor në nivel lokal
<i>raportit të VSM-së</i>		
<b>Faza D:</b> <i>Konsultimi dhe vendimmarrja</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Duhet të konsiderohet mundësia e aranzhimit të debateve publike të de-centralizuara (p.sh. debatet e aranzhuara në rajone të ndryshme të Kosovës)</li> </ul>	
<b>Faza E:</b> <i>Monitorimi dhe zbatimi i planit</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Monitorimi duhet të përfshijë agjencitë përkatëse (siç është AKMM) dhe të harmonizohet me protokollet e mbledhjes së të dhënave të përcaktuara nga agjenci të tilla</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Monitorimi duhet të kryhet nga krahasimi i të dhënave të prodhuara nga agjencitë në nivel kombëtar, si dhe mbledhjen e të dhënave të reja në nivel komunal. Plani i monitorimit duhet të përfshijë detyra që mund të realizohen në mënyrë të arsyeshme në nivel komunal, duke pasur parasysh çështje të tilla si kufizimet buxhetore dhe kohore, ekspertizën, etj.</li> </ul>

#### **Kutia 4.1.1 Rekomandime të veçanta për VSM-në e Hartave Zonale të Komunave**

VSM-ja e HZK duhet të bazohet në VSM-në e Planit Zhvillimor Komunal përkatës (PZHK), duke shmangur dyfishimin e përpjekjeve dhe për të siguruar një vlerë të shtuar reale në marrjen e vendimeve. HZK-ja mund të përmbajë elemente shumë specifike me një përmbajtje të kufizuar "strategjike", dhe një përmbajtje më operative dhe të bazuar në nivelin e projektit. Kjo është për shkak se një HZK mundet në pjesë të madhe, të pasqyroj vendimet strategjike të bëra në PZHK, duke u dhënë atyre një përfaqësim eksplicit më të prekshëm dhe hapësinor (p.sh., vendndodhja e saktë e infrastrukturave, kufijtë e zonave ku përdorimet e ndryshme të tokës janë të lejuara/ndaluara). Sipas rrethanave, VSM-ja për HZK duhet të marr parasysh rekomandimet e mëposhtme:

- Të ndërtohet në kornizën strategjike të përcaktuar nga VSM-ja e PZHK-së. Duhet të shmangen dyfishimi i VSM-së së PZHK-së, veçanërisht në qoftë se HZK-ja është projektuar menjëherë pas PZHK-së. Korniza strategjike e përgatitur gjatë PZHK-së është në përgjithësi e vlefshme edhe për HZK-në, përveç nëse kanë ndodhur ndryshime të rëndësishme. Pra VSM-ja e PZHK-së thjesht mund t'i referohet kësaj kornize strategjike, dhe të shtoj elemente të reja, sipas nevojës.
- Përpunimi i synimeve të VSM-së. Synimet e VSM-së të vendosura gjatë PZHK-së duhet të jenë të vlefshme edhe për HZK-në, përveç nëse kanë ndodhur ndryshime të rëndësishme. Pra, VSM-ja e HZK-së duhet thjesht t'i referohet këtyre objektivave dhe, kur është e nevojshme, ti përsos ato, p.sh. duke ofruar më shumë pikësynime më të detajuara ose sasiore.
- Të ndërtohet në bazë të studimit themelor të kryer nga VSM-ja e PZHK-së. Gjithashtu këtu duhet të shmangen dyfishimet, në vend të përsëritjes së studimit themelor të VSM-së për PZHK-në, VSM-së për HZK-në duhet të marrë atë të kryer, dhe të shtohen vetëm ato elemente që kërkojnë më shumë detaje se ato të ofruara gjatë PZHK-së. Për shembull, mund të përgatitet një hartë më e detajuar (dhe e kontrolluar në terren) e shfrytëzimit dhe mbulimit të tokës, të paktën për ato zona ku janë të parapara, nga HZK, transformimet e përdorimit të tokës.
- Kryerja e analizave sasiore. Disa HZK do të përmbajnë indikacione që lejojnë një analizë sasiore të efekteve mjedisore. Në këto raste, duhet të ndërmerret një analizë e tillë sasiore. Një shembull tipik është humbja e tokës për shkak të zhvillimit të ri urban. Nëse HZK përcakton saktë kufijtë dhe kushtet (p.sh. dendësinë e strehimit, etj) VSM-ja duhet të përdor këtë informacion për të prodhuar vlerësime sasiore të humbjes së tokës, në vend të indikacioneve dhe tendencave të përgjithshme (siç ndodh zakonisht në nivelin e PZHK-së).
- Fokusimi në alternativat e nivelit të projektit. Për shumicën e HZK-ve alternativat që do të konsiderohen do të kenë një dimension të kufizuar strategjik, sepse kjo është trajtuar tashmë nga PZHK-ja. Për shembull, nëse duhet të ndërtohet një infrastrukturë e re rrugore, apo promovohet zhvillimi i mëtejshëm industrial, PZHK-ja është ajo që vendos. HZK-ja do të përqendrohet se ku do të ndodhin këto zhvillime, dhe me çfarë karakteristikash (shih dy nivelet e fundit të hierarkisë së alternativave të paraqitura në figurën 14.). Në mënyrë të vazhdueshme, VSM-ja duhet të fokusohet në analizën e vendndodhjeve alternative (p.sh. nga GIS mbishtresim i hartave tematike) dhe alternativa kohore ose detajet e ndërtimit.
- Masat lehtësuese të jenë të qarta. Duke pasur parasysh se ndikimet do të jenë më të qarta (dhe shpesh sasiore) në nivelin e HZK-së, edhe masat lehtësuese për të ulur ndikimet e tilla duhet të përcaktohen në mënyrë të qartë gjatë VSM-së. Masat lehtësuese të përgjithshme të parapara nga VSM-ja e PZHK-së duhet tu jepet një përkufizim më i detajuar gjatë VSM-së së HZK-së - çfarë do të bëhet? Si? Ku? Me cilat burime? Kush do të jetë përgjegjës për kryerjen / kontrollin e zbatimit të lehtësirave?

#### Kutia 4.1.2 Procesi i një VSM-je kualitative

- |                                       |  |
|---------------------------------------|--|
| Është e integruar                     | <ul style="list-style-type: none"><li>■ Siguron një vlerësim të duhur mjedisor për të gjitha vendimet strategjike relevante për arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm.</li><li>■ Adreson ndërlihdjet në aspektin biofizik, shoqëror dhe ekonomik.</li><li>■ Është i shtresuar në politikat e sektorëve përkatës dhe rajonet (ndërkufitare) dhe, kur është e përshtatshme, në projektet e VNM-të dhe vendimmarrje.</li></ul> |
| Është e udhëhequr nga qëndrueshmërisë | <ul style="list-style-type: none"><li>■ Lehtëson identifikimin e mundësive zhvillimore dhe propozimeve alternative që janë më të qëndrueshme.</li></ul>  |
| Është e fokusuar                      | <ul style="list-style-type: none"><li>■ Ofron informata të mjaftueshme, të besueshme dhe të dobishëm për planifikimin e zhvillimit dhe vendimmarrjen.</li><li>■ Përqendrohet në çështjet kyçe të zhvillimit të qëndrueshëm.</li><li>■ Është përshtatur me karakteristikat e procesit të vendimmarrjes.</li><li>■ Është kosto dhe kohë efektive.</li></ul>  |
| Është e përgjegjshme                  | <ul style="list-style-type: none"><li>■ Është përgjegjësi e agjencive kryesore për marrjen e vendimeve strategjik.</li><li>■ Është kryer me profesionalizëm, saktësi, drejtësi, paañesi dhe ekuilibër.</li><li>■ Është subjekt i kontrolleve dhe verifikimit të pavarur.</li><li>■ Dokumenton dhe justifikon mënyrën se si janë marrë në konsideratë çështjet e qëndrueshmërisë në vendimmarrje.</li></ul>                 |
| Është pjesëmarrëse                    | <ul style="list-style-type: none"><li>■ Informon dhe përfshin organet qeveritare dhe publike të interesuara dhe të prekura në të gjithë procesin e vendimmarrjes.</li><li>■ Në mënyrë eksplicite adreson inputet dhe shqetësimet e tyre në dokumentimin dhe vendimmarrjen.</li><li>■ Ka kërkesa të qarta, lehtë të kuptueshme dhe siguron qasje të mjaftueshme në të gjitha informatat relevante.</li></ul>                |
| Është ri-përsëritëse                  | <ul style="list-style-type: none"><li>■ Siguron disponueshmërinë e rezultateve të vlerësimit në fillim për të ndikuar në procesin e vendimmarrjes dhe për të frymëzuar planifikimin e ardhshëm.</li><li>■ Ofron informata të mjaftueshme mbi ndikimet aktuale të zbatimit të një vendimi strategjik, për të gjykuar nëse ky vendim duhet të ndryshohet dhe për të siguruar një bazë për vendimet e ardhshme.</li></ul>     |

*Burimi: IAIA (2002).*



#### Kutia 4.1.3 Një përmbledhje e shkurtër e VSM-së

VSM-ja ofron një qasje sistematike për shqyrtimin e çështjeve mjedisore brenda procesit të planifikimit hapësinor. VSM-ja duhet të konsiderohet si një mjet plotësues për të promovuar zhvillimin e qëndrueshëm: në nivelet më strategjike, proceset që sjellin analiza cilësore, pjesëmarrje dhe komunikim janë më të përshtatshme se metodologjitë teknike.

- **NJË PROCES KREATIV INTEGRUES:** ndërton vlerësimin prej **fazave të hershme të planifikimit**, duke përfshirë të **gjithë palët relevante të interesit** në proces: organet kompetente dhe politikë-bërësit, planifikuesit, praktikuesit e VSM-së dhe akterët e të tjerë kyç. Gjatë këtyre proceseve, **VSM-ja mund të përdoret si një proces kreativ** për të mësuar dhe ndarë informacion mbi aspektet mjedisore të zonave nën studim dhe duhet të konsiderohen disa nga **teknikat** e zakonshme për vlerësim të qëndrueshmërisë, të tilla si:
  - vlerësimi matric, p.sh. matja e ecurisë së veçantë për secilën mundësi të planifikimit kundrejt kriterëve mjedisore;
  - analiza e shumë kriteresh;
  - shqyrtimi dhe vlerësimi i skenarëve të ndryshëm;
  - përdorimi i GIS-it, përfshirë edhe procesin analitik të hierarkisë (AHP);
  - teknikat pjesëmarrëse;
  - 'diskursi bashkëpunues' në të cilin grupet e interesit përzgjedhin kriteret e vlerësimit, ekspertët prezantojnë informatat dhe matin ndikimet, dhe qytetarët eksplorojnë vlerat, etj.

Një proces integrues ngrihet mbi një platformë për dialog me palët e interesit në nivelet përkatëse gjeografike / administrative dhe është një element kyç i një procesi të suksesshëm të VSM-SË.

- **STRATEGJIK:** Përdorimi i VSM-së si një proces strategjik, duke u fokusuar në aktivitetet e formësimit të planit dhe të projektuara për të shmangur mundësitë e ardhshme kontradiktore në nivel të VNM-së. Për shkak se ajo kryhet në një fazë të hershme të procesit të planifikimit hapësinor, VSM-ja mund të adresojë çështjet kryesore mjedisore në mënyrën se si ato ndikojnë në llojet e ndryshme të projekteve kur mundësitë janë ende të hapura. VSM-ja duhet të përballlet me sfidat globale dhe të zhvillojë mjete që të përfshijë më mirë kufizimet mjedisore dhe ndryshimet klimatike.
- **KONTEKSTI I VEÇANTË:** Shqyrtimi i çështjeve mjedisore duhet të jetë i përshtatur me **kontekstin e veçantë** të PP-ve. Synimet e çështjes mjedisore duhet të identifikohen dhe të projektohen për çdo kontekst të veçantë dhe çdo VSM duhet të jetë potencialisht e ndryshme. Listat kontrolluese janë mjete të dobishme, por nuk duhet të zëvendësojnë kreativitetin e zgjedhjeve të kontekstit të veçantë.
- **THJESHTËSIA:** Të jeni praktik dhe të përdorni një vlerësim të shëndoshë në vlerësim. Gjatë këshillimit me palët e interesit shmangni shpërqendrimin e tyre me zhargone apo duke kaluar në konkludime të menjëhershme, pa i dhënë kohë të duhur për diskutim, kuptim të duhur të situatave komplekse dhe shkëmbim të ideve nga të gjithë.
- **VENDOSJA E PRITSHMËRIVE REALE:** Duhet të kuptohet se përfitimet që vijnë nga VSM-ja mund të bëhen të dukshme vetëm pas një kohe. Vlera më e madhe duhet të vendoset në efektivitetin indirekt, si dhe në rritjen e ndërgjegjësimit mjedisor dhe proceset e të mësuarit.

Procesi i vlerësimit strategjik mjedisor në Kosovë përfshin disa parime të cilat janë konsideruar si pjesë e udhëzimit të ofruar nga UN-Habitati për autoritetet komunale:

- marrja në konsideratë e të dhënave sasiore dhe cilësore gjatë analizës;
- ofrimi i barazisë midis brezave dhe pakicave duke marrë parasysh grupet e ndryshme sociale dhe interesat e tyre të veçanta;
- ofrimi i mundësive për të mësuar gjatë procesit;
- sigurimi i transparencë në çdo hap të VSM-së; dhe
- pasja e një elementi të fortë të angazhimit publik dhe grupeve të interesit.

## REFERENCAT

---

ABAZA, H., BISSET, R., SADLER, B. (2004) *Environmental Impact Assessment and Strategic Environmental Assessment: Towards an Integrated Approach*, UNEP

Agência Portuguesa do Ambiente (2007) *Guia de boas práticas para a Avaliação Ambiental Estratégica: Orientações Metodológicas*, Lisbon, Direcção-Geral do Ordenamento do Território e Desenvolvimento Urbano

ANDRÉ, Pierre et al (2006) *Public participation: international best practice principles*, *Publikim i Veçantë, Seria nr. 4*, Fargo, SHBA, Asociacioni Ndërkombëtarë për Vlerësimin e Ndikimit

BOND, A., MORRISON-SAUNDERS, A., STOEGLHNER, G. (2013) Hartimi i një procesi të vlerësimit efektiv të qëndrueshmërisë, në: BOND, A., MORRISON-SAUNDERS, A. dhe HOWITT, R. (eds) *Sustainability Assessment Pluralism: Practice and Progress*, Routledge, 231-244

BRAGAGNOLO, C., GENELETTI, D., FISCHER, T.B. (2012) Efektet kumulative në VSM-të e planeve hapësinore- dëshmi nga Italia dhe Anglia, *Impact Assessment and Project Appraisal* 30 (2), fq. 100-110

CALTHORPE, Peter (2010) *Urbanism in the age of climate change*, Washington, Revista Island

COOPER, L. M. (2004) *Guidelines for Cumulative Effects Assessment in SEA of Plans*, EPMG Occasional Paper 04/LMC/CEA, Kolegji Mbretërorë, Londër

Komisioni Evropian (2013) *Guidance on Integrating Climate Change and Biodiversity into Strategic Environmental Assessment*, Bashkimi Evropian  
[<http://ec.europa.eu/environment/eia/sea-support.htm>]

Komisioni Evropian (2010) *Libri vjetor rajonal i EUROSTAT-it 2010*, Luksemburg, Zyra për publikime e Bashkimit Evropian

Komisioni Evropian (2003) *Zbatimi i Direktivës 2001/42/EC për Vlerësimin e Efekteve në Mjedis të Planeve dhe Programeve të caktuara*, Bruksel  
[[http://ec.europa.eu/environment/eia/pdf/030923\\_sea\\_guidance.pdf](http://ec.europa.eu/environment/eia/pdf/030923_sea_guidance.pdf)]

Komisioni Evropian (1999) *Perspektiva Evropiane e Zhvillimit Hapësinor: Drejt një Zhvillimi të balancuar dhe të Qëndrueshëm të Territorit të Bashkimit Evropian*, Bruksel

GENELETTI, D. (2013). *Strategic Environmental Assessment: General principles*. Material ligjërues për kursin afatshkurtër mbi VSM-në për planifikim hapësinor dhe urban. Universiteti i Trentos.

GENELETTI, D. and BRAGAGNOLO, C. (2009), *L'uso di indicatori per il confronto tra scenari nella Valutazione Ambientale Strategica, Sentieri Urbani. I(2), 33-37.*

GENELETTI, D., BAGLI, S., NAPOLITANO, P., PISTOCCHI, A. (2007) Mbeshtetja për vendimin hapësinor për vlerësimin mjedisor të planeve për shfrytëzimin e tokës: Një rast studimor në Italinë jugore, *Environmental Impact Assessment Review*, 27: 408-423,

GEHL, Jan (2010) *Cities for people*, Washington|Covelo|Londër, Island Press

Asociacioni Ndërkombëtarë për Vlerësimin e Ndikimit (2002) *Strategic Environmental Assessment: Performance Criteria*, Publikimet e veçanta IAIA, seria nr. 1  
[Shih: <http://www.iaia.org/publicdocuments/special-publications/sp1.pdf>]

Office of the Deputy Prime-Minister (2005) *A Practical Guide to the Strategic Environmental Assessment Directive*, London, ODPM Publications

OECD (2006) *Applying Strategic Environmental Assessment: Good practice guidance for development co-operation*, DAC Guidelines and Reference Series

[Shih: <http://www.oecd.org/dac/environment-development/37353858.pdf>]

PARTIDÁRIO, Maria do Rosário (2012) *Strategic Environmental Assessment Better Practice Guide: Methodological guidance for strategic thinking in SEA*, Lisbonë, Agência Mjedisore e Portugalisë dhe Redes Energéticas Nacionais (REN)

PARTIDÁRIO, Maria do Rosário (2007) *Guia de Boas Práticas para Avaliação Ambiental Estratégica: Orientações Metodológicas*, Lisbonë, Agência Mjedisore e Portugalisë

PINHEIRO, Manuel Duarte (2006) *Ambiente e construção sustentável*, Amadora, Instituto do Ambiente

Regional Environmental Center for Central and Eastern Europe (2003) *EIA training resource manual for South Eastern Europe*, Szentendre, REC

SADLER, B. (2011) Taking stock of SEA, In: SADLER, B., ASCHEMANN, R., DUSIK, J., FISCHER, T.B., PARTIDARIO, M., VERHEEM, R. (eds), *Handbook of strategic environmental assessment*, London, Earthscan, 1-19

SADLER, B. and R. VERHEEM (1996) *Strategic Environmental Assessment*, Volume 53: Status, Challenges and Future Directions, Ministry of Housing, Spatial Planning and the Environment, The Netherlands, and the International Study of Effectiveness of Environmental Assessment

THERIVEL, R. (2004) *Strategic Environmental Assessment in action*, Earthscan, Londër

UNEP (2014) *Integrating ecosystem services in Strategic Environmental Assessment: A guide for practitioners*, A report of Proecoserv. Geneletti, D.

[<http://www.proecoserv.org/information-hub-test/guideline.htm>]

UNEP (2009) *Integrated Assessment for Mainstreaming Sustainability into Policymaking: A Guidance Manual* [<http://www.unep.ch/ETb/publications/AI%20guidance%202009/UNEP%20IA%20final.pdf>]

VERHEEM, R. (1996) *Handbook of strategic environmental assessment*, London, Earthscan, 1-19

**Adaptimi (ndryshimet klimatike):** Rregullimi në sistemet natyrore apo njerëzore në reagim ndaj stimujve aktual ose të pritshëm klimatik dhe efekteve të tyre, të cilat modelojnë dëmet ose shfrytëzojnë mundësitë e dobishme. (IPCC)

**Baza:** Një përshkrim i gjendjes aktuale dhe të ardhshme, në qoftë se plani ose programi (PP) nuk është zbatuar, duke marrë parasysh ndryshimet që rezultojnë nga dukuritë natyrore dhe nga aktivitetet e tjera njerëzore.

**Biodiversiteti:** Konventa mbi Diversitetin Biologjik (CBD) përcakton diversitetin biologjik si 'ndryshueshmëria midis organizmave të gjallë nga të gjitha burimet, duke përfshirë, ndër të tjera ato tokësore, detare dhe ekosistemet e tjera ujore si dhe komplekset ekologjike ku ata janë pjesë; kjo përfshin shumëllojshmërinë brenda llojeve, mes llojeve dhe të ekosistemeve '(Neni 2).

**Izolimi i karbonit:** Largimi i karbonit nga atmosfera dhe ruajtja e tij në mjedis ujore (si oqeanet, pyjet ose tokat) përmes proceseve fizike ose biologjike, të tilla si fotosinteza.

**Ndryshimet klimatike:** Çdo ndryshim i klimës me kalimin e kohës, qoftë për shkak të ndryshimeve natyrore ose si rezultat i aktivitetit të njeriut. (IPCC)

**Komisioni:** organi i propozuar nga Ministria dhe i miratuar nga Qeveria, në rastin kur Ministria është autoriteti përgjegjës i planit ose programit.

**Organet konsultative:** Ministria ose, kur Ministria është vetë autoriteti përgjegjës, Komisioni; dhe të gjitha organet e tjera të caktuara me ligj që kanë përgjegjësi të veçanta mjedisore dhe të cilat Ministria i konsideron se mund të kenë lidhje me planin ose programin e propozuar.

**Ndikimet kumulative:** ndikimet e shkaktuara nga disa projekte dhe veprime strategjike që rezultojnë nga një veprim i propozuar.

**Ndikimet e drejtpërdrejta:** efektet mjedisore të shkaktuara drejtpërdrejtë nga zbatimi i një PP-je.

**Shërbimet e ekosistemit:** Përfitimet e marrura nga ekosistemet. Vlerësimi i Ekosistemit të Mijëvjeçarit nga Kombet e Bashkuara përcakton katër kategori të shërbimeve të ekosistemit që kontribuojnë në mirëqenien e njeriut:

- shërbimet ofruese, p.sh. ushqimet organike, të lashtat, uji i freskët dhe ilaçet bimore;
- shërbimet rregullative p.sh. filtrimi i ndotësve nga ligatinat, rregullimi i klimës përmes ruajtjes së karbonit dhe riciklimit të ujit, pllenimi dhe mbrojtja nga fatkeqësitë;
- shërbimet kulturore p.sh. rekreative, vlerat shpirtërore dhe estetike, arsimit;
- shërbimet mbështetëse p.sh. formimi i tokës, fotosinteza dhe riciklimi i lëndëve ushqyese.

**Vlerësimi mjedisor:** Metoda ose procedura për vlerësimin e mjedisit. Në Direktivën e VSM-së (Neni 2 (b)), një vlerësim mjedisor nënkupton "përgatitjen e një raporti mjedisor, kryerjen e konsultimeve, marrja parasysh e raportit mjedisor dhe rezultatet e konsultimeve në vendimmarrje dhe ofrimi i informacionit mbi vendimmarrjen.

**Vlerësimi i ndikimit mjedisor:** Vlerësimi i ndikimit në mjedis: Procesi i shqyrtimit të pasojave mjedisore të projekteve zhvillimore përpara vendimmarrjes. Ai ndryshon nga Vlerësimi Strategjik Mjedisor në kuptimin se ai në përgjithësi i referohet efekteve më specifike që rrjedhin nga zbatimi i projektit në nivel lokal ndërsa shumë vendime negative për mjedisin tashmë të marra në nivel më të gjerë strategjik (për shembull fakti se infrastruktura e re e transportit mund të gjenerojë rritje të kërkesës për udhëtim). Fazat e një VNM-je mund të përfshijnë:

- vendimi nëse nëse nevojitet ose jo një VNM ("ekzaminimi")
- vendimi se cilat ndikime dhe çështje duhet të adresohen ("shqyrtimi (studimi)")
- përshkrimi i projekteve dhe alternativave të propozuar

- përshkrimi i bazës mjedisore
- parashikimi dhe vlerësimi i ndikimeve të mundshme të projektit bazë
- propozimi i masave për të lehtësuar çdo ndikim të rëndësishëm negativ (dhe gjithashtu për të rritur më tej ndikimet pozitive)
- raportimi i gjetjeve në një deklaratë të ndikimit mjedisor
- përfshirja e publikut dhe palëve të tjerë të interesuara / të prekura në faza të ndryshme të VNM-së.

**Raporti mjedisor:** Dokument që kërkohet nga Direktiva e VSM-së si pjesë e një vlerësimi mjedisor, i cili identifikon, përshkruan dhe vlerëson ndikimet e mundshme domethënëse në mjedis nga zbatimi i një PP-je. Në legjislacionin e Kosovës kjo korrespondon me raportin e VSM-së.

**Fauna:** Kafshët e një rajoni ose habitati të caktuar.

**Flora:** Bimët e një rajoni ose habitati të caktuar.

**Infrastruktura e gjelbër (IGJ):** infrastruktura e gjelbër iu shërben interesave të të njerëzve dhe natyrës. Ajo mund të përkufizohet si rrjet strategjik i planifikuar dhe i vendosur në hapësirat e gjelbra me cilësi të lartë dhe karakteristika të tjera të mjedisit. Infrastruktura e gjelbër përfshin zonat natyrore dhe gjysëm natyrore, karakteristikat dhe hapësirat e gjelbra në zonat rurale dhe urbane, tokësore, ujërave të ëmbla, bregdetare dhe detare. Ajo duhet të jetë e projektuar dhe menaxhuar si burim shumë funksional i aftë për të ofruar një gamë të gjerë të përfitimeve dhe shërbimeve. Zonat e mbrojtura si vendet e Natura 2000 janë në thelbin e infrastrukturës së gjelbër.

**Gazrat serrë (GHG):** Çdo gaz atmosferik (qoftë natyror ose antropogjen në origjinë) i cili absorbon rrezatimin termik të emituar nga sipërfaqja e Tokës. Ky e ngërthen ngrohjen në atmosferë dhe e mban sipërfaqen në një temperaturë të ngrohtë se sa ndryshe do të ishte e mundur.

**Treguesi:** Një pjesë e informacionit, në përgjithësi sasiore, e cila përdoret për të matur dhe përcjellur gjendjen aktuale dhe progresin e një sistemi kompleks. Në kuadër të VSM-së, treguesit shpesh herë janë përdorur për të matur nivelin e suksesit të një plani apo projekti dhe arritjen e objektivave.

**Ndikimet e tërthorta:** Ndikimet që mund të jenë shkaktuar nga një projekt apo veprim strategjik, për shembull zhvillimi që ndodh rreth kryqëzimeve magjistrale pas ndërtimit të një autostrade. Gjithashtu këto quhen edhe ndikime të krijuara ose të shkaktuara.

**Masat lehtësuese:** Masat që shmangin, reduktojnë, rregullojnë apo kompensojnë ndikimet domethënëse negative të një veprimi strategjik në mjedis.

**OJQ:** Organizata jo-qeveritare (p.sh. shoqatat qytetare, sindikata e fermerëve) të themeluara juridikisht nga persona fizikë ose juridikë që veprojnë në mënyrë të pavarur nga çdo qeveri.

**Objektivi:** Qëllimi i veprimit strategjik ose VSM-së, duke specifikuar se çfarë përpiqet të arrijë, drejtimi i dëshiruar i ndryshimit ose përmirësimit në trendet aktuale.

**Plani:** Procedura e formalizuar, vendosja e objektivave të koordinuara dhe në kohën e duhur për zbatimin e një politike.

**PP:** planet dhe programet, që përfshijnë edhe ato të bashkë-financuara nga Bashkimi Evropian ose institucionet e tjera ndërkombëtare, si dhe çdo ndryshim në ato, të cilat janë subjekt i përgatitjes ose miratimit (ose të dyja) nga një autoritet në nivel kombëtar, rajonal ose lokal; ose janë të përgatitura nga një autoritet për miratim, me procedurë legjislative, rregullatore ose administrative nga Parlamenti apo Qeveria.

**Publiku:** Një ose më shumë persona fizikë ose juridikë, dhe shoqatat, organizatat apo grupet e tyre.

**Elasticiteti:** Aftësia e një sistemi shoqëror ose ekologjik për të absorbuar çrregullimet, duke ruajtur të njëjtën strukturë themelore dhe sistemin e funksionimit, si dhe kapacitetin e tij për të ri-organizuar veten dhe për tu përshtatur me stresin dhe ndryshimin.

**Organi përgjegjës:** në lidhje me një plan ose program, do të thotë organi nga i cili ose në emër të të cilit ai është përgatitur.

**Shqyrtimi (studimi):** Procesi i vendosjes së përmbajtjes dhe nivelit të detajuar në një VSM (llojet e efekteve alternativave mjedisore që duhet të merren parasysh) dhe se si VSM-ja duhet të kryhet (afati kohor, metodologjia, struktura e raportit, etj). Ky proces duhet të kryhet në fillim, idealisht në konsultim me autoritetin kompetent dhe grupet e prekura.

**Direktiva e VSM-së:** Direktiva Evropiane 2001/42/EC “për vlerësimin e efekteve të planeve dhe programeve të caktuara në mjedis”.

**Raporti i VSM-së:** Raporti kërkohet nga Direktiva e VSM-së dhe legjislacioni i Kosovës si pjesë e vlerësimit strategjik mjedisor, i cili identifikon, përshkruan dhe vlerëson ndikimet e mundshme domethënëse në mjedis gjatë zbatimit të një plani ose programi. Dokumenti duhet të regjistrojë procesin dhe gjetjet e procesit të VSM-së. Po ashtu ai quhet edhe raporti mjedisor.

**Ndikimet dytësore:** Efektet që ndodhin si pasojë e një efekti primar apo si rezultat i një shtegu kompleks (shih gjithashtu ndikimet indirekte).

**Grupi i interesit:** Dikush që ndikohet nga veprimi strategjik: ata kanë një interes në të.

**Veprim strategjik:** Një vendim që është "mbi" nivelin e projektit: politika, plani ose programi.

**Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM):** Vlerësimi mjedisor i aplikuar në plane ose programe, që kërkon një proces të parashikimit dhe vlerësimit të ndikimit të një veprimi strategjik në mjedis. Informacioni që buron nga VSM-ja ka për qëllim të përdoret në vendimarrje. Gjithashtu ai referohet si vlerësim i qëndrueshmërisë, vlerësimit mjedisor, vlerësimit sektorial, vlerësim i ndikimit programatik mjedisor. Në këtë udhëzues, VSM-ja është përdorur për t'iu referuar llojit të vlerësimit mjedisor që kërkohet në bazë të Direktivës së VSM-së dhe Ligjit të Kosovës, gjegjësisht në procesin e përgatitjes së raportit të VSM-së, kryerjen e konsultimeve, marrjen parasysh të raportit mjedisor dhe rezultatet e konsultimeve në vendimarrje dhe ofrimin e informacionit mbi vendimet në përputhje me këtë ligj.

## SHTOJCA I: LISTA PËRKATËSE E DIREKTIVAVE TË BE-SË PËR MJEDISIN

Propozimi i Planifikimit	Çështjet relevante gjinore	Rreagimi komunitetit	Implikimet gjinore	Implikimet e planifikimit
<i>Zhvillimi i një rrjeti ekologjik koherent të lëvizshmërisë të butë dhe zonës natyrore rekreative</i>	<i>Kush ka qasje në rrjetin ekologjik dhe / ose zonat rekreative?</i>	<i>Kontrolloni nevojat e komunitetit, kërkesat dhe prioritetet (për shembull gjatë konsultimeve).</i>	<i>Më pak angazhime të qytetarve në aktivitete rekreative, implikimet e sigurisë.</i>	<i>Shmangni propozime të projekteve që promovojnë mjediset e pasigurta dhe sjelljet. Kontrolloni se dizajni i plotëson nevojat e përdoruesve</i>
<i>Shërbimet e integruara të parashkollave</i>	<i>Kush bën çfarë?  Cilat janë kushtet në aspektin e qasjes të shërbimeve?</i>	<i>Reagim mbi përgjegjësitë.  Kontrolloni kushtet e përshtatshmërisë (koha e udhëtimit, kushtet e rrugëve, infrastruktura, oraret, etj)</i>	<i>LMungesa e qasjes në lokacionin e parashkollorës, implikimet e sigurisë, më pak disponueshmërinë për mundësi punësimi.</i>	<i>Inkurajoni lokacionin e duhur në qendër të qytetit dhe konsiderojnieni aksesin e duhur në këtë lokacion. Plani i lëvizshmërid duhet të analizohet paralelisht.</i>

Pavarësisht nga fakti se Kosova ende nuk është një shtet anëtarë e Bashkimit Evropian, Qeveria e saj është e angazhuar shumë për të arritur statusin e saj si para-kandidat dhe për këtë arsye transpozojnë Direktivavat të BE-së në kornizën legjislative të Kosovës. Si e tillë, është e rekomandueshme që VSM-ja duhet të marrë parasysh Direktivat e BE-së dhe rregulloret në vijim, në mënyrë që të përmbushë aq sa është e mundur standardet dhe procedurat e BE-së nga një fazë të hershme:

1. Council Directive n.76/464/EEC of 04.05.1976 “on pollution caused by certain dangerous substances discharged into the aquatic environment of the Community”;
2. Council Directive n.79/409/EEC of 02.04.1979 “on the conservation of wild birds”;
3. Council Directive n.80/68/EEC of 17.12.1979 “on the protection of groundwater against pollution caused by certain dangerous substances”;
4. Council Directive n.82/501/EEC of 24.06.1982 “on the major-accident hazards of certain industrial activities”;
5. Council Directive n.85/337/EEC of 27 June 1985 “on the assessment of the effects of certain public and private projects on the environment”;
6. Council Directive n.88/609/EEC of 24.11.1988 “on the limitation of emissions of certain pollutants into the air from large combustion plants”;
7. Council Directive n.91/271/EEC of 21.05.1991 “on urban waste water treatment”;
8. Council Directive n.91/676/EEC of 12.12.1991 “on the protection of waters against pollution caused by nitrates from agricultural sources”;
9. Council Directive n.91/689/EEC of 12.12.1991 “on hazardous waste”;
10. Council Directive n.92/43/EEC of 21.05.1992 “on the conservation of natural habitats and of wild fauna and flora”
11. Council Regulation (EEC) n.259/93 of 01.02.1993 “on the supervision and control of shipments of waste within, into and out of the European Community”;

12. Council Decision n.93/98/EEC of 01.02.1993 “on the conclusion, on behalf of the Community, of the Convention on the control of transboundary movements of hazardous wastes and their disposal (Basel Convention)”;
13. Council Directive n.94/66/EC of 15.12.1994 amending Directive n.88/609/EEC “on the limitation of emissions of certain pollutants into the air from large combustion plants”;
14. Council Directive n.96/61/EC of 24.09.1996 “on integrated pollution prevention and control”;
15. Council Directive n.96/62/EC of 27.09.1996 “on ambient air quality assessment and management”;
16. Council Directive n.96/82/EC of 09.12.1996 “on the control of major-accident hazards involving dangerous substances”;
17. Council Directive n.97/11/EC of 03.03.1997 amending Directive n.85/337/EEC of 27.06.1985 “on the assessment of the effects of certain public and private projects on the environment”;
18. Council Directive n.1999/30/EC of 22.04.1999 “on limit values for sulphur dioxide, nitrogen dioxide and oxides of nitrogen, particulate matter and lead in ambient air”;
19. Council Directive n.1999/31/EC of 26.04.1999 “on the landfill of waste”;
20. Communication from the Commission COM (2000) 265 final of 03.05.2000 “promoting sustainable development in the EU non-energy extractive industry”;
21. Communication from the Commission COM (2000) 664 final of 23.10.2000 “on safe operation of mining activities: a follow-up to recent mining accidents”;
22. Directive n.2000/60/EC of the European Parliament and of the Council of 23.10.2000 “establishing a framework for Community action in the field of water policy”;
23. Directive n.2000/69/EC of the European Parliament and of the Council of 16.11.2000 “on limit values for benzene and carbon monoxide in ambient air”;
24. Directive n.2001/42/EC of the European Parliament and of the Council of 27.06.2001 “on the assessment of the effects of certain plans and programs on the environment”;
25. Directive n.2001/80/EC of the European Parliament and of the Council of 23.10.2001 “on the limitation of emissions of certain pollutants into the air from large combustion plants”
26. Decision n.2455/2001/EC of the European Parliament and of the Council of 20.11.2001 “establishing the list of priority substances in the field of water policy and amending Directive n.2000/60/EC”;
27. Directive n.2002/3/EC of the European Parliament and of the Council of 12.02.2002 “on the ozone in ambient air”;
28. Directive n.2003/35/EC of the European Parliament and of the Council of 26.05.2003 “providing for public participation in respect of the drawing up of certain plans and programs relating to the environment and amending with regard to public participation and access to justice of Council Directives n.85/337/EEC and n.96/61/EC”;
29. Directive n.2003/87/EC of the European Parliament and of the Council of 13.10.2003 “establishing a scheme for greenhouse gas emission allowance trading within the Community and amending Council Directive n.96/61/EC”;
30. Directive n.2004/107/EC of the European Parliament and of the Council of 15.12.2004 “relating to arsenic, cadmium, mercury, nickel and polycyclic aromatic hydrocarbons in ambient air”;



31. Directive n.2006/11/EC of the European Parliament and of the Council of 15.02.2006 “on pollution caused by certain dangerous substances discharged into the aquatic environment of the Community”;

32. Directive 2006/12/EC of the European Parliament and of the Council of 05.04.2006 “on waste”;

33. Directive 2006/21/EC of the European Parliament and of the Council of 15.03.2006 “on the management of waste from extractive industries and amending Directive n.2004/35/EC”;

34. Directive 2006/118/EC of the European Parliament and of the Council of 12.12.2006 “on the protection of groundwater against pollution and deterioration”;

35. Regulation (EC) n.166/2006 of the European Parliament and of the Council of 18.01.2006 “concerning the establishment of a European Pollutant Release and Transfer Register and amending Council Directives n.91/689/EEC and n.96/61/EC”;

36. Directive n.2008/1/EC of the European Parliament and of the Council of 15.01.2008 “concerning integrated pollution prevention and control”.

### **Raportë shtesë të rekomanduara**

1. European Commission, European Spatial Development Perspective: Towards Balanced and Sustainable Development of the Territory of the European Union

*[http://ec.europa.eu/regional\\_policy/sources/docoffic/official/reports/pdf/sum\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/regional_policy/sources/docoffic/official/reports/pdf/sum_en.pdf)*

## SHTOJCA II: LISTA PËRKATËSE E LEGJISLACIONIT DHE VEPRIMEVE STRATEGJIKE PËR MJEDISIN DHE PLANIFIKIMIN HAPËSINOR

Legjislacioni i Kosovës për mjedisin dhe planifikim hapësinor që duhet të merret parasysh:<sup>31</sup>

Nr. i Ligjit	Ligji për	Nr. Gazetës Zyrtare
03/L-025	Mbrojtjen e Mjedisit	50/06.04.2009
04/L-174	Planifikimin Hapësinor	30/23.08.2013
03/L-230	Vlerësimin Strategjik Mjedisor	83/29.10.2010
03/L-214	Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis	83/29.10.2010
03/L-233	Mbrojtjen e Natyrës	85/09.11.2010
04/L-086	Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna"	02/21.01.2013
04/L-087	Parkun Kombëtar "Sharri"	02/21.01.2013
02/L-078	Shëndeti Publik	35/15.08.2008
03/L-043	Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes	52/08.05.2009
03/L-160	Mbrojtjen e ajrit nga ndotja	67/29.03.2010
02/L-102	Mbrojtjen nga zhurma	40/15.10.2010
04/L-197	Kimikate	18/26.03.2014
04/L-060	Mbeturina	17/29.06.2012
03/L-119	Produktet Biocide	55/10.07.2009
04/L-147	Ujërat e Kosovës	10/29.04.2013
02/L-79	Veprimtaritë hidrometeorologjike	25/01.06.2008
04/L-120	Mbrojtjen e bimëve	1/17.01.2013
02/L-98	Mbrojtjen e varieteteve të bimëve	40/15.10.2008
04/L-013	Kadastër	13/01.09.2011
04/L-110	Ndërtim	18/03.07.2012
02/L-26	Tokat bujqësore	13/01.06.2007
04/L-040	Rregullimin e tokës	3/22.02.2012
03/L-163	Minierat dhe mineralet	80/27.08.2010
04/L-158	Ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03-L-163 për minierat dhe mineralet	11/02.05.2013
03/L-104	Mbrojtje nga rrezatimi jo-jonizes, jonizes dhe sigurinë nukleare	66/17.03.2010
04/L-067	Për Agjencinë e Kosovës për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguria bërthamore	18/03.07.2012

<sup>31</sup>Disa ligje mund të përmbajnë legjislacione sekondare shtesë, si udhëzime administrative.


Veprimet strategjike, raportet, dhe studimet kryesore ekzistuese për mjedis dhe planifikimit Strategjik,. Vlerësimi Strategjik Mjedisor pritet të merr në konsideratë dhe të shqyrtojë dokumentet e mëposhtme:

<b>Veprimet Strategjike</b>	<b>Autoritet</b>
Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020 +	MMPH
Plani Hapësinor Komunal (nëse është e përshtatshme)	Komuna
Strategjia dhe Plani i veprimit për biodiversitetin 2011-2020	MMPH
Strategjia për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm	MMPH
Plani i Kosovës për veprim në mjedis	MMPH
Plani lokal i veprimit në mjedis	Komuna
Plani i Republikës së Kosovës për menaxhimin e mbeturinave	MMPH
Strategjia e Republikës së Kosovës për menaxhimin e mbeturinave	MMPH
Strategjia dhe Plani i Veprimit për Cilësinë e Ajrit	MMPH
Strategjia për Zhvillimin e Pyltarisë	MBPZhR
Strategjia e Energjisë	MZhE
Strategjite e tjera sektoriale poashtu mund të konsultohen	Qeveria

<b>Referenca tjera</b>	<b>Burimi</b>
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Disa Fakte mbi Mjedisin - Anketa e Mbeturinave Komunale - Anketa e Ekonomive Shtëpiake Bujqësore -Të tjera	<a href="http://esk.rks-gov.net">esk.rks-gov.net</a>
Country Pasture/Forage Resource Profiles – Kosovo, FAO, 2009	Food and Agriculture Organization of the United Nations <a href="http://www.fao.org/ag/agp/AGPC/doc/Counprof/PDF%20files/Kosovo.pdf">http://www.fao.org/ag/agp/AGPC/doc/Counprof/PDF%20files/Kosovo.pdf</a>
Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale, Kosovë	Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale <a href="http://www.kosovo-mining.org/kosovoweb/al/mining/tectonics.html">http://www.kosovo-mining.org/kosovoweb/al/mining/tectonics.html</a>
River Pollution in Kosovo, Final report	<a href="https://wiki.rit.edu/display/0508484012121/Final+Report,+River+Pollution+In+Kosova">https://wiki.rit.edu/display/0508484012121/Final+Report,+River+Pollution+In+Kosova</a>
Raporte tjera	<a href="https://wiki.rit.edu/display/0508484012121/Kosovo+Project+Archive">https://wiki.rit.edu/display/0508484012121/Kosovo+Project+Archive</a>
Decentralizimi, Korrik 2011	Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale <a href="http://www.klg-institute.org/alb_decent.pdf">http://www.klg-institute.org/alb_decent.pdf</a>
The UNECE Convention on Access to Information, Public Participation in Decision-making and Access to Justice in Environmental Matters	<a href="http://live.unece.org/fileadmin/DAM/env/pp/documents/cep43e.pdf">http://live.unece.org/fileadmin/DAM/env/pp/documents/cep43e.pdf</a>
The UNECE Convention on Environmental Impact Assessment in a Transboundary Context	<a href="http://www.unece.org/env/eia/about/eia_text.html">http://www.unece.org/env/eia/about/eia_text.html</a>

Referenca tjera	Burimi
(Espoo Convention)	
UNECE Protocol on Strategic Environmental Assessment to the Convention on Environmental Impact Assessment in a Transboundary Context (Kiev Protocol)	<a href="http://www.unece.org/env/eia/about/sea_text.html">http://www.unece.org/env/eia/about/sea_text.html</a>

### SHTOJCA III: TABELA E VSM-SË NË LIDHJE ME PLANIFIKIMIN HAPËSINOR



## SHTOJCA IV: VEGLAT PËR VSM (MATRICAT, LISTA PËR VLERËSIM)

Tabela 1 - Tabela e Referencës për kornizën strategjike

PLANET, PROGRAMET, POLITIKAT	MAIN OBJECTIVES AND GOALS OBJEKTIVAT DHE SYNIMET KRYESORE <i>zbatueshme për zhvillimin komunale</i>	QASJA E PZHK-së

Tabela 2 - Mungesa e të dhënave

FAKTORËT*	KUFIZIMET DHE MUNGESA E TË DHËNAVE
Cilësia e ajrit	
Biodiversiteti	
Faktorët klimatike	
Trashëgimia	
Menaxhimi i mbeturinave	
Toka	
Uji	
Faktorët sociale dhe ekonomike	

\*Mund të ketë ndarje alternative të faktorëve

Tabela 3 - Objektivat e VSM-së të grupuar në fusha tematike

FUSHA TEMATIKE*	OBJEKTIVA	INDIKATORI	CAQET
Uji			
Cilësia e jetës			
Toka			
Natyra dhe biodiversiteti			
Peisazh			
Menaxhimi i mbeturinave dhe ujërave të zeza			
Rreziqet natyrore dhe ato të shkaktuara nga njerui			

FUSHA TEMATIKE*	OBJEKTIVA	INDIKATORI	CAQET
Energjia dhe ndryshimet klimatike			

\*Mund të ketë ndarje alternative të fushave tematike

Tabela 4 - Problemet kyçe mjedisore dhe mundësitë

PROBLEMET KYÇE
• • • •
MUNDËSITË KYÇE
• • • •

Tabela 5 - Objektivat e VSM-së të grupuar në fusha tematike

FAKTORËT*	NDIKIMET NEGATIVE	NDIKIMET POSITIVE
Cilësia e ajrit		
MASAT ZBUTËSE		
Biodiversiteti		
MASAT ZBUTËSE		
Faktorët klimatike		
MASAT ZBUTËSE		
Trashëgimia		
MASAT ZBUTËSE		
Menaxhimi i mbeturinave		
MASAT ZBUTËSE		
Toka		
MASAT ZBUTËSE		
Uji		
MASAT ZBUTËSE		

FAKTORËT*	NDIKIMET NEGATIVE	NDIKIMET POSITIVE
Faktorët sociale dhe ekonomike		
MASAT ZBUTËSE		

\*Mund të ketë ndarje alternative të faktorëve

Table 6 - Compatibility matrix to assess the MDP goals against the SEA objectives Tabela - Matricë për vlerësimin e përputhshmërisë së qëllimeve të PZHK-së kundrejt objektivave të VSM-së

OBJEKTIVAT E VSM-SË	Qëllimet e PZHK-së të ndara sipas fushave								
	FUSHA 1		FUSHA 2		FUSHA 3		FUSHA 4		FUSHA 5
	Qëllimi 1	Qëllimi 2	Qëllimi 3	Qëllimi 4	Qëllimi 5	Qëllimi 6	Qëllimi 7	Qëllimi 8	Qëllimi 9
O1:	0	0	+	+	0	0	0	0	0
O2:	0	0	0	-	-	0	0	--	0
O3:	0	0	0	0	0	0	0	0	0
O4:	0	0	0	?	0	-	0	--	?
O5:	0	++	0	+	0	0	0	0	0
O6:	0	0	0	+	0	0	0	0	+
O7:	0	0	-	++	+	0	0	-	-
O8:	0	0	0	-	?	0	0	--	0
O9:	0	0	0	0	+/-	0	0	0	0
O10:	0	0	0	0	0	-	0	0	0

#### ÇELËSI

- ++ Përputhshmëri e konsiderueshme
- + Përputhshmëri
- 0 Pa efekt
- - Mospërputhshmëri e vogël
- -- Mospërputhshmëri e konsiderueshëm
- +/- Elemente të mospërputhshmërisë dhe përputhshmërisë
- ? Përputhshmëria nuk mund të parashihet

#### QËLLIMI #

SINERGJIT E MUNDSHME:



<b>QËLLIMI #</b>
KONFLIKTET E MUNDSHME:

Table 7 - Issues and opportunities in *Municipality X*

FAKTORËT*	ÇËSHTJET	SI JANË TRAJTUAR ÇËSHTJET NË PROPOZIMET E PZHk-së
Cilësia e ajrit		<i>Mundësitë për të shqyrtuar:</i>
Biodiversiteti		
Faktorët klimatike		
Trashëgimia		
Menaxhimi i mbeturinave		
Toka		
Uji		
Faktorët sociale dhe ekonomike		

\*Mund të ketë ndarje alternative të faktorëve

Tabela 8 - Plani i propozuar i monitorim

OBJEKTIVAT	INDIKATORËT	FREKUENCA PËR MATJEN E PROPOZUAR	BURIMET E PRITURA TË TË DHËNAVE

Tabela 9 - Përmbajtja e kërkuar e raportit mjedisor sipas Ligjit 03/L-230 dhe ku është e mbuluar në këtë raport

INFORMACIONET QË DUHET PËRFSHIRË NË RAPORTIN E VSM, NENI 7 (SHTOJCA2, Ligji Nr.03/L-230)	KU ËSHTË E MBULUAR NË KËTË RAPORT
1. Një përshkrim i përmbajtjeve, objektivave kryesore të planit ose programit dhe marrëdhënieve me plane ose programe të tjera.	
2. Aspektet përkatëse të gjendjes aktuale të mjedisit zhvillimi i ngjashëm për zbatimin e planit ose programit.	

**INFORMACIONET QË DUHET PËRFSHIRË NË RAPORTIN E VSM, NENI 7 (SHTOJCA2, Ligji Nr.03/L-230)**

**KU ËSHTË E MBULUAR NË KËTË RAPORT**

3. Karakteristikat mjedisore të zonave që mund të preken konsiderueshëm.
4. Problemet ekzistuese mjedisore që lidhen me planin ose programin, duke përfshirë në veçanti problemet që lidhen me zona të një rëndësie të veçantë mjedisore.
5. Objektivat për mbrojtjen e mjedisit të përcaktuara në shkallë ndërkombëtare, nivel Komuniteti ose Shteti Anëtar, të cilat lidhen me planin ose programin dhe mënyra në të cilën këto objektiva ose konsiderata mjedisore janë marrë parasysh gjatë përgatitjes së planeve dhe programeve.
6. Efektet më të rëndësishme të mundshme mbi mjedis, duke përfshirë dhe çështje të tjera si biodiversiteti, popullsia, shëndeti i njerëzve, fauna, flora, toka, uji, ajri, faktorët klimaterikë, asetet materiale, trashëgimia kulturore duke përfshirë trashëgiminë arkitekturore dhe arkeologjike, pamjen dhe ndërlidhjen ndërmjet faktorëve të mësipërm.
7. Masat e parashikuara për të shmangur, ulur dhe për të zhdukur sa më shumë të jetë e mundur efektet domethënëse negative mbi mjedis gjatë zbatimit të planit ose programit.
8. Një përshkrim të arsyeve për përzgjedhjen e alternativave të trajtuara, dhe një përshkrim të mënyrës sesi u realizua vlerësimi, duke përfshirë vështirësitë (si për shembull mangësitë teknike ose mungesa e njohurive teknike) të hasura gjatë përgatitjes së informacionit të kërkuar.
9. Një përshkrim të masave të parashikuara për monitorimin, sipas nenit 15 të këtij ligji;
10. Një përmbledhje jo teknike të informacionit të dhënë nën kategoritë e mësipërme.

Tabela 10 - Vlerësimi i efekteve kumulative

FAKTORËT	VEPRIMET KRYESORE TË PLANIT					VLERËSIMI I EFEKTEVE KUMULATIVE (VLERËSIMI KUALITATIV + KOMENTE)
	1	2	3	4	...	
Uji						
Cilësia e jetës						
Toka						
...						

Tabela 11 - Krahasimi i alternativave (të plotësohet vetëm për vendime të mëdha)

OBJEKTI VAT E VSM-SË	ALTERNATIVA 1: PËRSHKRIMI SHKURTË	ALTERNATIVA 2: PËRSHKRIMI SHKURTË	ALTERNATIVA 3: PËRSHKRIMI SHKURTË
O1:	Performanca (shkallë cilësore)      Komente	Performanc a (shkallë cilësore)      Komente	Performanca (shkallë cilësore)      Komente
O2:			
O3:			
...			

